

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Nëntor 2022 / Nr. 11

NIS VITI I RI
AKADEMIK
NË AFA



**Peleshi: Synojmë që të përgatisim këtu
ekselencën karakteriale dhe dijes shqiptare**

Përmbajtja

Numri 11

MINISTERIALI

- 10** Ministri Peleshi: Shqipëria do të angazhohet fuqishëm për të ofruar një mjedis të sigurt dhe stabilitet më të gjerë në Ballkanin Perëndimor dhe hapësirat e përbashkëta detare

CEREMONIA

- 9** Gjeneral brigade Bilbil Bitri merr detyrën e komandantit të AFA-së

GPS

- 16** Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në forumin "GRUAJA, PAQJA DHE SIGURIA", zhvilluar në Kosovë

SOCIALE

- 28** "Unë ëndërroj për një ditë kur njerëzit nuk do të gjykohen nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre"

HISTORI

- 33** Shkolla Shqipe e Vashave, e krijuar prej pluhurit të shkretëtirës në shtyllën e fortë, për të ndriçuar kombin

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktore

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore / korrektore:
Suela HODA



4 NIS VITI I RI AKADEMIK NË AFA

Peleshi: Synojmë që të përgatishim këtu ekselencën karakteriale dhe dijes shqiptare

Nisi viti i ri akademik edhe për studentët dhe kursantët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi...



12 VIZITË ZYRTARE NË KOSOVË

Kingji: Është koha për qasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi vizitën e parë zyrtare bilaterale në Kosovë. Në ambientet e Ministrisë...



20 TETORI ROZË

RËNDËSIA E NDËRGJEGJËSIMIT TË FEMRAVE PËR PARANDALIMIN E SËMUNDJES SË KANCERIT TË GJIRIT

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në muajin e ndërgjegjësimit të luftës kundër kancerit të gjirit iu drejtua të gjitha femrave...



26 GJEOPOLITIKË

MAD, ose çmenduria që kërcënon të përsëritet

"Nëse njerëzimi nuk i jep fund luftës, lufta do t'i japë fund njerëzimit" - deklaratën e presidentit Kenedi në tetorin e viti '62, referuar kërcënimit nga raketat bërthamore....

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 11/ 2022

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





NIS VITI I RI AKADEMIK NË AFA

Peleshi: Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale dhe dijes shqiptare

Nisi viti i ri akademik edhe për studentët dhe kursantët e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e cilësoi Akademinë e FA-së si një nga projektet prioritare të Ministrisë së Mbrojtjes, që po avancon në bashkëpunim edhe me partnerin strategjik, SHBA-në. Ministri Peleshi uroi studentët dhe stafin pedagogjik për një vit të mbarë, ndërsa bëri me dije, për studentët e rinj, investimin që ky institucion, me mbështetjen e qeverisë shqiptare, po kryhen në mbështetje të Akademisë së FA-së.

“Po punojmë për ndërtimin e kampusit të ri të AFA-së me të gjithë parametrat. Është duke përfunduar master-plani, aty ku sot është Batalioni i Mbështetjes, kemi në përfundim procedurat për lidhjen e kontratës dhe fillimin e ndërtimit të godinës së parë. Jam i bindur që në rajon do të jetë projekti më i mirë, më i bukur dhe më i plotë”, - u shpreh ministri Peleshi. Në situatën e re të sigurisë, sipas z. Peleshi, sfida është edhe ngritja e nivelit të kërkimit shkencor. “Ne duam ta bëjmë AFA-në realisht avangardë të mendimit



shkencor, të dijes, të karakterit. Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale, por edhe të dijes shqiptare, të japim shembujt dhe modelin më të mirë të patriotëve të vërtetë me vepra dhe jo me fjalë. Ne po ndërtojmë qendrën e Inovacionit, e cila po merr jetë dhe shumë shpejt do të jetë funksionale”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes. Sipas ministrit Peleshi, teknologjia duhet të jetë fjala kyçe

e ristrukturimit të Akademisë së FA-së, duke përmendur këtu faktin se për pak muaj Shqipëria do të ketë një flotë dronësh të teknologjisë së fundit për botën ushtarake, por edhe civile, të cilët do të përdoren si burim informacioni për shërbime të ndryshme të institucioneve të vendit. Ministri Peleshi tha se brenda FA-së, prej 1 viti ka filluar programi i Masterit të Sigurisë Kibernetike, një disiplinë që është bërë e së tashmes, për shkak

edhe sulmit kibernetik, nga i cili u prek vendi ynë. “Duhet t’i kontribuojmë sistemit të sigurisë kibernetike, si pjesë e sigurisë kombëtare, edhe ne si institucion i edukimit ushtarak, duke prodhuar ekspertë, specialistë të kësaj fushe. Kemi shpallur 7 vende pune për specialistë të sigurisë kibernetike dhe më vjen mirë që ka shumë interes”, - bëri të ditur ministri Peleshi, duke shtuar se qeveria ka miratuar paga speciale për këtë sektor.





MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI MORI PJESË NË MINISTERIALIN E MBROJTJES NË KUADËR TË INICIATIVËS “ADRION”, VENEZIA, ITALI

Ministri Peleshi: Shqipëria do të angazhohet fuqishëm për të ofruar një mjedis të sigurt dhe stabilitet më të gjerë në Ballkanin Perëndimor dhe hapësirat e përbashkëta detare

Ministrat e mbrojtjes vlerësuan rëndësinë e Iniciativës “Adrion” (Adriatic - Ionian Initiative), si një shembull i suksesshëm i bashkëpunimit rajonal, bazuar në gjithëpërfshirjen, vlerat e përbashkëta si dhe orientimin e interesave të përbashkëta për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në zonën Adriatiko-Joniane. Vëmendje e veçantë iu kushtua rëndësisë së ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të kësaj iniciative, me qëllim rritjen e sigurisë detare, asistencës humanitare, kërkim-shpëtimit, ndërtimit të kapaciteteve si dhe mbështetjen e operacioneve të NATO-s dhe BE-së në zonën e “Adrion”.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi u shpreh se Ministria e Mbrojtjes dhe Forca Detare e vendit tonë është gjithmonë me e angazhuar në forcimin e bashkëpunimit në rajon me qëllim përballimin e sfidave aktuale dhe në të ardhmen, promovimin e stabilitetit rajonal, sigurisë dhe paqes: “Shqipëria do të angazhohet fuqishëm për të ofruar një mjedis të sigurt dhe për stabilitet më të gjerë në Ballkanin Perëndimor dhe hapësirat e përbashkëta detare. Iniciativa “Adrion” është një nga mekanizmat që po kontribuon në këtë objektiv. Pellgu Adriatik-Jon është një mjedis gjithnjë e më i aksesueshëm për të gjitha llojet e aktiviteteve malinje dhe është një nga pikat më të ndjeshme të tranzitit dhe infiltrimit në zemër të Europës. Prandaj, bashkëpunimi ynë rajonal duhet të jetë në nivelin më të lartë, për t’i ofruar siguri dhe stabilitet popullit tonë. Shqipëria dhe Forca e saj Detare janë gjithmonë të përkushtuara për të çuar më tej bashkëpunimin në rajon. Ne të gjithë duhet të vazhdojmë të luajmë një rol aktiv, duke adresuar sfidat e sigurisë, si dhe çështjet e prosperitetit ekonomik



dhe stabilitetit politik. Kjo mund të bëhet vetëm duke punuar së bashku”, - theksoi ministri Peleshi. Në Venecia, po në kuadër të nismës “Adrion”, po mbahet edhe “Simpoziumi Rajonal i Fuqive Detare”, në të cilin marrin pjesë komandantët e forcave detare të vendeve anëtare të kësaj iniciative. “Adrion” është një iniciativë, e cila ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet Forcave Detare të Shqipërisë, Kroacisë, Greqisë, Italisë, Malit të Zi dhe Sllovenisë.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Shqipëria, përpjekje për ngritjen dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj infrastrukturës kritike dhe sigurisë kibernetike

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Takimin 2-ditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në Takimin 2-ditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, që u mbajt në selinë e NATO-s, në Bruksel.

Në fokus të diskutimeve të ministrave të Mbrojtjes ishte rritja e kontributit për Ukrainën dhe forcimi i mbrojtjes së NATO-s, në situatën e krijuar nga agresioni rus në Ukrainë. Ministri Peleshi e vlerësoi mjaft të rëndësishëm këtë takim që, siç tha ai, vjen në një moment tepër kritik për mbrojtjen dhe sigurinë e aleatëve dhe adresimin e ndihmës së vazhdueshme për Ukrainën.

Ministri i Mbrojtjes falënderoi Aleancën dhe vendet partnere për gatishmërinë e treguar për të ndihmuar Shqipërinë pas sulmeve kibernetike të muajve të fundit. Ai i siguroi vendet aleate se Shqipëria po bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj infrastrukturës kritike dhe sigurisë kibernetike, në bashkëpunim edhe me vende e struktura

të specializuara në këtë fushë. Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin në fjalën e tij dënoi me forcë sulmin kibernetik ndaj shërbimeve online në vendin tonë dhe bëri thirrje për rritjen e vigjilencës dhe kapaciteteve mbrojtëse të vendeve të Aleancës dhe vendeve partnere në këtë fushë.

Në këtë Ministerial Shqipëria theksoi mbështetjen e saj për projektin e Porto Romanos, si një nyje e rëndësishme detare edhe në funksion të NATO-s.

Ndërkaq, ministri Peleshi theksoi gjatë fjalës së tij edhe rëndësinë që Aleanca i jep rajonit të Ballkanit, duke shtuar se kjo vëmendje duhet të jetë më e shtuar edhe në aspekte të tjera diplomatike dhe ekonomike, në interes të integritetit të rajonit edhe në organizma të ndryshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Gjatë punimeve të këtij takimi, ministri Peleshi zhvilloi takime të ndryshme me homologët të vendeve të tjera, ku u diskutua për çështje në interes të rritjes dhe bashkëpunimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.





MBAHET TAKIMI I 6-TË I GRUPIT TË KONTAKTIT

Ministri Peleshi: Shqipëria njih dhe respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ne po punojmë për të ofruar ndihmë ushtarake dhe humanitare

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e gjashtë të Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën.

Në këtë takim, të thirrur nga sekretari i Departamentit të Mbrojtjes i SHBA-së, z. Lloyd Austin dhe shefi i Shefave të Shtabit të Përbashkët (Chairman of the Joint Chiefs of Staff) të SHBA-ve, gjeneral Mark Milley, në selinë e NATO-s në Bruksel, ishin të pranishëm përfaqësues të afro 50 vendeve aleate dhe partnere.

Qëllimi i këtij takimi ishte adresimi i kërkesave të Ukrainës për kapacitete ushtarake dhe jo ushtarake, të nevojshme për vijimin e reagimit ndaj sulmit të paprovokuar të Rusisë. Në diskutimet e përfaqësuesve të lartë të shteteve aleate u konfirmua uniteti në mbështetje të Ukrainës.

Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Niko Peleshi dënoi me forcë të ashtuquajturat referendume ruse për aneksimin e ra-

joneve të Ukrainës, duke shprehur qëndrimin e Shqipërisë për të mos i njohur kurrë ato. Ministri Peleshi theksoi se Shqipëria njih dhe respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ministri Peleshi përmendi kontributin e deritanishëm të qeverisë shqiptare në mbështetje të Ukrainës dhe deklaroi

se po punohet për të ofruar ndihmë ushtarake dhe humanitare. Në këtë takim mori pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjene-ral brigade Arben Kingji. Takimi i gjashtë i Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën u mbajt para Takimit dyditor të Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri merr detyrën e komandantit të AFA-së

Gjatë ceremonisë së fillimit të vitit të ri akademik, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi prezantoi komandantin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri. Në ceremoninë e organizuar ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, studentë, kursantë si dhe stafi pedagogjik i AFA-së.

Mes të tjerash ministri Peleshi tha: "Këtë vit akademik, i cili përkon edhe me emërimin e komandantit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, AFA në auditorët e saj, mirëpret 212 studentë.

Gjeneral brigade Bitri ka një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura dhe ka kryer me profesionalizëm të gjitha detyrat që ka mbajtur, dhe jam shpresëplotë që edhe në këtë detyrë, ai do çojë përpara të gjithë objektivat në drejtim të rritjes së cilësisë së arsimimit dhe stërvitjes, përgatitjes së kurrikulave me objektiva, synime dhe programe bashkëkohore".

"Për më se tre vjet, studentët e programit "Bachelor" dhe gjatë një viti, Kursi i Përgatitjes së Oficerit të ri, do të aftësoheni, përgatiteni dhe formoheni për të drejtuar dhe komanduar. Krahas formimit bazë si oficerë, ju do të keni shansin që të arsimoheni dhe diplomoheni edhe në degë të dyta si në Shkenca Ushtarake, Teknologji Informacioni dhe Navigim Detar." Akademia e Forcave të Armatosura vitin e ardhshëm do të ndryshojë kohëzgjatjen e studimeve "Bachelor" nga tre vjet në katër vjet, duke pasuruar gjithashtu edhe larminë e degëve që do të ofrojë. Krahas programeve të studimit në degët Teknologji Informacioni, Navigim Detar dhe Shkenca Ushtarake, do të hapen dhe dy programe të reja studimi në: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe në Shkenca Komunikimi.



Shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e fillimit të vitit të ri akademik dhe marrjes së detyrës së komandantit të AFA-së nga gjeneral brigade Bitri, do t'i shprehte përgëzimet e tij për marrjen e detyrës, gjeneral brigade Bitrit, si një ushtarak me përvojë të gjatë pune në sektorë të ndryshëm të Forcave të Armatosura, ku çdo detyrë i është përgjigjur me devotshmëri dhe përkushtim të lartë.

Me tej gjeneral brigade Kingji do shprehej se: "Puna jonë do të orientohet në rritjen e cilësisë së sistemit të edukimit dhe të arsimimit të oficerëve të së ardhmes të FARSH, përmes një vizioni të ri sa më bashkëkohor dhe profesionist. Ndërsa në fjalën e tij, gjeneral brigade Bitri do të shprehte mirënjohjen për vlerësimin e dhënë dhe përkushtimin për ecurinë me produktivitet të lartë të AFA-së si institucioni më i lartë i arsimimit ushtarak.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në takimin e 10-të të Iniciativës “Defence Cooperation Initiative”

Shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të: Shqipërisë, Austrisë, Hungarisë, Italisë, Kroacisë, Malit të Zi dhe Sllovenisë, morën pjesë në takimin e 10-të të Iniciativës “Defence Cooperation Initiative” (DECI), të zhvilluar në Lubjanë, Slloveni.

Takimi u përshëndet nga ministri i Mbrojtjes slloven, z. Marjan Šarec, i cili u uroi mirëseardhjen gjithë pjesëmarrësve. Takimi i 10-të i Iniciativës DECI, i drejtuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Italisë, admiral Giuseppe Cavo Dragone, në rolin e vendit drejtues të Iniciativës, së bashku me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Sllovenisë, gjeneralmajor Robert Glavaš, në cilësinë e kryetarit të delegacionit të vendit pritës, vijoi punimet me disa prezantime, me qëllim njohjen e pjesëmarrësve në këtë takim mbi arritjet e deritanishme të kësaj nisme si dhe zhvillimet e pritshme në të ardhmen. Shefat e Mbrojtjes, pjesëmarrës në këtë takim, në fokus të diskutimeve të tyre kishin stabilitetin në rajonin e Ballkanit; ngritjen e kapaciteteve ushtarake, trajnimin dhe mundësinë e bashkëpunimit në projektet e përbashkëta; iniciativat e NATO-s dhe BE, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe shtimit të kontributeve në Aleancë dhe në Bashkimin Europian.

Gjeneral Kingji, në fjalën e tij në këtë takim e përshkroi Iniciativën si mjaft të rëndësishme për bashkëpunimin në rajon dhe më gjerë. Ai vlerësoi përpjekjet e vendeve të DECI-it si një nismë e rëndësishme rajonale që rrit bashkëpunimin ushtarak të vendeve të Ballkanit Perëndimor për të përmbushur aspiratat kombëtare për paqe, prosperitet dhe integrim euroatlantik.

Në përfundim të takimit u nënshkrua “Deklarata e Përbashkët” nga shefat e Shtabeve të Përgjithshme të vendeve të Iniciativës DECI.



Fillon Kursi i 5-të i Avancuar i Nënoficerit në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve

Qendra e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve vijon të zbatojë me intensitet dhe përkushtim të plotë planin e arsimimit për vitin 2022, në lidhje me arsimimin dhe trajnimin e kursantëve pranë këtij institucioni.

Më 3 tetor, u hap Kursi i 5-të i Avancuar i Nënoficerit, i cili do të zhvillohet në QAPN për një periudhë 8-javore dhe do të fokusohet në marrjen e njohurive dhe përgatitjen e nënoficerit në rolin e zëvendëskomandantit të togës. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën “tetar”. Ndjekin këtë kurs 46 kursantë, të cilët vijnë nga të gjithë njësitë dhe repartet e Forcave të Armatosura, si dhe 6 kursantë që vijnë nga Forcat e Sigurisë së Kosovës.



Gjeneral brigade Arben Kingji ndjek nga afër stërvitjen “Flotex-22”

Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, zhvilloi një vizitë inspektuese të stërvitjes “Flotex-22”, faza e ekzekutimit të së cilës u zhvillua në Gjirin e Vlorës. Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar. Në prezantimin e stërvitjes, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjell Sinanaj, njohu shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FAsë me qëllimin, objektivat dhe skenarin e stërvitjes.

Stërvitja “Flotex” është stërvitja vjetore kryesore e Forcës Detare, pasi

shërben për vlerësimin dhe certifikimin e aftësive dhe kapaciteteve të Flotiljes Detare në realizimin e misionit dhe detyrave të saj themelore. E veçantë në stërvitjen e këtij viti ishte realizimi i qitjeve detare me armatimin e anijeve, bazuar në skenarë të supozuar.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, i shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut I Ferdinand Kreshpani, ndoqi nga afër zhvillimin e stërvitjes së Forcës Detare, “Flotex-22”, e cila u zhvillua në Gjirin e Vlorës.

Qëllimi i stërvitjes ishte rritja e ndërveprueshmërisë midis mjeteve detare dhe Grupit të Bordingut të Flotiljes Detare, si dhe testimi i procedurave të zbatimit të ligshmërisë detare për operacionet e Ndalimit Detar dhe Kërkim-Shpëtimit (SAR).

Në fjalën e tij, gjeneral brigade Kingji vlerësoi profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar nga efektivat pjesëmarrëse në këtë stërvitje.





Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, vizitë zyrtare në Kosovë

Gjeneral brigade Kingji: Është koha për qasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi vizitën e parë zyrtare bilaterale në Kosovë.

Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, gjeneral brigade Arben Kingji, u prit me nderimet më të larta nga komandanti i Forcës së Sigurisë

së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari.

Në takimin e zhvilluar mes dy delegacioneve, gjeneral brigade Kingji vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin e deritanishëm midis Forcave tona të Armatosura dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, njëkohësisht u shpreh i vendosur për ta çuar përpara këtë bashkëpunim duke identifikuar

mundësi të reja praktike të përbashkëta. Kjo do të shërbejë në ngritjen e kapaciteteve ekzistuese dhe të reja ushtarake. "Ka ardhur koha që të kemi një përqasje të përbashkët dhe koordinim të qëndrimeve mbi rreziqet, sfidat në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në rajon. Në nivelin ushtarak, mbështesim procesin e transformimit të Forcës së Sigurisë



së Kosovës sipas standardeve të NATO-s”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kingji.

Nga ana e tij, gjeneralletenat Jashari shprehu mirënjohje për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nën lidhshpimin e gjeneral Kingjit, për kontributin e veçantë në zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operationale të FSK-së, veçanërisht në fushën e arsimimit dhe stërvitjes.

Më pas, gjeneral brigade Kingji u prit në një takim të veçantë edhe nga Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Me këtë rast, Mehaj i shprehu gjeneral brigade Kingjit falënderimin dhe mirënjohjen e thellë për Republikën e Shqipërisë për mbështetjen vëllazërore të ofruar në të gjitha periudhat e ndërtimit, zhvillimit, si dhe në të gjitha arritjet e deritashme të vendit, sikur edhe të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Gjeneral Kingji në fjalën e tij u shpreh se: “Nga ana ime, në të gjitha takimet dhe konferencat ku kam marrë pjesë, kam theksuar



rëndësinë e përsheptimit të procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në të gjitha organizmat dhe nismat rajonale dhe ndërkom-bëtare, për vetë të ardhmen e Kosovës dhe rajonit.

Axhenda e vizitës zyrtare të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji ka vijuar me një vizitë edhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku është njohur me arritjet e deritashme, sfidat dhe aktivitetet e planifikuara të FSK-së për të ardhmen.

Gjatë vizitës dyditore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm është pritur nga komandanti i KFOR-it gjeneralmajor Angelo Ristuccia.

Gjeneral brigade Kingji nga ana e tij, vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të NATO-s dhe KFOR-it për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në Kosovë dhe në gjithë rajonin. Shqipëria do të jetë gjithmonë një mbështetës dhe kontribuues i misionit të KFOR, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në Kosovë dhe rajon.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, zhvilloi vizitë në komandën rajonale në Pejë, ku është takuar me komandantin e kazermës kolonel Ivano Marotta, si dhe efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pjesë e misionit paqeruajtës, KFOR.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu mori pjesë në forumin “GRUAJA, PAQJA DHE SIGURIA”, zhvilluar në Kosovë



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Gratë, jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel global duhet të ngrenë fuqishëm zërin që femrat ushtarake, dhe jo vetëm, të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon

Me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, zëvendëskryeminstres dhe ministres së Punëve të Jashtme, Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, në Prishtinë u organizua Edicioni i Parë i Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GPS).

Me ftesë të presidentit të Kosovës në këtë forum mori pjesë edhe gjeneralmajor Shehu e autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes.

Në edicionin e parë të GPS-së, morën pjesë mbi 125 folës dhe mbi 500 pjesëmarrës nga 33 shtete, që shtrihen në 6 kontinente nga vende të ndryshme të botës, midis tyre lider botërorë, ekspertë, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile, të rinj dhe përfaqësues nga grupe të tjera të interesit.

Forumi ndërkombëtar pati si qëllim reflektimin e punës mbi sukseset dhe sfidat e kësaj axhende, 22 vite pas miratimit të Rezolutës 1325 të OKB-së "Gruaja, Paqja dhe Siguria" si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi nevojën për të njohur e promovuar aftësitë e grave dhe vajzave për të kontribuar në mënyrë aktive e përmbajtësore në procese të paqes dhe sigurisë.

Ky edicion i parë i Forumit iu dedikua trashëgimisë së ish-sekretares së SHBA-ve, Madeleine Albright. Organizimi i këtij Forumi ndërkombëtar ishte një ndër zotimet në kuadër të Samitit për Demokraci. Forumi synoi të përçonte qartë mesazhin, se paqja dhe siguria e grave janë shtyllat qendrore të vizionit të Kosovës për paqe të qëndrueshme në nivel vendor, rajonal dhe global.

Forumi GPS u zhvillua në një kohë kur paqja, liria dhe siguria po sulmohen në zemër të Europës, teksa gratë e

vajzat sërish janë në qendër të dhunës, torturës dhe trajtimit çnjerëzor.

Forumi u fokusua në "Ndërtimin e aleancave për paqe të qëndrueshme" dhe do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra nga përvojat e vendeve pjesëmarrëse, zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të balancuara gjinore, si dhe hartimin e kornizave të reja të veprimit në vazhden e ndryshimeve të vazhdueshme të arkitekturës së sigurisë dhe paqes në Europë e më gjerë.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, e cila hapi edicionin e parë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ndërmjet të tjerash u shpreh: "Historia e Kosovës është histori e secilës grua, e cila ka larguar një gur nga rruga drejt barazisë. Më vjen mirë që kemi mbledhur gra e burra nga çdo kënd i botës. Përpjekja është të sigurohemi që sfidat me të cilat përballemi të tejkalohen". 22 vite më parë, gratë vizionare dhe të guximshme bashkuan zërat e tyre për të krijuar rezolutën 1325, një akt historik që është gurtëmiel i asaj që njihet si agjenda për gratë për paqen dhe sigurinë. Ajo ka përmendur edhe diskriminimin e grave në vendet e botës, siç është Irani dhe jo vetëm.

Në këtë forum planifikohej të merret pjesë edhe tashmë e ndjera, ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit, Madeline Albright. Presidente Osmani u shpreh se: "Kishim menduar që zonja Albright do të ishte folësja kryesore në këtë forum, kur e patëm planifikuar këtë forum, por fatkeqësisht ajo ndërroi jetë. Ajo do të mbetet figurë historike për Kosovën, për kontributin që ka dhënë për sigurinë, paqen dhe lirinë. Ajo ishte frymëzim për ne, zëri ynë kur nuk kishim zë." Krahas rëndë-

sisë së grave, Osmani ka përmendur edhe luftën aktuale të Ukrainës me shtetin rus, gjersa ka theksuar se të pranishëm në forum ka edhe ukrainas.

Në këtë forum, Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, u ka ndarë çmimin presidencial për trimërinë dhe kontributin grave të Ukrainës. Forumin e kanë përshëndetur mjaft personalitete të larta botërore, të cilët ishin prezentë, por edhe nëpërmjet videove online.

Kështu Sekretari i Shtetit i ShBA-së, Antony Blinken, në Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, nëpërmjet një lidhjeje online me video ka thënë se, lufta në Kosovë është fituar sepse aleanca ishte e bashkuar dhe e fortë. "Lufta në Kosovë ishte një përballje mes vrasjeve barbare dhe forcës së nevojshme, ndërmjet mos tolerancës së dhunshme dhe respektimit të të drejtave të njeriut, mes tiranisë dhe demokracisë. Ne fituam sepse aleanca jonë ishte e bashkuar dhe e fortë. Më e rëndësishmja, ne ia dolëm sepse kauza jonë ishte e drejtë dhe për shkak të popullit të Kosovës", - ka cituar fjalët e zonjës Albright, Sekretari Bliken. Ai ka falënderuar Presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për organizimin e këtij forumi.

Gjithashtu edhe Presidentja e Parlamentit European, Roberta Metsola përmes një video-mesazhi i është adresuar Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Ajo ka folur për gratë në Ukrainë, duke thënë se nga to mësojmë kurajën dhe frymëzimin. Metsola gjithashtu u shpreh se Bashkimi European ka qenë gjithmonë i përkushtuar që të ndihmojë gratë. Bashkimi European ka qenë gjithmonë i përkushtuar që të ndihmojë gratë përmes agjendës për "Gratë, Sigurinë dhe Paqen", duke punuar me OKB-në, me NATO-n për të fuqizuar gratë dhe për t'u dhënë



rol në arritjen e paqes. Bashkimi Europian qëndron me këtë agjendë dhe kemi kërkuar përfshirjen e më shumë grave dhe të gjitha shteteve anëtare të BE-së, derisa stafi i BE-së duhet të kenë trajnim mandator për barazinë gjinore”, - tha ajo.

Zëvendësministria e Parë e Jashtme e Ukrainës, Emine Japarova, në Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ka folur për sfidat nëpër të cilat janë duke kaluar gratë ukrainase në luftën e nisur nga Rusia në këtë vend. Ajo në një moment e krahasoi presidentin rus, Vladimir Putin, me ish-presidentin serb, Slobodan Millosheviq, i cili kreu gjenocid në Kosovë. Ajo tha se Putini është Millosheviqi i ri, ku të dy i kanë duart e njollosura me gjak. “30 mijë ushtarë kanë luftuar krah me burrat në Ukrainë, nuk lodhen. Ato po sakrifikojnë jetën e tyre për një Ukrainë të lirë e të pavarur. Njëkohësisht Rusia i mban rob me qindra gra, edhe ato shtatzëna. Gratë keqtrajtohen e burgosen. Jetët e vajzave dhe grave në Ukrainë janë në rrezik, sidomos i atyre nën okupim”, - ka thënë Japarova. “Sot Putini është Millosheviqi i ri, të dy i kanë duart e njollosura me gjak”, - ka shtuar ajo.

“Në emër të të gjitha grave ukrainase dua të ju falënderoj për mirënjohjen, për trimërinë dhe rezistencën e grave të Ukrainës. Jam e sigurt që medalja presidenciale që i ndatë të gjitha grave të Ukrainës, që ju i përfaqësoni sot, do t’i inkurajojë nënat, gratë, mjeket, gazetaret dhe të gjitha gratë e Ukrainës për arritje të mëtijshme”, - ka shtuar ajo.

Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti, në Forumin Ndërkombëtar “Gratë, Paqja dhe Siguria”, ka thënë se populli i Kosovës u

beson grave po aq sa burrave. Ai tha se kur bëhet fjalë për çështjet e sigurisë, qytetarët e institucionet kanë caktuar si komandante Supreme, presidenten e vendit, Vjosa Osmani. Sipas Kurtit, gratë i përgjigjen thirrjeve të çdoditshme për paqe dhe siguri, sikur të jetë përpjekja e tyre jetësore, pasi sipas tij, gratë janë më të interesuara për politikën e paqes dhe sigurisë sepse edhe kërcënohen më së shumti nga mungesa e këtyre elementeve. “Nuk ka pasur ndonjë fazë që gratë s’janë angazhuar me thirrje e përpjekje për liri e paqe. Angazhimi i grave dhe vajzave në Kosovë s’ka munguar

asnjëherë në shtet-ndërtim por nuk mungon as në funksionimin e shtetit tonë të përditshëm”.

Në forum e kanë marrë fjalën edhe shumë personalitete të tjera të politikës, shkencës e shoqërisë civile.

Më tej forumi ka vijuar me panele. Kështu zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu ka marrë pjesë në panelin “Gratë në Sektorin e Sigurisë: Sfidimi i stereotipeve gjinore në sektorin e sigurisë”, ku paneliste ishin: Mgr. Bc. Šárka Havránková - nënkryetare e INTERPOL-it, Komiteti Ekzekutiv i INTERPOL-it; LTC Laura L. Lyons - Këshilltare për Politikën e Mbrojtjes, Drejtorja e Operacioneve të Mbrojtjes; Komisionere gjenerale Catherine Bourdes - Ministria e Forcave të Armatosura të Republikës Franceze; Lt. Col. (res.) Avital Leibovich - drejtore e Komitetit Hebre Amerikan në Jerusalem; gjenerale Pamela McGaha - komandante e Shtabit të NATO-s në Sarajevë; gjeneral Irfete Spahiu - inspektore e Forcës së Sigurisë së Kosovës; kolonel Taibe Canolli - drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës; Arta Bilalli Zendeli - shefe e Delegacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, etj.

Gjeneralmajor Shehu, mbasi ka falënderuar presidenten e Kosovës për organizimin e shkëlqyer të këtij forumi dhe për ftesën adresuar Ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi, ndër të tjera u shpreh: “Jam thellësisht e nderuar dhe e privilegjuar që jam ndër mikpritësit e këtij edicioni të parë të Forumit të Grave, Paqes dhe Sigurisë. Në emër të Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë, dëshiroj të përgëzoj për organizimin e këtij takimi të rëndësishëm, që ndodh në

një kohë kur paqja, liria dhe siguria janë nën sulm në zemër të Europës.

Në konfliktet e sotme, më shumë se 70% e viktimave janë civilë, shumica prej tyre gra dhe fëmijë. Lufta, konflikti, terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm kanë pasojë të ndryshme dhe shkatërruese për gratë dhe vajzat. Përballë kësaj, gratë në të gjithë botën janë duke udhëhequr lëvizjet për paqe (Iran, Afganistan) dhe rindërtimin e komuniteteve. Ekzistojnë prova të forta që sugjerojnë se pjesëmarrja e grave në proceset e paqes, kontribuon në paqe më të gjatë dhe më elastike pas konfliktit. Për fat të keq, pavarësisht kësaj, gratë mbeten kryesisht të padukshme dhe të përjashtuara nga proceset dhe negociatat e paqes. Shpresoj që në të ardhmen të ketë një rritje të përfaqësimit të grave në proceset e paqes dhe sigurisë, si luftëtare apo misionare”.

Në vijim ajo dha përvojën e Forcave të Armatosura shqiptare në zbatimin e Barazisë Gjinore, ku rreth 14.76% e personelit ushtarak janë femra. Më pas ajo u ndal në Planin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe në Planin e Veprimit të Ministrisë së Mbrojtjes, hartuar në mbështetje të rezolutës 1325 të OKB-së “Gruaja, Paqja dhe Siguria”. Roli i femrës ushtarake është rritur ndjeshëm si në arsimim, trajnim, në promovim në detyra e gradë. Femrat ushtarake sot i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në përfaqësitë tona në NATO, atashe ushtarake, në kryerjen e detyrave operacionale e mbështetëse brenda vendit, të barabarta me kolegët e tyre burra. Në vijim ajo i njohu pjesëmarrësit në panel edhe me hartimin e dokumentit mjaft të rëndësishëm që lidhet me mbrojtjen e femrave ushtarake ndaj dhunës dhe ngacmimeve në pozicionin e punës, dokument i cili është përgatitur dy vite më parë, me asistencën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri. Në fund gjeneralmajor Shehu theksoi se të gjitha si gra jo vetëm në nivel kombëtar, por në nivel rajonal dhe global duhet të ngremë fuqishëm zërin që femrat ushtarake të jenë të vlerësuara dhe të meritojnë vendin që u takon.

Gjatë panelit, pjesëmarrësit ndanë me publikun histori suksesi dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së gruas në sektorin e sigurisë. Panelistet inkurajuan pjesëmarrje të shtuar të grave në sektorin e sigurisë dhe dhanë rekomandime për të zhdukur stereotipet gjinore në këtë sektor të rëndësishëm. Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, organizuar në Kosovë, i mbylli punimet duke dhënë mesazhe të fuqishme për zbatimin e rezolutës “Gruaja, Paqja dhe Siguria”.



Komandanti i Forcës Detare mori pjesë në Simpoziumin XIII Trans-Rajonal të Fuqive Detare

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra mori pjesë në Simpoziumin XIII Trans-Rajonal të Fuqive Detare (T-RSS) në Venecia, Itali. Në simpoziun morën pjesë rreth 100 delegacione, të përbërë nga komandantët të Forcave Detare të Europës, Azisë, Afrikës, Amerikës Veriore dhe Jugore si dhe përfaqësues të agjencive dhe organizatave detare të ndryshme si COM MARCOM, "International Maritime Bureau", "African Union", "Gulf of Guinea Commission", ICC - "Interregional Coordination Center" (GoG), EU NAVFORMED, US NAVEUR / US NAVAFR (JFC NAPLES), SEGREDIFES, MARICOGECA.

Qëllimi i këtij simpoziumi ishte angazhimi i përbashkët i Forcave Detare rajonale për të mundur një qasje të përbashkët për një hapësirë detare të sigurt dhe të

qëndrueshme. Simpoziumi trajtoi sfidat globale detare në një mënyrë gjithëpërfshirëse, nëpërmjet ndarjes së informacionit dhe njohurive nga përfaqësues të ndryshëm të Forcave Detare, organizatave ndërkombëtare, industria dhe institucionet kërkimore shkencore nga fusha e detarisë. Gjatë ditëve të qëndrimit në Itali, komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnan Agastra pati takime dypalëshe me komandantin e Forcës Detare të NATO-s (MARKOM), nënadmiralet Keith Blount, me të cilin diskutoi mbi mundësitë e bashkëpunimit me grupet e gatshme të NATO-s dhe operacionet e aktivitetet detare që janë aktive. Gjithashtu, kundëradmiral Agastra zhvilloi takime të tjera me homologët e tij nga Forca Detare të vendeve të rajonit me të cilët diskutoi çështje të interesit të përbashkët.

Përfundon kursi SAR dhe Bording në Qendrën Stërvitore Pashaliman



Në Qendrën Stërvitore Pashaliman ka përfunduar kursi SAR dhe Bording, i cili u zhvillua në një periudhë dyjavore dhe morën pjesë pesë kursantë.

Pjesa e trajnimit u realizua në dy faza teorike mbi njohuritë e SAR dhe Bording, gërshetuar këto në veprime praktike, të cilat u zhvilluan dhe në det sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare. Kursantët gjatë kësaj periudhe kanë treguar disiplinë të lartë dhe korrektësi në zbatimin e rregulloreve të Forcave të Armatosura.

Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare Pashaliman krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm.

Firmoset Deklarata e edicionit të 4-t të Iniciativës “Adrion”

Në kuadër të Iniciativës “Adrion”, vendet anëtare të saj si Italia, Shqipëria, Greqia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, morën pjesë në takimin e radhës ministerial në Venecia, Itali.

Dokumenti kryesor i Iniciativës “Adrion” është deklarata e Ankonës, e cila u dakordësua në vitin 2000 në konferencën “Për sigurinë dhe zhvillimin e vendeve që kanë dalje në Adriatik dhe Jon”, duke krijuar mundësinë që anëtarët të ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë në shumë fusha, mes të cilave edhe në fushën detare në përputhje me Marrëveshjen Teknike të firmosur nga komandantët e Forcave Detare të vendeve të “Adrion”. Bashkëpunimi konsiston në fushën e shkëmbimit të informacionit, kontributin në operacione SAR dhe anti-ndotjeve detare, në zbatimin e ligjit ndërkombëtar në det etj. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u shoqërua nga komandanti i Forcës Detare shqiptare, kundëradmiral Adnand Agastra dhe atasheu ushtarak shqiptar në Romë Edmond Voci.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi u shpreh se Ministria e Mbrojtjes



dhe Forca Detare e vendit tonë është gjithmonë dhe më e angazhuar në forcimin e bashkëpunimit në rajon, me qëllim përballimin e sfidave aktuale dhe në të ardhmen, promovimin e stabilitetit rajonal, sigurisë dhe paqes.

Në edicionin e 4-t të Iniciativës “Adrion” Ministeriali i Mbrojtjes i

vendeve anëtare konkludoi me firmosjen e deklaratës së përbashkët të ministrave të Mbrojtjes që ka si synim vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm në frymën e besimit reciprok. Këto takime kanë si qëllim përmirësimin e angazhimit tërësor në Iniciativën “Adrion”.

Anija italiane “Amerigo Vespucci” realizoi një vizitë në Portin e Durrësit

Anija - shkollë e Forcave Detare italiane “Amerigo Vespucci” e konsideruar si një ndër anijet më të bukura në botë, me ftesë të komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, zhvilloi një vizitë portuale në portin e Durrësit.

Anija me vela “Amerigo Vespucci” ka filluar të lundrojë qysh prej vitit 1931 dhe është anija simbol e Forcës Detare Italiane. Në këtë anije janë edukuar dhe trajnuar breza të tërë oficerësh, ndër të cilët edhe shumë kadetë shqiptarë që kanë ndjekur studimet në Akademinë Detare të Livornos.

Gjatë kohës së qëndrimit të anijes në vendit tonë, janë zhvilluar vizita dhe takime zyrtare në anije nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji si dhe një vizitë e komandantit të anijes “Amerigo Vespucci”, kapiten i rangut I Luigi Romagnoli, në Komandën e Forcës Detare, ku u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Ad-



nand Agastra. Po ashtu, për efektivin e anijes u organizuan vizita në Muzeun e Krujës si dhe një ndeshje futboll midis efektivit të anijes dhe efektivëve të Forcës Detare. Gjithashtu, anija ka

qenë e hapur për t'u vizituar nga qytetarët e Durrësit, Tiranës dhe rrethinave përreth. Gjatë tre ditëve anija është vizituar nga më tepër se 12 000 qytetarë.

Ekuipezhet e helikopterëve zhvillojnë stërvitje për rritjen e aftësive profesionale në fluturimet natën

Në aerodromin e Bazës Ajrore Farkë është zhvilluar stërvitje ajrore me fluturime natën, kjo stërvitje ka qenë pjesë e programeve stërvitore për rritjen e aftësive profesionale të ekuipezheve ajrore.

Fluturimi në kushtet të shikueshmërisë së reduktuar është një nga përbërësit themelor të stërvitjes së vazhdueshme ajrore për pilotët. Fluturimet stërvitore, shërbejnë më së miri për rritjen e aftësive operacionale për përdorimin e mjeteve ajrore në operacione natën. Gjithashtu, fluturimet vizuale natën aftësojnë ekuipezheve ajrore në përdorimin e mjeteve të shikimit natën me NVG (Night Vision Goggles - Devices).

Operacionaliteti dhe gatishmëria është në fokusin e veprimtarisë së Forcës Ajrore, mjetet ajrore ofrojnë kapacitete për përdorim në një spektër të gjerë të përdorimit operacional, duke përfshirë kështu



realizimin e detyrave në konceptin e mbështetjes së trupave në terren dhe realizimin e misionëve të emergjencave civile.

Trajnimi dhe stërvitja për fluturimet natën u paraprijnë planeve të

modernizimit të Forcës Ajrore me helikopterë të rinj të tipit UH60 Black Hawk të cilët ofrojnë kapacitete operacionale për fluturime me NVG në kushte të shikueshmërisë së reduktuar.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, mori pjesë në Simpoziumin e 2-të të Komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve të NATO-s për vitin 2022

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, mori pjesë në Simpoziumin e 2-të të Komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve të NATO-s për vitin 2022 (NATO Air Chiefs' Symposium (NACS 2022)), i cili u zhvillua në Komandën Ajrore të Aleancës, në Ramstein, Gjermani. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i çështjeve aktuale dhe ndarja e perspektivave mbi fuqitë ajrore dhe hapësinore nën temën "Building the New Normal", për angazhimin e forcave ajrore të Aleancës në përpjekje për parandalim dhe mbrojtje, nisur nga situata aktuale në Ukrainë.

Takimi u zhvillua nën drejtimin e gjeneral James B. Hecker, i cili në fund të korrikut mori drejtimin e Komandës Ajrore Aleate dhe Komandës së Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën.

"Simpoziumi i Shefave Ajror të NATO-s është një traditë e krijuar prej kohësh për diskutime të hapura dhe të singërta midis liderëve të fuqive ajrore dhe hapësinore nga NATO dhe vendet anëtare partnere", - tha gjenerali Hecker. "Nën temën gjithëpërfshirëse 'Ndërtimi i Normales së Re', ne kemi ndarë perspektiva dhe kemi disku-



tuar qasjen tonë të përbashkët ndaj sigurisë", - shtoi gjenerali Hecker. "Përpjekjet e vazhdueshme dhe të kombinuara të të gjithë aleatëve në mbështetje të përgjigjes së NATO-s ndaj luftës brutale të Rusisë në Ukrainë, duke punuar për ngritjen e Sistemit të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të Integruar të Aleancës, demonstronjë përkushtimin tonë për Parandalim dhe Mbrojtje kuptimplotë", - përfundoi ai.

Vendet partnere, Finlanda dhe

Suedia, që janë në procesin e anëtarësimit në NATO, paraqitën kapacitetet e tyre ajrore dhe treguan punën e bërë për integrimin e tyre në këtë Aleancë.

Në këtë aktivitet Forca Ajrore Shqiptare diskuton si e barabartë në një mjedis ku fokusi i diskutimeve është mjedis strategjik i Aleancës, duke shkëmbyer mësimet e identifikuar nga praktikat më të mira për të fuqizuar më së miri Aleancën në të ardhmen.

Efektivët e BMEC-së të Komandës Mbështetëse, trajnim mbi teknikat operacionale të shuarjes së zjarreve

Në ambientet e auditorit në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua një trajnim mbi teknikat operacionale të shuarjes së zjarreve me efektivët e Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave civile (BMEC).

Ky trajnim u zhvillua nën asistencën e ekspertëve të Programit Operacional të Zjarrit të Shërbimit Pjor pranë Departamentit të Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila ka për qëllim aftësitë teorike dhe praktike për menaxhimin e emergjencave civile dhe në mënyrë të veçantë mbi teknikat e avancuara të fikjes së zjarreve në pyje.

Ky trajnim përmbajti trajtesa teorike në Ministrinë e Mbrojtjes si dhe ushtrime praktik pranë Bazës së Mbështetjes dhe Emergjencave Civile (BMEC) të Komandës Mbështetëse.



Efektivët të BMEC-së të Komandës Mbështetëse kryejnë trajnim bazë kërkim - shpëtimi me Forcat e Sigurisë së Kosovës

Efektivët e Kompanisë së Kërkim - Shpëtimit të Bazës së Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC) të Komandës Mbështetëse realizuan trajnimin bazë për Kërkim - Shpëtim urban në Qendrën Ndërkombëtare për Kërkim - Shpëtim të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Ky trajnim pati për qëllim përgatitjen, aftësimin dhe koordinimin e teknikave efikase që përdoren për kryerjen e operacioneve të kërkim - shpëtimit, kryesisht në zonat urbane si dhe në alpinizëm.

Efektivët, të cilët morën pjesë në këtë trajnim, ishin kryesisht nga Toga e Tërmeteve.





TETORI ROZË

RËNDËSIA E NDËRGJEGJËSIMIT TË FEMRAVE PËR PARANDALIMIN E SËMUNDJES SË KANCERIT TË GJIRIT “Pa gruan nuk ka jetë”

Zëvendësues i Shtabit të Përgjithshëm të FAsë, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, në muajin e ndërgjegjësimit të luftës kundër kancerit të gjirit iu drejtohet të gjitha femrave nën uniformën ushtarake ose jo. “Muaji tetor është muaji i ndërgjegjësimit në mbarë botën në luftën kundër kancerit të gjirit. Kjo sëmundje e rëndë prek këdo nga femrat, por më të rrezikuara janë ato mbi moshën 50-vjeçare. Sëmundje që nuk bën dallime, ajo mund të prekë këdo nga gratë, por gjithsecila nga ne duhet të ketë njohuri rreth kësaj sëmundjeje. Sot informacioni është i bollshëm, përveçse në qendrat shëndetësore të lagjeve, interneti është mjaft i pasur me informacione të tilla. I rëndësishëm është parandalimi i saj, ndërgjegjësimi për të bërë vizita mjekësore.

Mendoj se kjo është pika më e dobët në përgjithësi për femrat, të cilat hezitojnë të bëjnë teste, dikush nga padija e rrezikshmërisë së kësaj sëmundjeje, dikush nga frika, më mirë për të mos ta ditur nëse është prekur, por dikush, sidomos në zonat rurale, nuk i ka edhe mundësitë. Në këtë aspekt mendoj se strukturat shtetërore, por edhe private të shëndetësisë, duke filluar nga Ministria e Shëndetësisë deri te qendra e fundit shëndetësore në lagje, apo në fshat, duhet të sensibilizojnë opinionin femëror për rëndësinë që ka parandalimi i kancerit të gjirit.

Por edhe mediat kanë rolin e tyre të pazëvendësueshëm, jo vetëm tani që është muaji tetor, që

njihet ndërkombëtarisht si muaji i sensibilizimit të luftës kundër kancerit të gjirit, por gjatë gjithë vitit. Gjithashtu është e domosdoshme që edhe në shkollat të trajtohet ky problem, sidomos në arsimin e mesëm e atë të lartë. Lufta ndaj kësaj sëmundjeje nuk duhet të jetë me periudha por e përditshme. Sa më shumë të parandalojmë nga prekja e kësaj sëmundjeje, aq më shumë kemi ndikuar ndaj shoqërisë, pasi femra është qenia më e domosdoshme për krijimin e një familjeje të shëndoshë dhe ripërtëritjen e jetës në përgjithësi.

Për të kuptuar më shumë rëndësinë e luftës për parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit, vlen t'i referohemi disa statistikave zyrtare të Depistimit të Kancerit të Gjirit për vitin 2020, të publikuara në Shqipëri, Rajon, Europë dhe Botë si më poshtë:

Aktualisht, kanceri i gjirit është kanceri më i shpeshtë në popullatën e femrave dhe kanceri i dytë më i përhapur në të gjithë popullatën në Shqipëri, ku vetëm për vitin 2020 janë diagnostikuar për herë të parë 936 femra me Kancer Gjiri, ndërsa vdekje si rezultat i kësaj sëmundjeje për periudhën në fjalë janë 260 femra. Shkalla e mbijetesës, e cila llogaritet si raport mes numrit të vdekjeve në total nga kanceri i gjirit dhe numrit të rasteve të reja për një vit të dhënë, në Shqipëri rezulton 0.28 për vitin 2020. Kjo nënkupton që ka një numër të ulët të femrave që vdesin nga kanceri i gjirit krahasuar me numrin e rasteve të reja të diagnostikuara për vitin e marrë në shqyrtim. Krahasuar me vitin 2018,



ku shkalla e mbijetesës vlerësohej 0.33, ky tregues është në rënie, si rezultat i rënies së vdekshmërisë dhe numrit të rasteve të reja. Për më tepër, depistimi i kancerit të gjirit është një nga treguesit kryesorë për matjen e cilësisë së qendrave shëndetësore, dhe për vitin 2020 nga të dhënat zyrtare të FSDKSH ky tregues është realizuar në masën 22%, krahas standardit vjetor 80%, gjë që tregon përqindjen e ulët të femrave mbi 35 vjeç që kontrollohen në qendra shëndetësore në vendin tonë. Ky tregues është në rënie, krahasuar me vitin 2018 dhe 2019, ku realizimi i tij ka qenë përkatësisht 33% dhe 32%. Rënia ndër vite e këtij indikator paraqet numrin e ulët të femrave që kontrollohen për kancer gjiri.

Po në nivel global?

Kanceri i gjirit u bë kanceri më i zakonshëm globalisht që nga viti 2021, duke përbërë 12% të të gjitha rasteve të reja vjetore të kancerit në mbarë botën, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Rreziku i një gruaje për kancer gjiri pothuajse dyfishohet nëse ajo ka një të afërm të shkallës së parë (nënë, motër, vajzë) që është diagnostikuar me kancer gjiri. Më pak se 15% e grave që preken nga kanceri i gjirit kanë një anëtar të familjes të diagnostikuar me të.

Rreth 5-10% e kancerit të gjirit mund të lidhet me mutacione gjenesh të njohura të trashëguara nga nëna ose babai. Mutacionet në gjenet BRCA1 dhe BRCA2 janë më të zakonshmet.

Rreth 85% e kancerit të gjirit ndodh tek gratë që nuk kanë histori familjare të kancerit të gjirit. Këto ndodhin për shkak të mutacioneve gjenetike që ndodhin si rezultat i procesit të plakjes dhe jetës në përgjithësi, në vend të mutacioneve të trashëguara.

Faktorët më të rëndësishëm të rrezikut për kancerin e gjirit janë seksi (të jesh grua) dhe moshja (duke u rritur).

Sipas OBSH-së, në vendet me të ardhura të larta ekonomike, 9 në 10 femra të prekura nga kanceri i

gjirit mbijetojnë, në Indi 6 në 10 femra, ndërsa në Afrikën e Jugut 4 në 10.

Mbijetesa nga kanceri i gjirit pesë vjet pas diagnozës tani kalon 80% në shumicën e vendeve me të ardhura të larta, krahasuar me 66% në Indi dhe vetëm 40% në Afrikën e Jugut.

Pra duke iu referuar shifrave të mësipërme del e nevojshme njohja nga femrat dhe zbatimi i masave parandaluese ndaj kancerit të gjirit, ku do të veçoja:

1. Vetëkontrollin mujor të gjirit.
2. Ekzaminimin klinik të gjirit nga një personel shëndetësor.
3. Bërjen e mamografisë dhe ekos së gjirit, të cilat janë disa nga masat dhe hapat që çdo femër duhet t'i dijë dhe ti ndjek hap pas hapi.

Po në Forcat e Armatosura si trajtohet ky problem?

Aktualisht në Forcat e Armatosura rreth 15% e personelit ushtarak janë femra ushtarake, ndërsa përfshi edhe personelin civil, kjo shifër shkon në 20%.

Nisur nga kjo shifër në rritje të numrit të femrave edhe përkujdesja e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm është në rritje, jo vetëm në anën e ecures në karrierë, arsimim e kualifikim, por edhe të përkujdesjes ndaj shëndetit të tyre. Me të vërtetë vitet e fundit femrat ushtarake kanë qenë pjesë e shumë projekteve për mbrojtjen e shëndetit të tyre, përfshi edhe bërjen e mamografisë, bërja e së cilës në disa raste ka parandaluar sëmundjen e rrezikshme të kancerit të gjirit. Femrat ushtarake përpara të genit ushtarake me të gjitha detyrimet dhe të drejtat si edhe kolegët e tyre meshkuj, janë para së gjithash, nëna, motra, bashkëshorte që nga ana fiziologjike kanë disa veçori. Dhe pikërisht njohja e këtyre veçorive, duhet të jetë në qendër të punës të komandantëve të çdo niveli për t'i trajtuar femrat ashtu siç u takon, jo duke u krijuar privilegje të pamërituara, por për të zbatuar çdo të drejtë të tyre, përfshi edhe të drejtat në fushën shëndetësore si femra. Njohja e zbatimi Rezolutës 1325 të OKB-së "Gruaja, paqja dhe siguria", zbërthyer e planifikuar mjaftë mirë në Planin e Veprimit Kombëtar dhe në atë të Ministrisë së Mbrojtjes, hartimi i dokumentit për mos lejimin e dhunës e ngacmimeve seksuale në marrëdhëniet e punës, pjesë e kontributit jam edhe unë në detyrën e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm, për të cilën ndihem krenare, tregojnë e flasin për kujdesin dhe respektin ndaj femrave në përgjithësi dhe atyre ushtarake në veçanti.

Ndërgjegjësimi dhe lufta për parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit, përveç se detyrim individual i çdo femre, duhet të jetë në qendër të punës të komandave dhe shtabeve në Forcat e Armatosura. Përpara se të jemi ushtarake, me grada e detyra të ndryshme, jemi femra, nëna, motra e bashkëshorte dhe si të tilla veç e veç dhe së bashku si komunitet i femrave ushtarake, meritojmë trajtim dinjitoz në familje, në punë e shoqëri.

Si gjenerale, si zëvendëshef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, por mbi të gjitha si femër, u bëj thirrje të gjitha femrave në Forcat e Armatosura:

Kujdesuni për vete, ndërgjegjësoni veten dhe koleget tuaja për rëndësinë që ka lufta parandaluese ndaj kancerit të gjirit, e cila nuk duhet të jetë vetëm në muajin tetor, që njihet ndërkombëtarisht si muaji i ndërgjegjësimit ndaj sëmundjes së kancerit të gjirit, por kujdesi dhe lufta duhet të jetë e përditshme!



Nis nga Fieri procesi i vlerësimit të riskut në nivel qendror

Ka nisur nga qarku i Fierit procesi i vlerësimit të riskut në nivel vendor. Në prani të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbrojtjes Civile (AKMC), Haki Çako, prefektit të Fierit Leter Shehaj si dhe përfaqësuesve të UNDP-së dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë, u zhvillua takimi i parë i grupit ndërinstitucional teknik të punës me institucionet përgjegjëse për Mbrojtjen Civile për gjashtë bashkitë e Prefekturës Fier, përkatësisht bashkinë Fier, Lushnje, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër. “Fillimi i punës për dokumentin e vlerësimit të riskut në nivel vendor në gjashtë bashkitë e Prefekturës Fier do të plotësojë kuadrin ligjor në harmoni me dokumentin e Vlerësimit të Riskut në nivel qendror, që pritet të miratohet shumë shpejt”, - tha drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, z. Haki Çako.

Dokumenti i vlerësimit të riskut për 6 bashkitë e Prefekturës Fier është pikënisja për menaxhimin efikas të riskut të fatkeqësive në nivel vendor”, - u shpreh përfaqësuesi rezident ad interim i UNDP-së në Shqipëri Nuno Queiros. Zhvillimi i këtij dokumenti pason Dokumentin Kombëtar të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Strategjinë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Planin e Veprimit, që janë realizuar me ekspertizën vendase dhe të huaj të projektit RE-SEAL, të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

Një ekip ekspertësh do të asistojë institucionet vendore në hartimin e këtyre dokumenteve të rëndësishëm, të cilët do të shërbejnë për të orientuar punën e strukturave vendore për mbrojtjen dhe parandalimin nga fatkeqësitë si dhe në vijim për përgatitjen e Strategjive lokale të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive



dhe Planeve lokale të Mbrojtjes Civile.

Ky takim u parapri nga një bashkëbisedim dhe një ekspozitë me punime të nxënësve të shkollave 9 - vjeçare të Prefekturës Fier, realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parashkollor Fier, me tematikë “Nga paralajmërimi i hershëm në veprimin e hershëm” në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive dhe rëndësinë që gjithsecili ka në reduktimin e impaktit dhe përgatitjen në rast fatkeqësie.



Forcat Speciale kremtojnë 24-vjetorin e krijimit

Batalioni i Forcave Speciale (bFS), kremtoi 24-vjetorin e krijimit të tij. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), merrnin pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, anëtarë të komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare, komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale nënkolonel Ajet Jata, komandantë të reparteve vartëse të FT-së, si dhe përfaqësues nga shtabi i FT-së.

Ceremoninë e hapi komandanti i ROS-së, nënkolonel Jata, i cili në fillim bëri një rezymë të krijimit të batalionit të Forcave Speciale ndër vite dhe të angazhimeve të tyre si brenda ashtu edhe jashtë kufijve shtetërorë, në interes të paqes dhe sigurisë në vend, në rajon por edhe me gjerë. Më tej, në fjalën e tij, nënkolonel Jata nuk harroi të përmendë edhe sakrificën e këtij efekti, ku në majë të saj qëndron gjaku i derdhur nga Dëshmori i At-dheut kapiten Feti Vogli.

Por sipas komandantit të ROS-së, arritjet profesionale të bFS-së nuk do të ishin në këtë nivel pa ndihmën e aleatëve tanë në NATO, ku padyshim roli SHBA-së, Turqisë dhe Britanisë së Madhe ngelet më i spikatur.

Më pas, duke marrë fjalën zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral Ferdinant Dimo, vlerësoi punën e mirë të bërë në vite nga efektivet e këtij reparti elitë, duke veçuar kontributin e tyre në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, por duke mos lënë mënjanë edhe rolin e padiskutueshëm të forcave speciale në ndihmë të komunitetit, sidomos në rastet e fatkeqësive natyrore.

"...misioni juaj është i veçantë dhe realizimi i këtij misioni, kërkon po ashtu ushtarakë më aftësi të veçanta. Gjatë gjithë historisë tuaj,



që nga dita e parë e krijimit dhe deri më sot, ju keni treguar se profesionalizmi, disiplina dhe përkushtimi në realizimin e detyrave, nuk ju kanë munguar kurrë. Jam i bindur që edhe në të ardhmen, reparti juaj do të vijojë të përmbushë më të njëjtin përkushtim të gjitha detyrat, duke kaluar me sukses çdo sfidë që koha do paraqesë para jush.." - u shpreh ndër të tjera gjeneral Dimo.

Në emër të komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare, aktiviteti u përshëndet gjithashtu edhe nga deputeti dhe anëtari i këtij komisioni z. Bardhyl Kollçaku, i cili duke uruar forcat speciale për përvjetorin e krijimit të tyre, theksoi rëndësinë e veçantë që kanë këto forca në realizimin e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, në përgjithësi.

Ai shprehu falënderimet e tij për punën mjaft të mirë që efektivet e këtij reparti kanë bërë ndër vite dhe i siguroi ata për mbështetjen e vijueshme, jo vetëm të komisionit të Sigurisë Kombëtare, por edhe të Parlamentit shqiptar në tërësi.

Batalioni i Forcave Speciale, u krijua në vitin 1998 si nevojë e kohës në përgjigje të sfidave dhe situatave gjeopolitike. Prej 24 vitesh tashmë, ky repart elitë vijon traditën e tij të ruajtjes së një profesionalizmi, disipline, përkushtimi dhe standardi shumë të lartë, në realizimin e çdo detyre të ngarkuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Për kryerjen me devotshmëri dhe profesionalizëm të misionit të tij, ky repart është dekoruar disa herë nga autoritetet më të larta shtetërore.



Trupat komando të ROS-së përfundojnë me sukses stërvitjen “KFOR-31”

Trupat komando të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), përfunduan me sukses stërvitjen “KFOR-31”. Për një periudhë rreth njëmuajore, një kompani e katër trupave mori pjesë në stërvitjen “KFOR-31”, të zhvilluar në një nga bazat më të mëdha amerikane të trajnimit në Europë, siç është “Joint Multinational Readiness Center”, Hohenfels, Gjermani.

Ndër temat kryesore stërvitore, që u aplikuan gjatë “KFOR-31” ishin kontroll turme, patrullim me mjete dhe në këmbë, sigurimi i lirisë të lëvizjes, reagimi ndaj minave të improvizuara etj.

Efektivët e Regjimentit të Operacioneve Speciale, të përfaqësuar nga kompania I komando treguan disiplinë të lartë dhe profesionalizëm, në çdo detyrë të ngarkuar gjatë këtij trajnimi.

Në përfundim të “KFOR-31”, në analizën e zhvilluar nga pala amerikane që drejtonte stërvitjen, u vlerësua me nota pozitive, angazhimi dhe pro-



fesionalizmi i treguar nga personeli shqiptar i trupave komando.

“KFOR-31”, është një stërvitje ndërkombëtare e përvitshme, e cila

zhvillohet me qëllim përgatitjen e trupave ndërkombëtare, për dislokim në Kosovë nën komandën e KFOR-it.

Forca Tokësore zhvilloi takimin dypalësh “ALB-ITAL Army Staff Talks”

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, mes Forcave të Armatosura italiane dhe atyre shqiptare, sot në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, u zhvillua aktiviteti “ALB-ITAL Army Staff Talks”.

Qëllimi i këtij aktiviteti, ishte realizimi i bisedimeve dypalëshe me fokus kryesor realizimin e planit të bashkëpunimit për vitin 2022, si dhe diskutimin e aktiviteteve të planit të bashkëpunimit për vitin 2023.

Ekipi i ushtarakëve italianë u prit fillimisht nga zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo. Në bisedën me ushtarakët italianë, gjeneral Dimo e vuri theksin tek bashkëpunimi i shkëlqyer që ekziston midis dy ushtrive tona. Ai theksoi gjithashtu se, kontributi i përbashkët që japin në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut dy vendet tona mike dhe aleate, është një kontribut i cili natyrshëm rrjedh edhe nga bashkëpunimi ynë i ndersjellë.

Në këtë kuadër, gjeneral Dimo



falënderoi palën italiane për mbështetjen që i kanë dhënë efektivëve të Forcës Tokësore, sidomos në trajnimin e personelit. Ai shprehu besimin se ky bashkëpunim, do të vijojë të thellohet edhe në të ardhmen.

Takimi dypalësh, vijoi më tej në nivel ekspertësh, ku u diskutuan arritjet gjatë vitit 2022 si dhe mundësitë e reja për bashkëpunim afatgjatë gjatë vitit 2023.





Struktura e më e re e krijuar, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) nisi vitin e ri akademik për tre kurset institucionale të karrierës ushtarake të oficerëve të FA-së, në të cilat mirëpresim dhe 23 kursantë nga radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Jemi të vendosur të çojmë para përmirësimin e përgatitjes arsimore, programeve, modernizimin e metodologjisë dhe koncepteve të mësimdhënies, për të rritur nivelin e formimit të lidërshiptit ushtarak.



Krenarë për djemtë e ekipit të ROS, i cili u rendit në vend të dytë, në garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol”, mes 120 ekipeve nga mbi 30 vende të botës, të zhvilluar në Britaninë e Madhe.



Trupat Komandotë Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS), vijojnë trajnimin njëmuoj në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare “KFOR-31” në “Joint Multinational Readines Center” (JMRC) Hohenfels, Gjermani.



MAD, ose çmenduria që kërcënon të përsëritet



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“Nëse njerëzimi nuk i jep fund luftës, lufta do t'i japë fund njerëzimit” - deklaratën e presidentit Kenedi në tetorin e viti '62, referuar kërcënimit nga raketat bërthamore ruse në Kubë, e rivlerësojmë në aktualitetin e tetorit të 2022. “The Guardian”, më 4 tetor, shfaq një tren rus që transporton armatim të dyshuar bërthamor që i afrohet frontit të luftës, për një stërvitje bërthamore. Frikshëm, kjo na sjell në mend imazhet satelitore të raketave bërthamore sovjetike të vendosura në Kubë, të shfaqura nga J. Kenedi në OKB, 60 vite më parë. Gjatë krizës së kërcënimit bërthamor në luftën e ftohtë, në mënyrë metaforike BS dhe SHBA-të u personifikuan si dy njerëz që qëndrojnë në të njëjtën dhomë, ku secili ishte lagur me benzine dhe mbante në dorë disa shkrepëse. Për fat asnjëri nuk e ndezi shkrepësen, sepse ishin të bindur se të dy do digjeshin mes flakëve.

Me të drejtë kjo situatë u quajt Shtatërrim i Sigurt i Ndërsjellë (Mutual Assured Destruction - MAD). Jo pa qëllim u përdor ky akronim (MAD), cili në anglisht do të thotë, Marrëzi apo Çmenduri. Fatkeqësisht duhet të pranojmë se edhe pas 60 vitesh, Rusia e sotme ashtu si Bashkimi Sovjetik i atëhershëm, kërcënon të shkaktojë të njëjtën katastrofë, pra të përdorë armët e tij bërthamore. Gara e armëve bërthamore, në mes të dy fuqitë e mëdha, që shoqëroi luftën e ftohtë, bëri që BS të arrijë SHBA-në në aspektin e numrit të armëve “strategjike”. Gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, Perëndimi e dinte shumë mirë se forcat e saj në Europën Perëndimore ishin më të pakta në numër, ndaj atyre të Bashkimit Sovjetik dhe ndoshta nuk do t'i bënin ballë sulmit konvencional të bllokut të “Traktatit të Varshavës”. Për ta kompensuar këtë dobësi, amerikanët vendosën në vendet aleate europiane të NATO-s, bomba bërthamore me një fuqi relativisht të ulët taktike, megjithëse përsëri shkatërruese në një mënyrë të paprovuar më parë. Këto janë koka të raketave bërthamore më të mëdha, që të mund të lëshohen edhe nëpërmjet raketave ndërkontinentale, nga territori i njërës palë kundër territorit të palës tjetër. Nëse këto mbushje do të përdoren atë kohë, ato do të rrafshonin në të njëjtën kohë qytete të tëra. Edhe pse tingëllon si tmerruese, është pikërisht ky skenar frike e të dy palëve, ai që na ka shpëtuar deri më tani nga lufta bërthamore. Aktualisht vlerësohet se



Rusia është e barabartë në numër me SHBA-në, në armët nukleare strategjike, por ka avantazh në armët taktike, që kanë një rreze më të vogël veprimi dhe largëdhje. Në rastin e një sulmi sovjetik gjatë periudhës së luftës së ftohtë, NATO kishte kapacitete dhe mundësi të lëshonte disa raketa bërthamore, për të arritur fitoren. Udhëheqësit e Luftës së Ftohtë nga të dyja palët, u ndërgjegjësuan se nuk mund të fitonin një luftë bërthamore. Presidenti Biden e përsëriti, duke deklaruar të njëjtën gjë, më 22 shtator 2022: “Kjo luftë nuk ka fitues”.

Shumë kohë përpara epokës bërthamore, Carl von Clausewitz në librin e tij “Mbi Luftën” e analizoi shumë qartë pamundësinë e mbajtjes së konfliktit të kufizuar. Gjenerali e njihte dhe e kishte vërtetuar nga përvoja e tij dhe e të tjerëve strategë se, tensioni i natyrshëm midis politikanëve dhe gjeneralëve që përpiqeshin ta mbanin luftën të kufizuar nuk kishte pasur sukses. Gjithmonë luftërat kishin përfunduar në shkatërrimin total të njërës, ose të të gjitha palëve. Clausewitz na mëson që në çdo rast duhet të harmonizohen taktikat dhe strategjia. “Lufta nuk është gjë tjetër veçse vazhdimi i politikës me mjete të tjera”, - shkroi ai frazën e tij më të famshme me të cilën donte të thoshte se duhet të angazhohesh vetëm në atë lloj lufte që e bën të mundur paqen pasuese. Duhet të lutemi që sot në Moskë do të kenë mbetur ende njerëz që e kuptojnë dhe e besojnë “marrëzinë”, MAD.

Në tetorin e vitit 2022, plotësisht 60 vite pas krizës së raketave kubane të tetorit 1962, Rusia jo vetëm që nuk po ndalet por po përshkallëzohet drejt përdorimit të çdo mjeti ushtarak dhe të inteligjencës, si spionazhit, sabotazhit. Në këtë luftë shihet qartë përdorimi i pashembullt i kërcënimit me bllokadën ekonomike për mungesë gazi dhe drithi në Europë, si një strategji që po praktikohet në të gjitha frontet dhe me të gjitha armët ushtarake dhe përtej atyre ushtarake të Rusisë. Fuqia ushtarake, Inteligjenca, fuqia ekonomike, financiare dhe diplomacia si instrumentet kryesorë të fuqisë kombëtare ruse DIME, janë vënë në shërbim të luftës. Raportimet e fundit NATO-s dhe të mediave botërore prestigjioze, pranojnë se shpërthimet më 27, 28 dhe

29 shtator në tubacionin “Gaz prom 1” dhe “Gaz prom 2” në detin Baltik, pranë ishullit Danez të janë akte sab Bornholm, otazhi të drejtuar nga shërbimet sekrete ruse kundër Europës. Sipas “Vijesti”, më 29 shtator 2022, tridhjetë e tetë persona në Mal të Zi kanë rënë në pranga për spionazh në favor të Rusisë, mes tyre diplomatë dhe ish-zëdhënës i Ministrisë së Punëve të Jashtme Radomir Sekulović, i cili ka mbi 30 vjet, që ka mbajtur poste diplomatike dhe në vendet afrikane. Edhe 6 diplomatë të tjerë rusë shpallen ‘non grata’ nga Podgorica për spionazh dhe sabotazh kibernetik të shërbimeve qeveritare online. Në sesionin e fundit të OKB-së, përfaqësuesi i Moskës Vassily Nebenzi, përdor përsëri precedentin e njohjes së pavarësisë së Kosovës, për të legjitimuar njohjen e aneksimit të rreth 15 % të territorit të Ukrainës të pushtuar. Territori i Donensk, Luhansk, Zaporizhia dhe Kherson me rreth 90 mijë kilometra katrorë, është i barabartë me Hungarinë ose Portugalinë.

Infrastruktura kritike europiane dhe botërore është e rrezikuar nga Rusia. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të MB, Sir Tony Radakin paralajmëron për sabotim, nga ana e Rusisë të rrjetit kabllor të trafikut ndërkombëtar, kabllor nënujor dhe të dhënave ndërkontinentale. Ky rrjet zë 99% të komunikimeve globale pasi vetëm 1% janë satelitore. Qysh nga janari i këtij viti janë zbuluar veprime të dyshimta si nëndetëse të prodhuara posaçërisht për këtë qëllim, për prerjen e këtyre kabllove optike, me qëllim paralizimin e komunikimit ndërkombëtar, telefonatave, veprimeve online, transfertave bankare. Kablli optik më i gjatë deri tani është “Asia - American Gateway”, rreth 12 mijë milje i gjatë dhe përmban 200 fibra optike. Çdo fibër mund të transmetojë deri në 400 giga bite në sekondë, ose rreth 375 milion telefonata.

Përshkallëzimi i kërcënimeve ruse është rritur frikshëm dhe aktualisht gjykohet se rreziku bërthamor është në tavolinën e udhëheqësve perëndimorë. Në 2 dekadat e fundit, gjatë të cilave Putini e ka qeverisur Rusinë, ka ndryshuar sërish tabloja e armëve bërthamore strategjike. Aktualisht Rusia, është inferiore ndaj NATO-s në një luftë konvencionale dhe këtë dobësi Putin sigurisht që e di. Ai kërkon kompensim, duke kërcënuar, më 21 shtator 2022, me përdorimin e armëve bërthamore taktike, për të fituar betejat ose luftën që ka shpallur, të cilat vlerësohet se nuk po i shkojnë sipas parashikimit.

Shtetet anëtare të përhershme të këshillit të sigurimit, në një farë mënyre ia kanë borxh mbështetjes dhe sigurinë Ukrainës. Kjo për arsye se Ukraina si pjesë kryesore e BS, ka qenë edhe pose-

duese në territorin e saj të një sasive të konsiderueshme të armëve bërthamore. Ukraina ka filluar procesin e heqjes së kokave nukleare nga toka e saj, pas shpërbërjes së BS, në vitin 1991. Në këmbim, Kievit i është garantuar siguria dhe integriteti territorial me Memorandumin e Budapestit, të nënshkruar më 5 dhjetor 1994, nga liderët e Ukrainës, Rusisë, Britanisë, SHBA-së, Francës dhe Kinës. Fuqitë bërthamore, i kanë dhënë garanci për siguri Ukrainës, e për sovranitetin dhe integritetin në kufijtë ekzistues të Ukrainës. Rusia, përkundër kësaj marrëveshje, kreu agresion në Krime dhe pjesën lindore të Ukrainës më 2014. Kundërpërgjigjja e palëve garantuese perëndimore: SHBA-së, Britanisë, Francës por edhe e Kinës, ishte jo proporcionale, jo e fuqishme dhe nuk ndaloi Rusinë. Madje mbi bazën e këtij testi të vendosmërisë së Perëndimit, duket që Moska u nxit edhe për më shumë besim në agresionin e 24 shkurtit 2022. Sot kemi të drejtë të arsyetojmë, nëse Ukraina ishte poseduese e armëve bërthamore, Rusia nuk do guxonte ta sulmonte.

-Pas një sulmi të mundshëm bërthamor, NATO, dhe veçanërisht SHBA-të, duhet të jenë të përgatitur për vendime rrëqethese të paprecedentë. A mundet që Perëndimi të lëshojë armën bërthamore me rreze të vogël, për të treguar vendosmërinë e tij? Si do të vepronin më pas të dyja palët? Sapo të nisin të shpërthojmë këto armë, madje edhe një goditje "e kufizuar dhe e saktë" nga njëra anë, do të përjetohet si katastrofike nga pala tjetër. A mund të ruhet dimensionin e "luftës së kufizuar" në rastin e goditjeve nukleare? Sa e largët do të jetë paqja, në një rast konflikti bërthamor? Putin në fjalimet e tij patriotike, motivuese dhe propagandistike, ka lënë të kuptohet se mund të përdorë arsenalin e tij bërthamor, në rast se NATO do të kalonte vijat e tij të kuqe. Në situatën në të cilën ndodhet, ai ngatërron fatin e tij me fatin e Rusisë, duke e quajtur kërcënim çdo poshtërim personal, ose ndryshim të regjimit në Moskë. Njohja e republikave separatiste në shkurt dhe pranimiti i referendumeve vetëvendosëse për t'u bashkuar me Rusinë në shtator, bëhet qartazi për të "legjitimuar" reagimin, si dhe futur nën juridiksionin "integritet territorial dhe sovranitet të federatës ruse" këto territore ukrainase. Rezultati i referendumit u shpall më 30 shtator nga Putin, ishte siç pritet në një regjim autoritar dhe nën kërcënimin e armëve. Për fat të keq rezultati 99% në favor të bashkimit me Rusinë, na sjell trishtimin dhe frikën që ne e kemi përjetuar gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Mund të ndodhë hipotetikiqisht që një raketë hipersonike ruse të lëshohet në një vend anëtar i NATO-s, ose Perëndimi mund ta furnizojë Ukrainën me armë nukleare të cilat ndryshojnë fatin e luftës. Secili nga këto skenarë mund ta bëjë Putinin të frikësohet nga humbja dhe si pasojë të përshkallëzojë veprimet e tij. Goditja e tij e parë me armë bërthamore (nëse ndodh) do të tregonte edhe qëllimin e tij strategjik. Përsëri hipotetikiqisht ai mund të hedhë një bombë taktike me rreze të vogël në një pyll të zbrazët, apo në det të hapur, vetëm për të vërtetuar deklaratën



e tij, se nuk po bën bluf. Putin mund ta përdorë një armë nukleare taktike edhe kundër një depoje armësh në Ukrainë, apo një batalioni ushtarësh, vetëm për të treguar se në shënjestër të tij janë vetëm objektivat ushtarake.

Raketat bërthamore fluturojnë me shpejtësi aq të madhe shpejt, sa pala tjetër ka vetëm disa minuta kohë për t'u kundërpërgjigjur. Hakmarrja, frika dhe përgjegjësia para popullit, në kushtet e luftës online, do të rrisin tundimin: "ose t'i përdorim këto armë ose të humbim luftën". Një muaj më vonë, Biden e cilësoi Ministrin e Jashtëm rus Sergej Lavrov "të papërgjegjshëm", pasi Lavrov i tha televizionit shtetëror rus se rreziqet e luftës bërthamore ishin "të konsiderueshme". "Askush nuk duhet të bëjë komente të frikshme në lidhje me përdorimin e armëve bërthamore ose mundësinë e nevojës për t'i përdorur ato", - deklaroi presidenti Biden. Pak ditë pas pushtimit të Ukrainës, Putin urdhëroi forcat bërthamore të Rusisë në gatishmëri të lartë për herë të parë që nga rënia e ish-Bashkimit Sovjetik, duke bërë që Shtëpia e Bardhë të mblidhte një ekip zyrtarësh të sigurisë kombëtare - i ashtuquajtur "Ekipi i Tigrave". Ky ekip u ngrit për të studiuar dhe përgatitur përgjigjet reaguese, në rast se Rusia do të vendosë armë kimike, biologjike ose bërthamore kundër Ukrainës, kombeve fqinje ose autokolonave të NATO-s me armë dhe ndihma drejtuar për në Ukrainë.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), Rafael Mariano Grossi, raportoi më 24 shtator 2022 se situata e përgjithshme për uzinën mbetet e pasigurt, për sa kohë forcat ruse bombardojnë rajonin rreth Zaporizhzhia. Kjo zonë e pushtuar i është shtuar Donbass-t për t'u bashkuar Rusisë në referendumin e 24-27 shtatorit. Dyshohet se rusët po e testojnë opinionin ndërkombëtar me lëvizjet e tyre të studiuar në drejtim të kërcënimit të shpërthimit të kontrolluar në central. Rusët e dinë mirë çfarë bëjnë dhe sa larg duhet të shkojnë. Moska thjesht po i demonstroi Kievit, Brukselit dhe Washingtonit, se mund të shkaktojë së paku një "Çernobil të ri".

Versioni i vitit 1997 i doktrinës ushtarake ruse lejonte përdorimin e armëve bërthamore vetëm "në rast të një kërcënimi për ekzistencën e Federatës Ruse". Në vitin 2000, Rusia përditësoi doktrinën e saj ushtarake për të lejuar për-

dorimin e armëve bërthamore në "përgjigje ndaj agresionit në shkallë të gjerë, duke përdorur armë konvencionale në situata kritike për sigurinë kombëtare të Federatës Ruse". Doktrina e re i ka paraprirë veprimeve që Moska pikërisht po kryen sot. Duke njohur aneksimin e rajoneve separatiste: Donesk, Luhansk, Zaporizhzhias dhe Kherson, të pushtuar nën integritetin territorial të Federatës ruse, Putin i merr ato rrjedhimisht nën mbrojtjen e "Nënës Rusi". Ndërhyrja e Ukrainës apo dhe trupave të NATO-s në këtë rajon

të pushtuar, që deri dje i përkiste Ukrainës, nga data 1 tetor do të konsiderohet sulm kundër një toke ruse. Moska do ta quajë çdo veprim ushtarak në territorin e 4 krahinave, si shkelje e integritetit territorial dhe sovranitetit të Rusisë, e cila i jep të drejtë të përdorë "çdo lloj arme", siç deklaroi ish-presidenti dhe zëvendës kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare të Rusisë, Medvedev.

Jens Stoltenberg në një intervistë për "Reuters", më 22 shtator, deklaroi: "Sipas NATO-s, e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund luftës që Rusia nisi kundër Ukrainës, është që të pranohet se Moska nuk do të fitojë në fushëbetejë, por në negociata. Putini me mobilizimin e parë masiv ushtarak të Rusisë që nga Lufta e Dytë Botërore, do të përshkallëzojë konfliktin, dhe do të çojë në humbje më të mëdha të jetëve në të dy frontet. Është përtej ironisë që Putin ka zgjedhur 21 shtatorin, ditën ndërkombëtare të paqes të deklaruar nga OKB në 1981, si ditën e mobilizimit 'të pjesshëm' të 300 mijë rezervistëve rusë".

"Mos. Mos. Mos. Ju do të ndryshoni pamjen dhe dimensionin e luftës, ndryshe nga çdo konflikt qysh nga Lufta e Dytë Botërore. Rusët nën regjimin autoritar të Putin, po bëhen më të tmerrshëm dhe të frikshëm në botë, se sa kanë qenë ndonjëherë. Në varësi të asaj që rusët do bëjnë, ne do të përcaktojmë reagimin tonë", - deklaroi Biden në një intervistë për "CBS News". A do të provokojë Rusia një luftë bërthamore? Putin i ka të gjitha mundësitë, ka shprehur të gjitha motivet, ka konsumuar dhe përshkallëzuar të gjitha llojet e armëve në dispozicion, si dhe ka bërë të gjitha përgatitjet paraprake, që kjo të ndodhë. Nëse Putini mund ta nisë këtë MAD, kjo do të ndodhë vetëm se ai beson se mundet ta fitojë, ndryshe po nënshkruan vetëvrasjen e tij. Pyetja sot është nëse beson Putin vërtet në fitore me MAD? Ekzistojnë disa skenarë aktualisht, në të cilët ai mund të llogarisë si një lider autoritar, se lëshimi i një ose disa armëve bërthamore mund ta mbajnë Putinin në pushtet dhe t'i shpëtojnë atij jetën. Putin nuk e ka frikë perëndimin, as NATO-n me armët e saj bërthamore, por duhet të frikësohet nga reagimi dhe "shpërthimi" i rusëve. Rusët me qasje europiano-perëndimore, brenda dhe jashtë Rusisë po ndihen të turpëruar përballë botës së qytetëruar me veprimet e Moskës. Ata po refuzojnë masivisht pjesëmarrjen në luftën personale politike të Putinit, i cili më 7 tetor mbush 70 vjeç dhe në 2024 mbyll mandatin presidencial 6-vjeçar.

“Unë ëndërroj për një ditë kur njerëzit nuk do të gjykohen nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre”

Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë, me të drejta dhe dinjitet të barabartë. Pikërisht ky parim themelor që ka hedhur themelet në deklaratën e përgjithshme të të drejtave të njeriut, ka qenë një nga parimet bazë të rindërtimit të Europës pas Luftës së Dytë Botërore dhe është baza e sistemit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.

Për fat të keq njerëzit me ngjyrë shpesh nuk trajtohen si duhet. Me gjithë përparimet e arritura në trajtimin e barabartë dhe luftën kundër diskriminimit, në shumë vende europiane vazhdon të ekzistojë racizmi strukturor dhe institucional. Po të jesh njeri me ngjyrë, diskriminimi në tregun e punës, në sistemin e arsimit, në sistemin e shëndetësisë, etj. është më i madh se tek një person pa ngjyrë. Në luftën kundër racizmit ndaj njerëzve me ngjyrë duhen luftuar rrënjët e tij, duke u konfrontuar me trashëgiminë e të kaluarës si dhe skllavërisë historike. Po ashtu është e domosdoshme që të luftohen në mënyrë sistemate fjalimet që nxisin urrejtjen dhe veprat raciste.

Që nga fillimi i njerëzimit, diskriminimi, qoftë në një formë, qoftë në tjetrën, ka paraqitur problem. Diskriminimi është bërë gjithkund ndaj njerëzve autoktonë dhe ndaj minoriteteve, diskriminimi ndodh ndaj fëmijëve, femrave, të cilat trajtohen si qenie njerëzore më pak të vlefshme, njerëzve të infektuar me HIV/AIDS, kundër atyre që kanë të meta fizike dhe psikike, si dhe kundër atyre me orientime të tjera seksuale. Kjo shfaqet madje edhe në fjalorin tonë të përditshëm, përmes të cilit ndonjëherë, me qëllim ose pa qëllim e veçojmë veten nga të tjerët. Diskriminimi shfaqet në aq shumë forma, sa që mund të supozojmë se secili në njëfarë forme dhe mase ka qenë i prekur nga diskriminimi.

Marrë historikisht, ndryshimet biologjike që nga kohët e hershme janë përdorur për ta justifikuar ekzistimin e racave “superiore” dhe “inferiore” dhe me këtë qeniet njerëzore klasifikoheshin varësisht nga raca.

Për shembull, teoritë e Çarls Darvinit (Charls Darwin), për evoluimin dhe mbijetesën e më të aftëve, janë përdorur për të justifikuar “shkencërisht”

ekzistencën e superioritetit racor.

Sot, si rezultat i këtyre përvojave historike, ndalimi i diskriminimit është paraparë me shumë konventa ndërkombëtare dhe legjislacione kombëtare. Diskriminimi i bazuar në çfarëdo baze, pengon njerëzit që në mënyrë të barabartë të ushtrojnë të drejtat dhe zgjidhjet e tyre dhe kjo rezulton jo vetëm në pasiguri ekonomike dhe shoqërore, por gjithashtu prek edhe respektin ndaj vetes dhe vetëvendosjen e personit të diskriminuar.

Njohja e dinjitetit të lindur dhe e të drejtave të barabarta, ashtu siç është paraqitur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore, *paraqet shtyllën për liri, drejtësi dhe paqe në botë.*

Racizmi është një qëndrim.

Ata që janë viktima të racizmit janë ata njerëz që për shkak të prejardhjes apo ngjyrës së lëkurës, diskriminohen ose injorohen. Diskriminohen ata persona që injorohen dhe përjashtohen për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, prejardhjes kulturore ose sociale, por edhe besimit fetar. Koncepti i racizmit është i lidhur ngushtësisht me atë të ksenofobisë dhe nacionalizmit. Ksenofobia që konsiderohet si frikë nga të huajt, shpesh përkthehet si “armiqtësi kundër të huajve”.

Racizmi mund të shprehet haptazi dhe fshehurazi.

Mund të cilësohet si një ironi e hidhur që ka si synim përjashtimin e tjetrit dhe të të huajit dhe fatkeqësisht ka ekzistuar dhe ekziston në të gjitha epokat, kulturat dhe kontinentet.

Diskriminimi i bazuar në çfarëdo baze, pengon njerëzit që në mënyrë të barabartë të ushtrojnë të drejtat dhe zgjidhjet e tyre dhe kjo rezulton jo vetëm në pasiguri ekonomike dhe shoqërore, por gjithashtu prek edhe respektin ndaj vetes dhe vetëvendosjen e personit të diskriminuar.

Racizmi, kjo e metë e shoqërisë, është i dukshëm edhe në shoqërinë shqiptare. Kjo shoqëri është paragjykuar dhe vazhdon të paragjykohe.

Dukshëm kjo vihet re dhe në prezencën e dy komuniteteve, rome dhe egjiptiane, si komunitete shtegtare, të cilët përbëjnë së bashku grupin minoritar më të madh në Europë.

Stereotipat anti-ciganë vazhdojnë të përhapen dhe të ri përsëriten dhe nga mediat. Disa gazeta dhe medie transmetuese kanë raportuar mbi romët dhe egjiptianët vetëm në kontekstin e problemeve sociale dhe krimit.



Duhet të largohemi nga gazetaria e 'klikimeve' dhe të kemi një qasje të re, drejt një gazetarie etike, për t'i dhënë fund përshkrimit negativ të romëve në medie. Si një parim i përgjithshëm, çfarë është e paligjshme jashtë lidhjes në internet, duhet të jetë e paligjshme dhe gjatë lidhjes, në një kontekst ku interneti përdoret për të përhapur fjalë urrejtjeje anti-rome dhe nxitur dhunën.

Fryma anti-cigane mund të përmbajë gjithashtu refuzimin e njohjes së historisë rome të vuajtjeve të mëparshme, në veçanti gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky mohim pasiv manifestohet shpeshherë në heshtjen mbi viktimat rome në ceremonitë dhe monumentet përkujtimorë, në mbulimin që i bëhet nga media, në librat zyrtarë ose në tekstet e historisë.

Asgjësimi i romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk duhet të harrohet. Mësimdhënia e historisë rome, ngritja e vetëdijes mbi gjenocidin e këtyre komuniteteve gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e monumenteve përkujtimorë, janë më e pakta që vendet mund të bëjnë për të nderuar viktimat.

Duhet të krijohen gjithashtu komisionet e të vërtetës, ku të vendosen faktet.

Asgjësimi i romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk duhet të harrohet. Mësimdhënia e historisë rome, ngritja e vetëdijes mbi gjenocidin rom gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e monumenteve përkujtimorë janë më e pakta që shtetet anëtare mund të bëjnë për të nderuar këto viktime.

Vetëm pak romë në Gjermani arritën t'u mbijetonin Holokaustit dhe kampeve të përqendrimit nazist, ata u përballën me vështirësi të panumërta gjatë përpjekjes së tyre për të rifilluar jetën nga e para, pasi kishin humbur shumë familjarë dhe të afërm, sikurse dhe pronat e tyre të cilat ishin shkatërruar apo konfiskuar. Shëndeti i shumë prej tyre ishte përkeqësuar.

Për vite me radhë, kur disa tentonin të kërkonin rikompensim, kërkesat e tyre refuzoheshin. Për të mbijetuarit drejtësia nuk erdhi dhe pas periudhës post-Hitleriane. Vrasjet masive të romëve nuk ishin pjesë e gjykimit të Nurenbergut.

Gjenocidi ndaj romëve pranohej vetëm përciptas në fjalimet publike. Nuk u njohën po ashtu dhe krimet që regjimet fashiste bënë ndaj romëve në të njëjtën

periudhë në vende të tjera në Europë.

Në Itali, një qarkore e 1926-ës, urdhëronte dëbimin e të gjithë romëve të huaj në mënyrë që *"të pastrohej vendi nga karvanët e ciganëve, të cilët, e panevojshme të rikujtohet, përbëjnë një rrezik për sigurinë dhe shëndetin publik nga kultura e jetesës cigane"*.

Romët janë të huajt që shërbejnë si koka turku kur situatat shkojnë keq dhe njerëzit vendas nuk dëshirojnë të marrin përsipër përgjegjësinë. Kjo, një situatë e njohur në të gjithë Europën nga grupet ekstremiste.

Metodat e persekutimit kanë ndryshuar me kohën duke përfshirë skllavërimin, asimilim e sforcuar, përzënien, internimin dhe vrasjet masive.

Shqipëria bëri përpjekje për të përmirësuar pjesëmarrjen e fëmijëve romë në sistemin shkollor, por me ndikim të ulët deri tani.

Shqipëria prezantoi disa masa favorizuese për studentët romë ose studentë nga grupe të cenuara, p.sh.: duke dhënë libra falas ose duke ofruar kuota për studentët romë ose egjiptianë në universitet.

Ministria e Arsimit rriti pjesëmarrjen e romëve në parashkollor, që prej tetorit të 2017, romët dhe egjiptianët janë njohur si një pakicë kombëtare e veçantë në Shqipëri. Deri atëherë, romët janë njohur si një pakicë gjuhësore, ndërkohë që egjiptianët nuk njiheshin as si pakicë gjuhësore, as si pakicë kombëtare.

'Romët e duan lirinë, e marrin jetën lehtë dhe janë nomadë të gëzuar, që veshin rroba shumëgjyreshe dhe shumë bizhuteri ari. Ata kërcejnë me pasion, janë artizanë të talentuar dhe muzikantë të mëdhenj. Gratë e tyre janë të bukura dhe joshëse si Karmeni i Xhorxh Bizesë apo Esmeralda nga 'Katedralja e Notre Dame-it''.

Ata kanë më shumë fëmijë sesa janë në gjendje t'i ushqejnë e veshin. Frika e refuzimit ndonjëherë është aq aktuale sa disa romëve u duhet të fshehin origjinën e tyre etnike me qëllim që të vazhdojnë të jetojnë në shoqëri dhe jo larg saj. Për sa kohë që martesat me një rom apo lejimi i prindërve për fëmijët që të martohen me romët është një tabu nuk bëhet fjalë për të diskutuar mos dëshirën e vetë romëve për t'u integruar.

Vetë-marxhinalizimi, kur haset, është dhe ka qenë më shumë një strategji mbijetese, se sa një zgjedhje e lirë nga ana e tyre.

INTERVISTË ME NËNKOLONELIN AJET JATA, KOMANDANT I REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE

Forcat Speciale, njësi elitare e FA-së

**INTERVISTOI:
ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE**

Nënkolonel AJET JATA KOMANDANT I REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE pas mbarimit të shkollës së mesme në vendlindje dhe përfundimit të studimeve në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", u diplomua Officer i Zbulimit me gradën Toger në vitin 2001.

Që atëherë ka shërbyer në pozita të ndryshme si komandant toge, komandant kompanie në Brigadën Komando dhe instruktor në kursin e Forcave Komando, asistent pedagog/komandant i Kompanisë Taktike në Universitetin Ushtarak "Skënderbej", specialist i Intel-it dhe shef i Seksionit të Zbulimit në Batalionin e Forcave Speciale.

Ka shërbyer si zëvendëskomandant i Batalionit të Komandës Mbështetëse në Forcën Tokësore, më pas ka shërbyer si shef Shtabi dhe zëvendëskomandant i Policisë Ushtarake. Nga data 1 shtator 2020 deri më 1 shtator 2022 ka shërbyer si komandant i Batalionit të Forcave Speciale.

Që nga viti 2001, nënkolonel Jata shërbeu në 5 dislokime, duke përfshirë "Operacionin Liria e Irakut" (OIF), si komandant toge dhe zëvendëskomandant i Kontingjentit në Irak dhe si shefi i S2 i kontingjentëve "Eagle 2, 5, 7", në "Operacionin e Lirisë së Përhershme" - "Operation Enduring Freedom" (OEF) në, Afganistan.

Për shërbimin e tij të jashtëzakonshëm në Afganistan është vlerësuar me medaljen "Shqiponja e Artë" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Nënkolonel Jata ndoqi një sërë kursesh kualifikimi, të tilla si Kursi Komando, Kursi i Instruktorit në Republikën Çeke, Kursi Pre-Ranger dhe Ranger në FT Benning, Kursi i Avancuar i Oficerit, Kursi Bazë i Oficerit, Kursi bazë FS Intel në Mons, Belgjikë, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, Kursi i Menaxhimit të Burimeve Ndërkombëtare të Mbrojtjes, në Monterey dhe Kursi LADSCA në Rhode Island në SHBA. Ai gjithashtu ka ndjekur disa kurse trajnimi në Shqipëri dhe jashtë saj me Forcat Speciale të SHBA-së dhe Aleatët e NATO-s.

Është diplomuar në Fakultetin Histori-Filologji në degën "Histori" dhe mban titullin "Master Shkencor" në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Gjatë viteve të shërbimit, ai ka marrë shumë medalje si medalja "Shqiponja e Artë" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë "Për profesionalizëm, përgjegjësi të lartë dhe ndihmë të spikatur në fushën e sigurisë së trupave dhe zbatimin me sukses të tre kontingjentet "Eagle" 2, 5 dhe 7 në Kandahar, Afganistan; katër medalje nga ministri i Mbrojtjes, tre medalje për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare dhe një medalje "Për shërbim të Shquar", nga CHoD, një medalje "Karriere" nga Komandanti i Forcës së Përbashkët, një medalje nga Komandanti i FT "Për rezultate të larta në përvetësimin e programit të stërvitjes", dy medalje të NATO-s nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, "Për Pjesëmarrje në Operacionet e ISAF". Po ashtu ai ka marrë shumë certifikata mirënjohjeje, vlerësimi të arritjeve në punë, misione të ndryshme dhe pjesëmarrje.

Nga data 01 shtator 2022 caktohet Komandant i Regjimentit të Operacionit Special.

Komandant Jata, si u krijua njësi e operacioneve speciale, organizimi dhe funksionimi i saj?

Forcat Speciale Shqiptare u krijuan 24 vjet më parë, në një kohë të zyrtë për Gadishullin Ballkanik dhe në një kohë kur kërkoheshin angazhime serioze për t'u përfaqësuar në NATO. Lideri politik edhe ushtarak në ato kohë vlerësuan krijimin

e një kapaciteti/njësie me aftësi të veçanta taktike, fizike e operacionale të dislokueshme për t'u paraprirë kërcënimeve të reja asimetrike si brenda dhe jashtë vendit, por gjithashtu të ndërveprueshme në kuadrin e bashkëveprimit me aleatët.

Vizioni strategjik u implementua që në zanafillën e vet, duke zbatuar një kurrikul trajnimi të padëgjuar apo aplikuar më parë në trajnimin e trupave të Forcave të Armatosura, ku përveç ngarkesës fizike dhe psikologjike, një vend të veçantë e ka rritja e vlerave atdhetare dhe krenaria Kombëtare. Sot, pas 24 vjetësh, kjo njësi unike në aftësitë operacionale paraqitet më e konsoliduar dhe më e ndërveprueshme në shkallën e ekspertizës të kërkuar nga NATO për këto lloj njësish, kjo si rezultat edhe i eksperiencës së fituar në trajnimet e përbashkëta dhe misionet luftarake.

Kjo njësi u krijua me vendimin Nr.2 datë 16.10.1998 të Kryetarit të Këshillit të Mbrojtjes, zotit Rexhep Meidani, e cila varej drejtpërsëdrejti nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Njësia që në fillimet e saj është organizuar me strukturë të mirëfilltë të forcave Speciale.

Cilat janë detyrat operacionale të FS?

Forcat tona speciale, ashtu si të gjitha forcat speciale të vendeve të tjera, janë njësi të mirë organizuara dhe mirë pajisura, të cilat kryejnë detyra speciale brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur metoda dhe teknika jo konvencionale.

Bazuar në doktrinën e Forcave Speciale AJP 3.5, Forcat Speciale kryejnë tre detyra bazë, siç janë: Asistencë Ushtarake, (MA), Goditje direkte (DA) dhe Zbulim Special (SR). Zakonisht forcat e operacioneve speciale operojnë në zona me rrezikshmëri të lartë dhe të ndjeshme politikisht. Duke iu referuar doktrinës, mjediset ku forcat speciale operojnë janë mjedisë armiqësore, zona gri, zona në të cilat konflikti është prezent, janë mjedisë operacionale të mohuara (mjedisë ku asnjë aktor shtetëror dhe jo shtetëror nuk merr përgjegjësi mbi ndikimin në zonë) dhe mjedisi i tretë janë vende me të brishta politikisht. Sipas mjedisëve realizohet edhe kryerja e detyrave speciale. Në mjedisin armiqësor dhe të mohuar forcat speciale kryejnë tre detyrat bazë të tyre, por në mjedisin e tretë (mjedis politikisht i brishtë) forcat speciale kryejnë detyra të operacioneve psikologjike (PSYOPS), ngritje të formacioneve paraushtarake, operacione kryengritëse etj. Forcat Speciale, përveç detyrave të përmendura më sipër, kryejnë një sërë detyrash të tjera, si kryerjen e operacioneve speciale nga toka, deti dhe ajri, operacione brenda të gjithë spektrit të luftimeve, operacione sabotazhi, gjurmimi, operacione të hapura dhe të mbuluar.

Cilat janë operacionet e para të batalionit të Forcave Speciale?

Operacionet e para të Batalionit të Forcave Speciale kanë filluar gjatë konfliktit të Kosovës, në vitin 1999 me detyra të ndryshme si: patrullim në kufirin shtetëror, kryerjen e zbulimit special, grumbullim informacioni dhe detyra speciale për gjatë kufirit. Në vitin 2002 - 2004 forcat speciale dislokohen për të kryer detyra speciale në Afganistan në bashkëpunim me kontingjentin turk nën komandën ISAF, Kabul, Afganistan. Nga viti 2005 - 2008 forcat speciale janë dislokuar në kryerjen e operacioneve në Mosul, Irak, dhe në vitin 2008 FS janë dislokuar me një grup special në Chad, si pjesë e kontingjentit francez në Afrikë.

Nga viti 2010 - 2014 batalioni i Forcave Speciale dislokohet në operacionet luftarake të koduara "Eagle" në Kandahar, Afganistan. Në këtë operacion batalioni ka kryer gjithsej tetë misione luftarake. Në misionin "Eagle 4", fatkeqësisht ka rënë në krye të detyrës Dëshmori i Atdheut Kapiten Feti Vogli. Nga viti 2018 - 2020 batalioni ka kryer 6 (gjashtë) misione asistence ushtarake, në kuadër të RSM-së në Kabul, Afganistan. Nga viti 2016 - 2022



batalioni i Forcave Speciale ka kryer 7 (shtatë) misione në kuadër të mandatit të KFOR-it në Kosovë, ku aktualisht vazhdon misioni i radhës me një grup special.

A disponojmë burime logjistike dhe njerëzore për përbashkëtimin e misioneve që kjo strukturë ndërmerr?

Që një njësi të jetë operacionale sigurisht që burimi njerëzor është më kryesor, ku forcat speciale ka një thënie se: "njerëzit janë më të rëndësishëm se pajisjet". Krijimi i një operatori special nuk është e lehtë, ai kalon në një rrugëtim të vështirë dhe sfidues dhe duke kaluar shumë filtra. Që një operator të jetë plotësisht operacional i duhet afërsisht një kohë 2-3 vite. Aktualisht ne po ndeshemi me një brez që nuk duan të ndeshin shumë vështirësi dhe kjo të them të drejtën na ka kufizuar në gjenerimin e forcës ashtu siç do donim të kishim.

Përveç anës njerëzore, është shumë e rëndësishëm trajnimi dhe pajisjet, ku Forcat Speciale i nënshtrohen një cikli trajnimesh dhe kursesh si; Kursi Bazë i Forcave Speciale (kurs i domosdoshëm për t'u bërë pjesë e FS), kurse funksionale si, kursi i ndërlidhjes, xhenios, snajperit, parashutizmit, zhytjes, zbulimit, njohjes së ushtrive të huaja e të tjera.

Në lidhje me pajisjet, është bërë një progres shumë i madh në drejtim të modernizimit, ku janë hartuar të gjitha kërkesat e nevojshme operacionale për pajisjen e FS-së me teknologji dhe pajisje të reja.

Cili është roli i FS-ve të FARSH-it për t'u përgjigjur ndryshimit të mjedisit të sigurisë në kushtet e luftës asimetrike?

Operacionet Speciale për nga natyra janë operacione të përbashkëta. Forcat e Operacioneve Speciale (FOS) janë të organizuara nga FARSH-i që të jenë të afta të veprojnë në mënyrë të pavarur, të mbështetura/në mbështetje dhe të përbashkët me komponentët ajrorë, detarë dhe tokësorë të FARSH-it, si dhe agjencitë ligj zbatuese, në nivel kombëtar, për përmbushjen dhe realizimin e misioneve të veçanta.

FOS-ët e FARSH-it janë asete strategjike që angazhohen për arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave të veçantë operacionale. FOS-ët komandohen nëpërmjet zinxhirit të tyre të komandim-kontrollit ose nga komandat ku ato janë dhënë në vartësi.

Zakonisht FARSH-i zhvillon OS-të në një Zonë të Përbashkët Operacionale (ZPO) me forcat e tjera ajrore, detare dhe tokësore. Në këto rrethana, komandanti i nivelit operacional krijon efektin më të madh sinergjik për të krijuar unitetin e komandimit, integrimin e forcave në nivelin operacional dhe duke përdorur parimet e marrëdhënieve të njësisë/forcave të mbështetura ose mbështetëse.

Zakonisht OS-të kryhen në mjedise/zona të pasigurta, armiqësore ose të ndjeshme politikisht që krijojnë efekte që mbështesin arritjen e objektivave gjithëpërfshirës strategjiko-operacionale. Këto operacione mund të zhvillohen duke përdorur teknika/kapacitete klandestine dhe të mbuluara/sekrete që kërkojnë operatorë të mirë trajnuar me përvojë në kryerjen e OS-ve. OS-të mund të zhvillohen në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me forcat e njësive konvencionale dhe mund të përfshihen në operacione të përbashkëta nëpërmjet ose me agjencitë e tjera ligj zbatuese, forcat vendase dhe rezerviste.

Nga ndryshojnë misionet klasike nga ato speciale?

Operacionet Speciale (OS) janë veprime ushtarake që kryhen nga forca të mirë pajisura, të stërvitura, të organizuara dhe strukturuar në mënyrë të posaçme, të përbëra me personel të përzgjedhur, që zbatojnë taktika/teknika dhe mënyra përdorimi jo konvencionale. Këto veprime ushtarake mund të zhvillohen përgjatë gjithë spektrit të operacioneve ushtarake në mënyrë të pavarur, me forcat konvencionale ose me agjencitë ligj zbatuese vendase, për të arritur synimin përfundimtar të dëshiruar. Faktorët politiko-ushtarakë mund të kërkojnë përdorimin e teknikave ilegale ose të mbuluara (sekrete), duke marrë përsipër edhe shkallën e një rreziku politiko-ushtarak, që nuk ka lidhje me operacionet e forcave konvencionale.

OS-të japin rezultate të nivelit strategjik dhe operacional, me qëllim mbështetjen e autoriteteve kombëtare në parapraktjen, parandalimin dhe eliminimin e kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare ose zbatohen në operacionet speciale të drejtuara nga NATO/ vendet aleate në zonat e konfliktit, për të arritur efekte të nivelit strategjik dhe operacional, të dëshiruar nga NATO.

OS-të ndryshojnë nga operacionet konvencionale për sa i përket shkallës së rrezikut nga ana politike dhe fizike, teknikat/ taktikat operacionale, mënyrat e përdorimit, si dhe varen nga zbulimi i detajuar operacional dhe përdorimi i asetëve vendase. Personeli i forcave të operacioneve speciale (FOS) i nënshtrohet një procesi të kujdesshëm përzgjedhjeje dhe trajnimit të veçantë për misionin, përtej aftësive bazë ushtarake, për të arritur aftësitë e nivelit fillestar për FOS-ët. Struktura organizative e FOS-ve ka prirjen për të pasur personel të zgjedhur, me pjekurinë profesionale të kërkuar dhe me kapacitete të një niveli shumë të lartë në më shumë se një specialitet ushtarak.

OS-ët janë pjesë përbërëse e fushatave të FARSH-it, ndërkohë që ato mund të zhvillohen edhe në mënyrë të njëanshme, në mbështetje të objektivave të veçantë kombëtarë. Shumica e OS-ve hartohen dhe zbatohen për të shtuar mundësitë e suksesit në fushatat e përgjithshme ushtarake/ jo ushtarake, të cilat zakonisht kryhen duke mbështetur operacionet e FOS-ve. OS-të mund të jenë plotësuese por jo të konkurrueshme dhe të pazëvendësueshme nga forcat konvencionale.

Zhvillimi i suksesshëm i OS-ve mbështetet tek aftësitë speciale të shumanshme individuale dhe të njësive të vogla. Shpesh përdorimi i aftësive dhe metodave jo konvencionale, improvizimit, përshtatjes me mjedisin operacional, duke u vetë-mbështetur, sjell përdorimin e teknikave të reja. Për shkak të strukturës së vogël, kapaciteteve unike dhe vetë-mbështetjes (për një të kohë caktuar), njësitë e FOS-ve i ofrojnë FARSH-it mundësi shtesë për një përgjigje ushtarake/ jo ushtarake, e cila nuk sjell rrezik për përshkallëzimin e konfliktit, që normalisht lidhet me dislokimin e një numri të lartë të forcave konvencionale, të cilat bien në sy.

OS-të mund të zhvillohen drejtpërdrejt kundër një kundërshtari, duke u përbashkuar, në një përplasje të vetme, si goditje direkte kundrejt njave kritike të tij, ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke organizuar, trajnuar dhe mbështetur forca jo të rregullta vendase, nëpërmjet Asistencës Ushtarake (MA). Në të shumtën e rasteve, rezultatet përfundimtare janë me efikasitet të lartë, në krahasim me numrin e personelit të njësive të angazhuara.

Pse Operacionet Speciale janë unike dhe cilat janë parimet e këtyre Operacioneve?

Për realizimin e misioneve të caktuara, komandantët e niveleve taktike, operacionale dhe strategjike duhet të kenë parasysh parimet bazë të operacioneve speciale të mëposhtme:

a. Objektivat. Operacionet Speciale janë të përdorura më së miri atëherë kur mbështesin objektivat e komandantëve në të gjitha nivelet. Vëmendja kryesore e çdo operacioni special është kryerja e misionit që bën të mundur realizimin e objektivave operacionale ose strategjike të komandantit të forcës së përbashkët.

b. Sulmuese. Operacionet speciale, nga vetë natyra, janë sulmuese, sepse vetë ato kërkojnë të jenë proaktive, të godasin ose të përplasen me një kundërshtar, në mënyrë që të detyrojnë ndalimin, dëmtimin, pengimin ose vonimin e veprimeve të tij luftarake.

c. Masive. Operacionet Speciale përqendrohen në efektet e fuqisë së luftimit në kohë kritike dhe në vende të ndryshme për të arritur rezultate vendimtare.

d. Ekonomizimi i forcave. Forcat e Operacioneve Speciale nuk mund të përdorin burimet e tyre të kufizuara për detyra jo të rëndësishme dhe dytësore. Ekonomizimi i forcave është i

rëndësishëm për kryerjen me sukses të operacioneve speciale për shkak të madhësisë së vogël dhe mungesës së aftësive të shumta që janë pjesë e pandarë e reparteve taktike të Operacioneve Speciale.

e. Manovra. Manovra është një element i rëndësishëm i Operacioneve speciale, me qëllim goditjen e kundërshtarit ku dhe kur ai është më i zbuluar dhe i pambrojtur, si dhe për të shmangur forcën e tij.

f. Unifikimi i komandës. Operacionet Speciale kërkojnë unifikim të komandës për të integruar dhe sinkronizuar FS me çdo aspekt të planit të fushatës ushtarake. Arkitektura e komandim-kontrollit të operacioneve speciale shpeshherë i përshtatet secilit mision për arritjen e qëllimit përfundimtar.

g. Sigurimi. Planëzimi dhe kryerja e operacioneve speciale kërkojnë një shkallë shumë të lartë sigurie për mbrojtjen e natyrës së fshehtë që kanë misionet, të cilat shpeshherë kryhen në zona të vetmuara shumë larg në prapavijat armike. Në të njëjtën kohë, FS duhet të balancojnë shqetësimin mbi sigurinë me nevojën e provave të shumta përpara kryerjes së tyre dhe duke integruar operacionin me forcat e tjera. Si përfundim, një planëzim i saktë mbi sigurimin dhe kryerjen e operacionit, është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e jetës së FS.

h. Befasia. Befasia, në shumicën e rasteve është çelësi kyç për kryerjen me sukses të operacioneve Speciale dhe për mbijetesën e këtyre forcave gjatë operacionit. Forcat e Operacioneve Speciale duhet të arrijnë dhe mbajnë befasinë deri në atë shkallë, sa kundërshtari të mos mund të kundërveprojë në mënyrë të efektshme përpara sesa misioni të ketë përfunduar.

i. Thjeshtësia. Ashtu siç kemi thënë, operacionet speciale kërkojnë shpesh pajisje, armatim dhe metoda të sofistikuar, planet që drejtojnë mënyrën e dislokimit të këtyre trupave në operacion, duhet të jenë të thjeshta dhe në mënyrë direkte, me qëllim që të jenë sa më të kuptueshme, që të përballojnë stresin e mjedisit operacional dhe të adoptojnë ndryshimin e situatave

Cilat janë karakteristikat dhe cilësitë e këtyre forcave ushtarake?

Këto forca udhëhiqen nga karakteristika të tilla si integriteti, kuraja, rezistenca, profesionalizmi, përshtatja, puna në grup dhe kapacitetet që zotërojnë këto forca. Të gjitha këto karakteristika lejojnë forcat e operacioneve speciale të kryejnë operacione në bashkëveprim me forcat konvencionale ajrore, detare dhe tokësore, për të përmbushur misionet e tyre.

Përveç karakteristikave të mësipërme, forcat speciale kanë edhe aftësi të tilla si:

Bashkëpunimi. Forcat e operacioneve speciale zakonisht bashkëpunojnë me Ministrinë e Brendshme dhe Decentralizimit, ministrinë dhe agjencitë e tjera të Qeverisë Shqiptare, organizatat qeveritare dhe joqeveritare si dhe FOS-ët e shteteve aleate ose partnere. Operacionet ilegale, të fshehta dhe me shikueshmëri të ulët mund të kërkojnë një koordinim të gjerë ndër-institucional apo midis OJF-ve.

Aftësi fizike dhe profesionale. Forcat speciale i nënshtrohen një procesi ku përcaktohen qartë standardet dhe kriteret e përzgjedhjes në aspektin fizik, intelektual, psikologjik etj. Pas zgjedhjes, ato marrin trajnim të veçantë, sipas misionit, për të rritur profesionalizmin në aftësitë e operacioneve speciale. FS prirën të jenë personeli me më shumë përvojë, shumë prej të cilëve janë kompetentë në më shumë se një specialitet ushtarak.

FS të zgjedhura ruajnë specialitetet rajonale, kulturore dhe gjuhësore. Trajnimet në disa gjuhë të huaja dhe ndërkulturore janë pjesë rutinë e zhvillimit të tyre. Disa prej tyre kërkojnë trajnime të veçanta, të avancuara dhe të larta teknike për misionet e pritura.

Elasticiteti dhe fleksibiliteti. Në mënyrë tipike, FS-të janë të organizuara në grupe të vogla, elastike dhe të shkathëta, që mund të veprojnë pa mbështetjen në mjedise të paqarta, të vështira dhe dinamike për periudha të shkurtra.

Cilët janë disa prej drejtuesve të kësaj njësie ndër vite?

- Kolonel Hysen Ymeri 1998-2001
- N/Kolonel Xhevahir Abdia 2001-2001
- N/Kolonel Bashkim Balla 2002-2005
- Kolonel Ruzhdi Kuçi 2005-2006
- Kolonel Dritan Demiraj 2007-2013
- N/kolonel Qazim Hoxha 2013-2015

- Kolonel Ekland Dauti 2015-2017
- Kolonel Ilirjan Dauti 2017-2018
- N/Kolonel Ramadan karakushi 2018-2020
- N/Kolonel Ajet Jata 2020-2022

Si shihen Forcat Speciale nën reformën e Forcave të Armatosura, vendi dhe roli i tyre si prioritet?

Mjedisi kombëtar, rajonal dhe global i sigurisë po ndryshon shpejt dhe në mënyrë të vazhdueshme. Këto tipare e bëjnë atë vështirësisht dhe të parashikueshëm dhe i japin larmi gamës së rreziqeve mbizotëruese. Dekada e ardhshme parashikohet që rreziqet do të kenë natyrë kryesisht asimetrike dhe hibride të gjeneruara nga aktorë shtetërorë, jo shtetërorë apo nga shtete të dështuara.

Më qëllim parandalimin dhe përballjen me kërcënimet e kohës dhe rreziqet e reja hibride dhe asimetrike si dhe duke marrë shkas edhe nga sfidat e kohës por edhe nevojat urgjente për të pasur një njësi të aftë dhe të dislokueshme, kudo që nevojitet për garantimin e një sigurie më të madhe kombëtare dhe forcimin e stabilitetit në rajon dhe më gjerë, duke shpenzuar më pak para dhe duke rritur bashkëpunimin dhe ndërveprueshmërinë midis agjencive dhe strukturave vendase dhe atyre të NATO-s, forcat speciale janë reformuar dhe strukturuar në njësinë e quajtur Regjimenti i Operacioneve Speciale në dhjetor të viti 2020.

Krijimi i kësaj njësie erdhi si rezultat jo vetëm i faktorëve të mësipërm por edhe si një përgjigje e duhur, për një shtet me kapacitete operacionale speciale modeste dhe anëtar i NATO-s, erdhi si rezultat i përshtatjes doktrinoe dhe përmbushjes së detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s.

Kjo strukturë ka si qëllim kryerjen e gjitha detyrave të spektrit të Operacioneve Speciale në të gjitha mjediset e ndjeshme operacionale. Kjo strukturë i ofron lidhshpirt politik-ushtarak një aftësi unike për të parandaluar, përballuar dhe eliminuar të gjithë kërcënimet dhe rreziqet që cenojnë Sigurinë Kombëtare, rajonale dhe të Aleancës (NATO).

Themelimi i ROS është bazuar në kriteret përcaktuese të doktrinës së përbashkët të forcave të Operacioneve Speciale AJP3.5, por edhe në nevojën për t'iu përshtatur ndryshimeve të reja të kohës.

Së fundmi dua të theksoj se vendi dhe roli i forcave dhe njësieve speciale sa vjen e rritet. Të gjitha vendet po shtojnë investimet në këto forca dhe po rrisin numrin e tyre. Nga mësimet e nxjerra nga dy konfliktet e fundit, si Armeni-Azerbajxhan dhe Ukrainë-Rusi, mësojmë se forcat speciale kanë ndryshuar fate betejash dhe fatin e luftës, ndaj ato sot konsiderohen aset kombëtare dhe si të tilla sjellin benefite të mëdha për vendin nëse përdoren në mënyrë efektive.

Kush është vizioni juaj për të ardhmen e Forcave Speciale?

Në një kohë kur kërcënimet janë shumë modern dhe asimetrik, sigurisht që nevojitet një njësi speciale e aftë për të kryer detyra speciale në të gjithë spektrin e plotë të luftimeve. Një njësi e aftë për të kryer detyra speciale nga toka deti dhe ajri. Kjo do të ishte e pamundur pa një personel të mirë trajnuar, mirë pajisur dhe të mirë motivuar.

Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe si i tillë ne kemi detyrime në kuadër të saj dhe përmbushja e detyrimeve do të ishte së pari përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe kjo do të përmbushte edhe kushtet e detyrimeve në kuadër të aleancës.

Që të ecim në rrugën e duhur, duhet patjetër të harmonizojmë rrugën tonë me atë të ecjes së forcave speciale të NATO-s dhe kjo kërkon që të jemi në sinkron të zhvillimeve taktike, teknike, doktrinoe dhe të koncepteve të reja për forcat speciale.

Investimi në rritjen e kapaciteteve njerëzore do të jetë "thembra e Akilit" në zhvillimin e mëtejshëm të njësisë së FS, kjo kërkon që ne të rrisim aftësitë në gjuhën operacionale të NATO-s, në anën profesionale dhe speciale të njësisë.

Përmbushja dhe realizimi me sukses i misionit dhe detyrave të forcave speciale është dhe do të mbetet prioritet në punën tonë, krahas krijimit të kushteve më të mira për jetesë, stërvitje dhe mbështetje të vazhdueshme në operacione.

Shpresoj se në një periudhë kohore të shpejtë ne do të kemi një forcë speciale me të gjitha parametrat e kërkuara dhe plotësisht të ndërveprueshme me forcat speciale të NATO-s.

Shkolla Shqipe e Vashave, e krijuar prej pluhurit të shkretëtirës në shtyllën e fortë, për të ndriçuar kombin

13 vite më parë, më 23 tetor 1891, u hap "Shkolla e Vashave" në Korçë nga familja e njohur Qiriazit.

Hapja e kësaj shkolle shënonte një hap me rëndësi pasi do të edukonte vajzat, të cilat për kohën nuk e gëzonin privilegjin për t'u arsimuar, sidomos në gjuhën amtare.

Shkolla e Vashave ka qenë një shkolle me standarde europiane për kohën, me një bibliotekë mjaft të pasur dhe laborator kërkimor për shkencat e natyrës.

"Historia e shkolles së parë shqiptare për vasha, - shkruan në kujtimet e veta Sevasti Qiriazit, - është si një romancë plot aventura. Është historia e luftës kundër injorancës, që pati arritje të rëndësishme dhe me vlerë. Ishte si një re pluhuri e krijuar aty-këtu prej erës që u hoq nga shkretëtira, ku kishte lindur dhe papritur u shndërrua si me magji në një shtyllë të bukur e të fortë për të ndriçuar e stolitur kombin."

Si sot, më 23 tetor 1891, 126 vjet më parë, në qytetin e Korçës hapi dyert e para shkolle shqipe për vajzat, e cila u bë vatër e arsimit shqiptar dhe e ideve për liri e përparim kombëtar. Ajo shkolle mbledhi rreth saj patriotët më të shquar, të cilët punuan me mish e me shpirt për gjuhën, arsimin dhe përparimin e kombit shqiptar. Siç tregon Sevastia në kujtimet e veta, çdo gjë fillon me një ide dhe kjo ide "ekzistoi në mendjen e vëllait tim të ndjerë, Gjerasim, një njeri i virtytshëm, i cili e shihte nevojën e madhe për një institucion të tillë që do të shërbente për emancipimin e grave shqiptare.

Gjerasim Dhimitër Qiriazit, një shqiptar nga Manastiri, lindur në një familje me origjinë nga Kolonja, kishte mbaruar Seminarin Teologjik Ungjillor në Samokov, Bullgari, dhe punonte në atë kohë pranë "Shoqërisë Biblike për Britaninë dhe Vendet e Huaja", e cila në vitin 1827 u kishte dhënë shqiptarëve për herë të parë në gjuhën e tyre të plotë "Dhiatën e Re" me përkthimin e Vangjel Meksit.

Gjerasimi kishte bërë disa udhëtime në viset shqiptare, si në Korçë, Berat, Durrës, Kavajë, Vlorë e Shkodër për të predikuar shqip ungjillin, lajmin e mirë. Në këto udhëtime ai kishte parë nga afër gjendjen e mjeruar të popullit, kishte ndjerë dëshirën e zjarrtë

të njerëzve për arsim në gjuhën amtare dhe zemra e tij ishte prekur thellë. "Ishte e natyrshme, - shkruan Sevastia në kujtimet e veta, - që ideja të vinte prej tij, se ai arrinte të shihte të mirat e edukimit në tokën tonë dhe fatkeqësitë pa të".

Me dëshirën e zjarrtë për të ndihmuar sadopak popullin e tij, Gjerasimi bashkë me të shoqen, Athinanë, vendoset në Korçë në vitin 1890 dhe fillon të predikojë në gjuhën shqipe, ku gjeti ndër njerëzit një etje të madhe për gjuhën shqipe. Nga ky shkak fitoi simpatinë dhe përkrahjen e shumë patriotëve shqiptarë, veçanërisht të Jovan Cico Kosturit, Orhan Pojanit, Thimi Markos, Petro Nini Luarasit e Thanas Sinës, të cilët e lutën që të predikojë shqip në ndërtesën e Mësonjëtores së Parë Shqipe, dhe armiqësinë e klerit grek dhe autoriteteve osmane, të cilët e panë si rrezik për realizimin e planeve të tyre antishqiptare dhe filluan përndjekjet, kontrollet, bastisjet, mallkimet.

Më 23 tetor 1891 Gjerasimi dhe e motra Sevastia, e cila sapo kishte mbaruar studimet në Shkollën Amerikane për Vajza në Stamboll (themeluar nga "Bordi Amerikan i Komisionerëve për Misionet e Huaja"), të vendosur për të përmbushur nevojën e popullit shqiptar për arsim në gjuhën amtare, çelën në Korçë të parën shkolle shqipe për vajza.

Në ceremoninë e diplomimit të Sevastisë në Stamboll, kishte qenë i pranishëm dhe Naim Frashëri si përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, i cili i kishte thënë Sevastisë: "Motër, punë më të mirë dhe më të vyer nuk mund të bësh për Shqipërinë e mjerë sesa kini vendosur të bëni bashkë me vëllanë për emancipimin e grave të vendit tonë të shkretë. Detyrat tënde fillojnë tani dhe po të jesh besnike, këmbëngulëse dhe e vullnetshme do të arrish të kryesh vepra të mëdha për kombin."

Shkolla u çel në shtëpinë e Grigor Eliadhe Frashërit, pranë kishës së Shën Gjergjit, shtëpi në të cilën Gjerasimi me të shoqen dhe Sevastia banonin me qira. Sevastia kujton se: "...atë ditë erdhën tri vajza mjaft inteligjente e premtuese, vetëm për shkak të lajmit që ishte përhapur në qytet. Fillimi ishte shumë i thjeshtë, por kur mbyllëm vitin shkollor, në qershor, numri kishte



arritur në 27 nxënese, më shumë nga çfarë kishim guxuar edhe të shpresonim si fillim lidhur me punimin e një toke kaq të fortë. Por asnjë vepër e mirë nuk ikën pa lënë gjurmë”.

Polikseni (Dhespoti) Luarasi, e shoqja e patriotit Kristo Luarasi, një nga tri nxënëset e para të kësaj shkolle dhe e diplomuara e parë e saj e kujton kështu hapjen e shkollës shqipe të vashave: “Shkolla u hap në një dhomë të shtëpisë ku banonte Gjerasim Qiriaz. Dhomën e ktheu në një sallë mësimi: vuri ca bango sipas moshës së nxënësve, rregulloi një katedër për mësonjësin, një dërrasë të zezë për të shkruar dhe harta gjeografike nëpër mure. Kështu lindi bërthama e parë e shkollës shqipe të vashave në Korçë.”

Sevastia shkruan në kujtimet e saj se shkolla iu nënshtrua qysh në ditët e para sulmeve të injorancës, besëtytnisë, tiranisë dhe përndjekjes. Qeveria turke i ndalonte familjet myslimane t’i dërgonin vajzat në këtë shkollë, duke i kërcënuar prindërit me burgim dhe me syrgjynosje, ndërsa kisha greke i kërcënonte familjet ortodokse me mallkime, ç’kishërim, moskryerje të shërbesave fetare, veçanërisht të ceremonive mortore. Por, pavarësisht nga këto, kjo shkollë arriti që jo vetëm të mbijetonte, por edhe të lulëzonte, duke u dhënë dije dhe frymëzim shumë vashave, numri i të cilave sa vinte e rritej më shumë.

Në shtator 1892 shkolla u çel në ndërtesën e re që bleu Gjerasimi prej zotit Petrika Peço, në lagjen e re aty afër vendit që quhej “Çezma e Arave”. Aty vazhdoi derisa u mbyll, më 10 korrik të vitit 1914. Kjo ndërtesë është edhe sot në Korçë. Në periodikun e Bordit Amerikan të Komisionerëve për Misionet e Huaja “Lajmëtari Misionar” të muajit nëntor 1892, botohet një letër e z. Berd, drejtues i Misionit Amerikan të Manastirit, që mban datën 13 shtator, ku thuhet: “Rreth 3 javë më parë zoti Qiriaz bleu një shtëpi dhe një copë tokë në Korçë për 120 lira turke. Pjesa e sipërme e shtëpisë s’ka qenë mbaruar ndonjëherë dhe disa nga muret janë anuar nga një tërmet.”

Po në këtë periodik të muajit shkurt të vitit 1893,

botohet një letër e Gjerasimit, që njofton përparimin e punës në Korçë, në Shqipëri, ku përmend me kënaqësinë më të madhe ndërtesën e re për kishë dhe shkollë, e cila ka qenë blerë dhe pajisur, me një sallë që mban 100 dëgjues. Kostoja e ndërtesës, përfshirë riparimet, ishte vetëm 165 lira turke dhe mbetet vetëm një borxh i vogël. Kontributet për punën u dërguan nga Samokovi dhe nga vende të tjera (nga miqtë e Gjerasimit).

“Gjithë orenditë shkollore, - kujton Sevastia, - ishin: dërrasa e zezë, bankat, stolat, por tipari mbizotërues i shkollës ishte fryma e të qenit i kënaqur dhe me qëllime në jetë. Kur nuk kishim banka aq sa na nevojiteshin, nxënëset ulëshin në dyshtemenë e larë mirë dhe përdornin stolat për banka.”

Pas blerjes së ndërtesës u ngrit një valë e re përndjekjesh, madje u provua edhe eliminimi fizik i Gjerasimit. Blerja e ndërtesës tregonte një veprimtari të përhershme, gjë që për autoritetet osmane dhe greke ishte e papranueshme. Megjithatë, shkolla përhapte dritë në të gjithë qytetin. Mësueset e shkollës punonin jo vetëm me nxënëset, por pasditeve edhe me gratë e qytetit, duke u mësuar atyre

shkrim e këndim. Madje, Sevastia kujton një ngjarje, ku një nga policët që ishte vënë të mos lejonte nxënëset të vinin në shkollë, kishte mësuar prej tyre të lexonte shqip. Si pasojë e transferuar në një vend tjetër, por ai para se të largohej, tha: “Tani që unë kam atë për të cilën zemra ime kishte dëshirë të zjarrtë, nuk ka fare rëndësi për mua se ku më çojnë.” Kështu, kjo shkollë përhapte dritë në gjithë qytetin.

Viti shkollor 1892-1893 u mbyll me sukses të madh dhe kishte gjithsej 53 nxënese. Zoti Berd nga Manastiri, shkruan me këtë rast në periodikun “Lajmëtari Misionar” të muajit shkurt 1893: “Qershorin e shkuar Shkolla Shqipe e Vashave në Korçë u mbyll me program për publikun, ku nxënëset treguan aq përparim sa habitën shumë nga miqtë e tyre.

Personeli i shkollës në vitet e para, po t’u referohemi kujtimeve të Polikseni Luarasit, përbëhej nga: Gjerasim Qiriaz, drejtor, Sevasti Qiriaz, Thanas Sina Postenani dhe Fanka Eftim, e cila, siç kujton Efigjeni Pendavinji, një tjetër ish-nxënëse e kësaj shkolle, megjithëse ka qenë bullgare, e kishte mësuar shqipen shumë mirë dhe e ka dashur Shqipërinë si një shqiptare e flaktë. Mësues të tjerë që kanë dhënë mësim në këtë shkollë janë edhe patriotët e shquar Grigor e Katerina Cilka, Gjergj Qiriaz, Kristo Dako, Parashqevi Qiriaz, nxënese të kësaj shkolle Polikseni Luarasi, Helidhona Titu (Falli), amerikanët Fineas e Violet Kenedi të Misionit Amerikan, etj.

Mësimi kryesor, - kujton Polikseni Luarasi, - ka qenë gjuha shqipe, për të cilën kujdesej vetë drejtorja. Punës së dorës i jepej rëndësi e madhe, nxënëset e kësaj shkolle u bënë mjeshtrë në punë dore, bile ato i tejkaluan vashat e shkollës greke. Gjithashtu rëndësi i vihej mësimi të këngëve patriotike shkruar kryesisht nga Gjerasim Qiriaz, i cili u vinte dhe muzikë.

Helidhona Titu (Falli) kujton: “Mësimet në klasat e fillores i bënë në gjuhën shqipe dhe, meqë nuk kishim libra, mësuesit na i përgatitnin në një lloj litografi.

Pas vdekjes së Gjerasimit, në vitin 1894, vendin e tij e zuri i vëllai Gjergj Qiriaz i më pas Thanas Sina e



Grigor Cilka dhe secili dha një kontribut të shquar për përparimin e kombit shqiptar:

Në vitin 1895, Bordi Amerikan njofton se shkolla e vajzave pa konvikt, e vetmja shkollë e vajzave që përdor shqipen, është drejtuar shkëlqyeshëm prej mësueseve vendëse. Provimet e saj në mbyllje të vitit tërhoqën një numër të madh nga qytetarët më të mirë të Korçës. Po ashtu në vitin 1898, zoti Berd nga Manastiri njofton se aktualisht nuk ka më shumë se 5 shkolla shqipe dhe pjesa më e madhe e tyre janë të vogla dhe të varfra. Shkolla protestante e vashave në Korçë po bën një punë të mirë për vajzat shqiptare dhe po lulëzon.

Në vitin 1900, pas shkollimit në Seminarin Teologjik të Unionit në Nju-Jork, Grigor Cilka kthehet së bashku me të shoqen Katerina (Stefanova) Cilka dhe punojnë së bashku në Shkollën Shqipe të Vashave. Katerina Cilka, një grua bullgare me zemër të madhe, punoi pa u lodhur për përparimin e kombit shqiptar. Në vitin 1921 ajo u bë drejtoresha e spitalit të parë në Tiranë dhe pastaj drejtoresha e Strehës së parë Vorfnore në Shqipëri.

Në raportin vjetor të Bordit Amerikan të vitit 1901, thuhet se shkolla e vajzave me konvikt (tashmë) në Korçë, gjithashtu ka pasur një vit të begatë. Mësueset në këtë shkollë janë të gjitha vendëse. Zonjusha Qiriazit lëvdohet shumë nga misionarët e Manastirit dhe të Selanikut, që e kanë vizituar shkollën, për aftësinë me të cilën ajo e ka drejtuar këtë institucion. Ky është viti i parë që kanë marrë konviktore. Numri i tyre ishte pesë. Në provimet e mbylljes ishte i pranishëm një auditor i madh, ku hynin edhe disa bejlerë shqiptarë, e mes tyre ishte guvernatori i qytetit, i cili mbajti një fjalë lavdëruese për punën e shkollës."

Në vitin 1904 fillon punën si mësuese edhe motra më e vogël e Gjerasimit dhe Sevastisë, Parashqevi Qiriazit, e cila kishte mbaruar po Shkollën Amerikane të Vajzave në Stamboll. Ajo zëvendësoi si drejtoreshë Sevastinë gjatë vitit 1905-1906. Në vitin 1908 ajo themeloi në Korçë shoqërinë e parë të grave dhe vajzave "Yll" i Mëngjesit".

Në vitin 1907 autoritetet osmane u përpoqën ta mbyllnin shkollën, por pa sukses. U tentua përsëri të mbyllej në vitin 1910, por tashmë shkolla ndodhej nën administrimin dhe mbrojtjen direkte të Misionit Amerikan, i cili kishte një marrëveshje me Portën e Lartë për ushtrim të lirë të veprimtarisë. Prandaj, zoti Kenedi, përfaqësues i këtij misioni në Korçë protestoi dhe refuzoi që kjo shkollë të mbyllej. Fatkeqësisht, kjo fole kom-

bëtare që u bëri ballë kohërave të turbullta të luftërave ballkanike u mbyll, më 10 korrik 1914, kur kishte nisur Lufta e Parë Botërore dhe ushtria greke kishte hyrë në Korçë. Zoti dhe zonja Kenedi u dëbuan, Parashqevia dhe Sevastia, tashmë e martuar me patriotin Kristo Dako, u shtrënguan të linin atdheun. Megjithatë ata u rikthyen në Shqipëri në vitin 1922 për të çelur në Tiranë "Institutin Kyrias-Dako", e cila vazhdoi traditën e mirë të shkollës shqipe.

Që nga viti i parë i çeljes së kësaj shkolle, 1891, deri në vitin 1913, numërohen 23 vite shkollore. Kanë studiuar 1028 nxënëse. Numri mesatar i nxënësive ka qenë rreth 44 nxënëse në vit.

Viti 1905-1906, viti me numrin më të madh: 87 nxënëse. Viti 1904-1905 me numrin më të vogël: 19 nxënëse. Nga kjo shkollë u diplomuan gjithsej 20 nxënëse deri në vitin 1913. Nxënësja e parë e diplomuar është Polikseni Dhespoti 1895. Të diplomuarat e fundit në vitin 1913 janë: Theodora Ciko, Theodota Kristo, Ksanthipi Qelesi. Internati (konvikt) i shkollës u çel më 1900 me 5 nxënëse: Ollga Themili, Olimpi Gorguzi, Olimpi Todi, Helidhoni Titu, Thomaidha Llazo.

Nuk është e rastit që mësuesit e kësaj shkolle janë ndër patriotët më të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare. Ata i gjen në ballë të luftës për liri e arsim kombëtar e në krye të ngjarjeve më të rëndësishme të atyre viteve. I gjen gjithmonë të orientuar drejt dhe në krahun progresist, duke bërë sakrificat të mëdha: i gjen mësues në shkollën shqipe, përkthyes e shpërndarës librash në gjuhën amtare, propagandues të ideve kombëtare, hartues abetaresh e gramatikash, tekstesh shkollore, pjesëmarrës në Kongresin e Alfabetit, 1908, pjesëmarrës në Kongresin e Elbasanit që solli çeljen e shkollës pedagogjike (normale), luftëtarë politikë, përkrahës të shtetit shqiptar më 1912, përkrahës të qeverisë së Vidit. Ata i gjen gjithmonë duke kontribuar me sakrificat atje ku ka një copë Shqipëri.

Në parathënien e autobiografisë së Sevasti Qiriazit, botuar së fundi, studiuesja e saj zonja Dana Stucky citon Sevasti Qiriazin, që thotë: "I quaj heronj ata që sakrifikojnë veten për hir të të tjerëve dhe jo ata që sakrifikojnë të tjerët për hir të vetes."

Kjo sakrificë e këtyre njerëzve na bën të përkujtojmë sot shkollën shqipe, për të mos e harruar sa shumë mund e gjak është derdhur për arsimimin dhe emancipimin e këtij kombi.



Banda Kombëtare "Vatra" e krijuar në Worcester, Mass. USA

Orkestra Frymore E FORCAVE TË ARMATOSURA, simbolika e shtetit shqiptar

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura është trupa artistike profesioniste e FA-së, e përbërë nga kontingjente të përzgjedhura muzikantësh të talentuar.

Si formacion muzikor, ajo u krijua më 18 tetor 1944, në fshatin Priskë të Tiranës, ku me urdhër të Shtabit të Korparmatës së Parë të

Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u grumbullua një grup i madh muzikantësh partizanë dhe u formua orkestra frymore e këtij formacioni të madh partizan. Pas Çlirimit, kjo orkestër u plotësua me të gjithë elementet e nevojshme të një bande muzikore moderne. Në fillim ajo u quajt Orkestra Frymore e Ushtrisë Kombëtare dhe më vonë Orkestra frymore e Ushtrisë Popullore.

Ajo është pjesë e rëndësishme

e ceremonive zyrtare të shtetit shqiptar, që i jep tonin solemn momenteve të zbatimit të protokollit shtetëror. Që nga krijimi i saj e deri më sot, ajo ka një histori shumë të pasur aktiviteteve të rëndësishme që përbëjnë edhe pjesën më të qenësishme të krenarisë së saj legjitime. Aktivitetet artistike të realizuara prej saj janë shtuar, veçanërisht pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, pjesë e së

cilës janë edhe Forcat e Armatosura shqiptare, pas vitit 2008.

Pararendëse e Bandës Muzikore "Vatra", që frymëzoi vullnetarët shqiptaro-amerikanë, pjesëmarrës në Luftën e Vlorës 1920

Zanafilla e këtij formacioni kompleks muzikor, në fakt qëndron në vetë shpirtin luftarak të Kombit shqiptar, në historinë e tij të luftërave shekullore kundër pushtuesit të huaj. Rituale të kahershme kur binin trimat në luftë, apo kur ata varroseshin me të gjitha nderet që iu takonin, më pas shoqëroheshin nga këngët e trimërisë, që brenda tyre kishin tinguj që të bëjnë të ndjehesh krenar. Kështu, një moment i rëndësishëm që evidenton qëllimin dhe misionin e madh që ka pasur Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura në historinë pararendëse të saj, ka qenë viti 1920, dhe pikërisht Lufta e Vlorës. Me këngët e saj, Banda Muzikore "Vatra" mbajti lart moralin e forcave që luftonin furishëm në Tepelenë, Drashovicë dhe kudo përreth qytetit të Vlorës. Kjo luftë e pashembullt, ku luftonte një popull i vogël dhe i paarmatosur me një fuqi të madhe, kishte marrë përmasat e një beteje epike. Dhe po epike u bë edhe kënga "Vlora-Vlora", simboli i kësaj lufte: "Vlora, Vlora, Vlora, Vlora./ Rroki armët, bëja fora! / Vlora, Vlora, Vlora, Vlora, / Bjeri më të lumtë dora!". Dhe siç dihet, kjo këngë simbol, e kënduar nga Banda "Vatra" shoqëroi Komitetin "Mbrojtja Kombëtare" dhe luftëtarët popullorë, më 3 shtator 1920, në manifestimet e fitores së Luftës së Vlorës.

Në vitin 2020, u bë dekorimi i kësaj Orkestre në 100-vjetorin e Luftës së Vlorës, nga institucionin i Presidentit të Republikës, me titullin e lartë "Kalorësi i Urdhrit të Flamurit".

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura mbart simbolikën e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të lidhura ngushtësisht me të. Kjo bandë është e djeshmja dhe e sotmja e një tradite të bukur muzikore shqiptaro-amerikane, sepse zanafillën e ka në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me krijimin e Bandës Kombëtare "Vatra" nga Thoma Nasi, trashëgimia e të cilës vijon sot, pas 78 vitesh, me Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura. Ky vlerësim është

nderim për të gjithë anëtarët e saj dhe drejtuesin Thoma Nasi, të cilët lanë Amerikën për të ndihmuar Atdheun, që deshën mbi gjithçka lirinë për vendin e tyre dhe që e shprehën këtë dashuri me muzikën e tyre.

Edhe pse gjatë pushtimit nazist, gjermanët i ndaluan veprimtaritë e saj, dhe në vitin 1943 banda zyrtare shqiptare u shpërndo.

Riorganizimi, dhe lançimi i formacioneve korale e muzikore dhe i institucioneve të reja madhore e bashkëkohore gjatë viteve 1950 - 1990 e në vazhdim patën zhvillim dhe prurje të reja.



Thoma Nasi, shqiptari, patrioti dhe muzikanti i chekur shumëplanësh

Roli i tij vlerësohet si përcaktues, sublim në shumë aspekte të Historisë së Muzikës Shqiptare, por edhe të angazhimit të tij të drejtpërdrejtë patriotik në marrëdhënie me konceptin e tij largpamës, se si ndikon edukimi emancipues kulturor e artistik në zhvillimin e ndërgjegjes dhe frymëzimit kombëtar: Për këtë, në libër aludohet paravolia se ndikimi i veprimit muzikor të Nassit tek entiteti shqiptar mund të krahasohet me rolin dhe influencën që patën kompozitorë të famshëm të tillë si Beethoven, Mozart, Verdi, Liszt, Çajkovski, Shtraus, Puçini, Stravinski, Dvorak, Sibelius, etj., në rritjen dhe forcimin e identitetit dhe krenarisë së kombeve të tyre. Me të drejtë, sepse edhe përfshirja e Thoma Nassit në arenën kombëtare të zhvillimeve muzikore shqiptare,



sidomos në fushat e kompozimit të këngëve patriotike e himneve, këngëve qytetare e lirike me rrënjë të forta në traditën muzikore qytetare e popullore shqiptare, si dhe sjelljes ndaj muzikës simfonike, por duke e ridimensionuar atë; apo aftësia dhe pasioni i tij për të organizuar shoqëri kulturore artistike, banda, formacione të tjera muzikore e kulturore patën në të gjithë kombin shqiptar tërheqjen magnetike të një fuqie të shpejtë e të gjerë në çdo skaj të vendit e popullit tonë.

Thoma Nassi, njihet si muzikanti i parë shqiptar i shkolluar në SHBA, gjithashtu si teoricieni, studiuesi, vlerësuesi e parashikuesi i zhvillimeve të muzikës bashkëkohore shqiptare, si botuesi i disa prej perlave të këngëve e muzikës shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX, si edukatori dhe pedagogu i disa brezave e shkollave muzikore dhe evidentuesi i artistëve të talentuar shqiptarë; pse jo edhe si shkruar e orator erudit i artikujve e fjalimeve entuziaste e manifeste të botëkuptimit të tij properëndimor; ku veçohet p.sh. fjalimi i tij në Universitetin e Harvardit, Cambridge Mass., me studentët shqiptaro-amerikanë në vitin 1960, i cili mund të konsiderohet edhe si testamenti moral që ai i linte bashkëkombësve të vet në atdhe, apo mërgim për rolin dhe detyrimin e madh që duhet të marrë çdokush me kontributin intelektual e profesional ndaj zhvillimit e prosperitetit kombëtar: etj. Njeri i lëvizjeve dinamike, i fantazisë, i zhdërvjelltësisë, armik i qetësisë, i rutinës dhe plogështisë, artist me talent e intuitë të hollë për misionin e tij artistik e qytetar, promotor, aktiv e me një trysni të madhe përgjegjësie ndaj vetes.

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura është manifesti frymëzues i historisë së muzikës Shqiptare.

KONTRIBUTI SHQIPTAR në panteonin e VLERAVE BOTËRORE

BEBE REXHA

Këngëtarja, tekst-shkruesja dhe producentja ka rrënjë shqiptare. Prindërit e saj shqiptarë nga Dibra, Maqedoni, u zhvendosën në Brooklyn në New York, ku edhe lindi Bebe, më 30 gusht në vitin 1989.

Bleta Rexha është bërë e njohur me këngën "Take Me Home" nga Cash Cash dhe "Hey Mama" nga David Guetta, gjithashtu ajo është vokalistja kryesore e grupit amerikan "Black Cards" i krijuar nga Pete Wentz dhe ka qenë kantautore e këngës nr. 1 në "Billboard Hot 10", me këngën "The Monster" nga Eminem.


Rexha filloi të merrej me muzikë që në moshën 4-vjeçare, dhe vazhdoi të ndjekë dashurinë e saj për muzikën nëpërmjet studimit në shkollën "Tottenville High School" në Staten Island, duke marrë pjesë në muzikalet si "Hello, Dolly!", "Jesus Christ Superstar" dhe "Fid-

ler on the Roof". Ajo është inspiruar nga muzikantë si Stevie Wonder, Tori Amos, John Legend, dhe The Temptations. Rexha fitoi "Best Teen Songwriter" ("Tekst-shkruesja e Re më e Mirë") në përvjetorin e "New York Grammy Day" nga "National Academy of Recording Arts & Sciences", që i dha asaj mundësinë të takojë shumë prodhues të suksesshëm të muzikës.

Bebe Rexha është një artiste që premtion shumë në skenën e muzikës amerikane, e cila dëshiron të përhapë një opinion pozitiv mbi jetën e të rinjve dhe të grave.

ANA OXA

Anna Oxa (Ilirjana Hoxha) lindi në Bari, më 28 prill 1961, nga nënë italiane dhe baba shqiptar (Qazim Hoxha, emigrant shqiptar në Bari). Filloi të këndojë si profesioniste në moshë shumë të re. Vetëm 17 vjeçe



u klasifikua në vendin e dytë të Festivalit të Sanremos 1978 me këngën "Një emociion i vogël".

Iliriana ka vite që njihet në Itali me emrin Anna Oxa, emër me të cilin ajo edhe ka ndërtuar karrierën e saj muzikore.

Sot 61-vjecare, Anna Oxa ka ditur të ndërtojë personalitetin e saj. Fituese dy herë e festivalit "Sanremo", festivali më prestigjioz i muzikës në Itali, pjesëmarrëse në "Eurovizion" për Italinë, Anna Oxa është një rebele në stilin e saj muzikor por edhe një grua e cila kur del në televizion, është gjithmonë protagonistja e skenës.

Aktive në muzikë qysh në vitin 1978, ajo debuton në Sanremo me këngën "Un Emozione Da Poco" dhe që atëherë, Anna Oxa del në skenë dhe italia mahnitet.

Ajo ka realizuar mbi 15-të albume në karrierën e saj muzikore, secili i radhitur mirë e më mirë në Europë. E nisi me albumin "Oxanna" më pas me "Oxa", "Pensami per te", "Di Questa Vita".

Ajo fitoi dy herë në festivalin e Sanremos : në vitin 1999 me këngën "Senza pietà" dhe në vitin 1989 me "Ti lascerò" (duet me Fausto Leali). Me Fausto Leali-n në vitin 1989 mori pjesë në Eurovision, ku ata përfaqësuan Italinë me këngën "Avrei voluto" dhe morën vendin e nëntë. Ajo ishte prezantuese e festivalit të Sanremos së bashku me Pippo Baudo në vitin 1994. Ishte po ashtu ndër të tjera edhe moderatore e shfaqjes së njohur italiane "Fantastico" në vitet 1988 dhe 1989. Në vitin 1979 mori pjesë në filmin "Maschio, femmina, fiore, frutto" nën regjinë e Ruggero Miti-t.

ERMAL META

Ermal Meta është një këngëtar dhe kompozitor shqiptaro-italian. Ai u transferua në Itali nga Shqipëria në moshën 13-vjeçare, duke debutuar si kitarist për grupin "Ameba4", i cili mori pjesë në seksionin Newcomers në Sanremo 2006. Katër vjet më vonë, ai mori pjesë në të njëjtën kategori në Sanremo 2010 si frontmeni i grupit "La Fame di Camilla".

Ai e filloi karrierën e tij solo pasi shkroi disa këngë për artistë të tjerë italianë. Në vitin 2017 përfundoi në vendin e tretë në kategorinë Campioni në Sanremo me këngën "Vietato morire", duke fituar edhe çmimin e kritikës "Mia Martini".

Ai fitoi "Sanremo 2018" së bashku me Fabrizio Moro dhe përfaqësoi Italinë në "Eurovision Song Contest 2018" në Lisbonë me këngën "Non mi avete fatto niente", duke përfunduar në vendin e 5-të.

Ermali u rikthye në Sanremo në vitin 2021 me këngën "Un milione di cose da dirti". Megjithëse u rendit i pari në pjesën më të madhe të festivalit, ai përfundoi në vendin e 3-të, duke marrë gjithashtu çmimin "Giancarlo Bigazzi" për Arranzhmanin më të Mirë.

ENTELE FURERAJ

Eleni Foureira ka lindur në vitin 1987 në Shqipëri dhe është këngëtare dhe aktore e muzikës pop. Ajo e filloi karrierën e saj solo në vitin 2010 me publikimin e albumit të saj të parë. E quajtur "Mbretëresha e Popit", këngëtarja ka pasur disa suksese si në Greqi ashtu edhe në Qipro.

Kënga e Elenit "Chica Bomb", një bashkëpunim me Dan Balan, u bë hit veror në vitin 2010. Në vitin 2014 Eleni u shfaq në "Mad Video Music Awards" së bashku me J Balvin, këngëtarin e hitit "Tranquila", i cili do të kalojë 100 000 000 shikime në YouTube.

Vitet e fundit Eleni ka publikuar këngë në greqisht dhe anglisht dhe në vitin 2017 shënoi një hit të ri ndërkombëtar me këngën "Send For Me", një bashkëpunim me producentin dhe reperin e suksesshëm A.M. SNIPE.

Përveç karrierës së saj muzikore, Eleni ka qenë edhe gjyqtare në versionin grek të "So You Think You Can Dance". Ajo gjithashtu ka bërë turne të shumta në Ballkan dhe ka punuar në industrinë e modës. Performanca e saj në edicionin 2014 të "MAD Video Music Awards" mori mbi 11 milionë shikime në YouTube. Ajo është një artiste shumë e dashur në Greqi, ku edhe filloi karrierën e saj, si pjesë e gupit "Mystique". Në vitin 2018 ajo mori pjesë në Eurovision duke përfaqësuar Qipron.



Sekretari i Përgjithshëm: Moment kyç për sigurinë tonë

Përshtati: Mimoza Golikja

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s u takuan në Bruksel më 12-13 tetor 2022 për të rritur mbështetjen për Ukrainën dhe për të vazhduar forcimin e mbrojtjes së NATO-s, në sfondin e përshkallëzimit më të rëndësishëm të Rusisë që nga fillimi i konfliktit në Ukrainë. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se "ky është një moment kyç për sigurinë tonë".

Mobilizimi i pjesshëm i Rusisë, përpjekjet e paligjshme të aneksimit, sulmet pa dallim në qytetet e Ukrainës dhe kërcënimet bërthamore përfaqësojnë përshkallëzimin më serioz të luftës që nga pushtimi në shkurt. "Gjatë javëve të fundit, ne kemi parë përshkallëzimin më serioz të luftës që nga pushtimi në shkurt. Rusia po mobilizon dhjetëra-mijëra trupa të reja. Ata po përpiqen të aneksojnë ilegalisht toka të reja ukrainase dhe ne kemi parë sulme pa dallim kundër qyteteve të Ukrainës", - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. "Ne gjithashtu kemi dëgjuar kërcënimet e fshehura bërthamore që vijnë nga Moska. E gjithë kjo e bën këtë përshkallëzimin më serioz që nga shkurti", - tha ai.

Ministrat diskutuan se si të rrisin mbështetjen për Ukrainën dhe si të vazhdojnë të forcojnë mbrojtjen e aleatëve, përfshirë rimbushjen e rezervave dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Mesazhi nga aleatët e NATO-s në takim ishte se Aleanca është e palëkundur në mbështetjen e saj për Ukrainën, se është e përgatitur për një afat të gjatë dhe se do të mbështesë Ukrainën. Ajo do të qëndrojë me Ukrainën për aq kohë sa të duhet. Stoltenberg tha se: "NATO nuk është palë në konflikt, por mbështetja jonë po luan një rol kyç për të ndihmuar Ukrainën të mbrojë veten dhe të çlirojë territorin, përballë sulmeve të tmerrshme dhe pa dallim të Rusisë ndaj civilëve dhe infrastrukturës kritike".

Ndërkohë Grupi i Kontaktit i Mbrojtjes së Ukrainës, i udhëhequr nga SHBA-të u takua në NATO, më 12 tetor, dhe ministri i Mbrojtjes i Ukrainës, Oleksii Reznikov informoi ministrat aleatë mbi zhvillimet më të fundit në terren dhe nevojat urgjente të Ukrainës për dimrin që po vjen. Stoltenberg mirëpriti njoftimet e fundit nga aleatët për të ofruar sisteme më të avancuara të mbrojtjes ajrore dhe aftësi të tjera. Kurse më 13 tetor Sekretari i Përgjithshëm kryesoi një takim të Grupit të Planifikimit Bërthamor, ku u diskutua retorika e rrezikshme bërthamore të Rusisë dhe roli i aftësisë bërthamore të NATO-s në ruajtjen e paqes dhe frenimin e agresionit. "Javën e ardhshme, NATO do të mbajë stërvitjen e saj të parandalimit të planifikuar prej kohësh, Steadfast Noon, ky është trajnim rutinë, i cili ndodh çdo vit për të mbajtur parandalimin tonë të sigurt, të mbrojtur dhe efektiv", - tha Stoltenberg.

Ministrat ranë dakord për masat që duhen marrë për



të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s, duke rritur stoqet e municioneve dhe pajisjeve, duke i ofruar industrisë kërkesën afatgjatë që u nevojitet për të nxitur prodhimin përmes procesit të planifikimit të mbrojtjes së NATO-s dhe duke rritur elasticitetin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Ata gjithashtu diskutuan misionet dhe operacionet e NATO-s nga Kosova në Irak. "Kemi një dimër të vështirë përpara. Pra, është edhe më e rëndësishme që Amerika e Veriut dhe Europa të vazhdojnë të qëndrojnë të bashkuar në mbështetje të Ukrainës dhe në mbrojtje të popullit tonë", - tha Stoltenberg.

Ministeriali gjithashtu trajtoi parandalimin dhe mbrojtjen si dhe plotësimin e rezervave, pasi aleatët i kanë ofruar mbështetje Ukrainës duke reduktuar rezervat e NATO-s, municionet ose armët. "Kjo ka qenë gjëja e duhur për të bërë, por sigurisht, ne duhet t'i rimbushim ato rezervat", - tha Stoltenberg. Ministrat ranë dakord mbi udhëzimet për stoqet dhe gjithashtu të angazhohen më shumë me industrinë. Ministrat diskutuan gjithashtu misionin dhe operacionet e NATO-s nga Kosova në Irak dhe Sekretari i Përgjithshëm kryesoi takimin e Grupit të Planifikimit Bërthamor.

Stërvitjet bërthamore të NATO-s

do të vazhdojnë, pavarësisht tensioneve me Rusinë

"Qëllimi themelor i parandalimit bërthamor të NATO-s ka qenë gjithmonë ruajtja e paqes, parandalimi i detyrimit dhe frenimi i agresionit. Kërcënimet e fshehura bërthamore të Presidentit Putin janë të rrezikshme dhe të papërgjegjshme. NATO është një Aleancë mbrojtëse dhe NATO është për të parandaluar një konflikt, për të parandaluar një luftë. Prandaj, ne kemi forcuar frenimin tonë për t'i dërguar një mesazh shumë të qartë Rusisë se ne jemi atje për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët, dhe lidhur me spekulimet për përdorimin e armëve bërthamore, NATO i ka përcjellë qartë Rusisë se kjo do të ketë pasoja të rënda për Rusinë. Rusia e di se një luftë bërthamore nuk mund të fitohet, ajo nuk duhet të luftohet

kurrë”, - tha Stoltenberg. “Ne po monitorojmë gjithashtu nga afër qëndrimin bërthamor të Rusisë. Ne nuk kemi parë asnjë ndryshim në qëndrimin bërthamor të Rusisë, por do të jemi vigjilentë, do të vazhdojmë të monitorojmë nga afër sepse kërcënimet bërthamore, retorika bërthamore dhe kërcënimet e mbuluara nga Rusia janë të rrezikshme dhe të pamatura.

Nga ana tjetër NATO do të vazhdojë me stërvitjet bërthamore javën e ardhshme, pavarësisht përshkallëzimit të tensioneve midis Perëndimit dhe Rusisë pas kërcënimeve të fshehta të presidentit rus, Vladimir Putin, për përdorimin e armëve bërthamore. Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, tha të se stërvitjet vjetore janë rutinë dhe ishin planifikuar shumë kohë përpara se Kremli të pushtonte Ukrainën. Pjesa kryesore e tyre do të mbahet më shumë se 1000 kilometra larg Rusisë dhe do të përfshijë avionë luftarakë me aftësinë për të mbajtur koka bërthamore, megjithëse pa bomba për t'u përdorur. Më pak se gjysma e vendeve anëtare të NATO-s do të marrin pjesë në stërvitje. I pyetur nëse kjo ishte një ide e mirë duke pasur parasysh situatën delikate me Moskën, Stoltenberg tha se nuk do të ishte mirë të ndalonin tani. “Do të dërgonte një sinjal shumë të gabuar nëse befas tani anulonim një stërvitje rutinë, të planifikuar për një kohë të gjatë për shkak të luftës në Ukrainë. Ky do të ishte absolutisht sinjali i gabuar për t'u dërguar”, - u tha Sekretari i Përgjithshëm gazetarëve në Bruksel. “Sjellja e vendosur dhe e parashikueshme e NATO-s, forca jonë ushtarake, është mënyra më e mirë për të parandaluar përshkallëzimin”, - shtoi ai.

“Nëse ne tani do të krijojmë bazat për ndonjë keqkuptim, llogaritje të gabuara në Moskë për gatishmërinë tonë për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët, ne do të rrisim rrezikun e përshkallëzimit”, - tha Stoltenberg. Stoltenberg tha gjithashtu se “anëtarët e vendeve të NATO-s do t'i japin përparësi nevojave urgjente të Ukrainës, duke përfshirë sisteme më të avancuara të mbrojtjes ajrore dhe aftësi të tjera në dritën e përshkallëzimit serioz në pushtimin e Rusisë. Ka shqetësime edhe në Perëndim, për rezervat e varfëruara të armëve, pas muajsh furnizimi të Ukrainës. Aleatët tani do të shikojnë se si t'i plotësojnë ato, duke ruajtur gjithashtu furnizimet në Kiev.”

Vendet e aleancës po marrin masa për mbrojtjen e infrastrukturës

Rezistenca ishte gjithashtu një çështje që u trajtua në Ministerialin e Mbrojtjes. “Rezistenca e infrastrukturës kritike, rëndësia e saj është demonstruar nga sabotimi kundër tubacioneve në Detin Baltik. NATO do të përballojë sulmet e mundshme ruse ndaj infrastrukturës kritike të aleatëve me një përgjigje të bashkuar dhe të vendosur, si edhe se vendet anëtare po rrisin sigurinë rreth objekteve të tyre kritike. Për mbrojtjen e infrastrukturës sonë kritike, NATO ka punuar për shumë vite dhe pas sabotimit të tubacioneve “Nord Stream”, ne kemi rritur më tej vigjilencën tonë në të gjitha fushat, ne kemi dyfishuar praninë tonë në Detin Baltik dhe atë të Veriut, për mbi 30 anije. Mbështetur nga avionët e patrullimit detar dhe aftësitë nënujore. Këto përpjekje koordinohen ngushtë nga Komanda Detare e NATO-s. Aleatët po rrisin gjithashtu sigurinë rreth instalimeve kryesore dhe rritjen e shkëmbimit të inteligjencës. Ne do të ndërmarrim hapa të mëtejshëm për të forcuar qëndrueshmërinë tonë dhe për të mbrojtur infrastrukturën tonë kritike. Çdo sulm i qëllimshëm kundër infrastrukturës kritike të aleatëve do të përballëj me një përgjigje të bashkuar dhe të vendosur”, - tha Stoltenberg.

NATO platformë unike, rritja e rezervave të municioneve dhe pajisjeve

Ministrat ranë dakord për masat që duhen marrë për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s,

duke rritur stoqet e municioneve dhe pajisjeve, duke i ofruar industrisë kërkesën afatgjatë që u nevojitet për të nxitur prodhimin përmes procesit të planifikimit të mbrojtjes së NATO-s dhe duke rritur elasticitetin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

“Ne kemi Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, ne kemi objektivat e aftësisë, ne kemi punën për standardizimin dhe ndërveprueshmërinë. Të gjitha këto janë mjete unike të NATO-s që na mundësojnë të angazhohemi me industrinë dhe t'i sigurojmë industrisë kërkesën afatgjatë që ajo ka nevojë për të investuar më shumë në kapacitetin e prodhimit, në mënyrë që të mund të prodhojmë më shumë armë, më shumë municione, më shumë nga aftësitë që na duhen, si për siguruar frenimin dhe mbrojtjen tonë, por edhe të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Në takimin ministror, u morën vendime për të rritur rezervat e municioneve dhe pajisjeve të NATO-s, për të përsheptuar shpërndarjen e aftësive dhe për të përdorur Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s për t'i siguruar industrisë kërkesën afatgjatë që i nevojitet për të rritur prodhimin.

Misionet dhe operacionet e Aleancës, Ballkani Perëndimor

Ministeriali i Mbrojtjes i NATO-s u fokusua gjithashtu edhe në misionet dhe operacionet e Aleancës, nga Kosova në Irak. Takimit iu bashkua edhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Borrell, pasi NATO dhe Bashkimi Europian përballen me të njëjtat sfida të sigurisë. “Kemi një dimër të vështirë përpara dhe është edhe më e rëndësishme që Amerika e Veriut dhe Europa të vazhdojnë të qëndrojnë të bashkuar, në mbështetje të Ukrainës dhe në mbrojtje të popullit tonë”, - tha Stoltenberg.

“Ballkani Perëndimor është i rëndësishëm për NATO-n. Ne kemi një histori atje, ne kemi qenë atje për shumë vite. Ne ndihmuam për t'i dhënë fund dy luftërave brutale në vitet 1990. Ne kemi misionin tonë të KFOR-it në Kosovë, duke ndihmuar në sigurimin e stabilitetit, lëvizjen e lirë të të gjitha komuniteteve në Kosovë, ne kemi selinë në Sarajevë dhe po ashtu po punojmë ngushtë me Bashkimin Europian”, - tha shefi i NATO-s. Trupat e NATO-s në Kosovë ndihmojnë për të mbështetur përpjekjet diplomatike të Bashkimit Europian dhe dialogun Prishtinë-Beograd. “Ne gjithashtu punojmë së bashku me BE-në në Bosnje-Hercegovinë dhe ne kemi edhe anëtarë në Ballkanin Perëndimor. Dy anëtarët më të rinj të Aleancës janë në fakt vende të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Pra, Ballkani Perëndimor është i rëndësishëm për NATO-n dhe për këtë arsye, ne vazhdojmë të fokusohemi në atë rajon”, - tha Stoltenberg.

Takimi i ministrave të Mbrojtjes të NATO-s këtë javë erdhi në një moment të rëndësishëm për sigurinë transatlantike. Ku u shqyrtua përparimi në forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s, rritja më tej e mbrojtjes të infrastrukturës kritike, në dritën e sabotimit të tubacioneve “Nord Stream”, rritja dhe shtimi i mbështetjes për Ukrainën, në mënyrë që ajo të mund të vazhdojë, të mbrohet dhe të çlirojë territorin nga pushtimi rus. Ukraina ka vrullin dhe vazhdon të bëjë fitime të konsiderueshme. Ndërsa Rusia po përdor gjithnjë e më shumë sulme të tmerrshme dhe pa dallim ndaj civilëve dhe infrastrukturës kritike. Presidenti Putin po dështon në Ukrainë. Përpjekja për aneksimet e tij, mobilizimi i pjesshëm dhe retorika e pamatur bërthamore përfaqësojnë përshkallëzimin më të rëndësishëm që nga fillimi i luftës dhe tregojnë se kjo luftë nuk po shkon siç është planifikuar. NATO nuk është palë në konflikt, por mbështetja e saj po luan një rol kyç. Aleatët mbeten të bashkuar në mbështetjen e tyre për sovranitetin dhe vetëmbrojtjen e Ukrainës.

10 NGA ARMËT E FORCAVE SPECIALE AMERIKANE

FN SCAR

Pushka sulmuese luftarake e Forcave të Operacioneve Speciale (SCAR) është një pushkë modulare e bërë nga FN Herstal (FNH) për Komandën e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara (SOCOM), për të përmbushur kërkesat e konkursit SCAR. Kjo familje pushkësh përbëhet nga dy lloje kryesore. SCAR-L, për "dritë", është i vendosur në fishekun 5.56×45 mm të NATO-s dhe SCAR-H, për "të rëndë", për qitje e NATO-n 7.62×51 mm. Të dyja janë të disponueshme në variantet e betejës në distanca të afërta apo të largëta



origjinale AR-15 që Eugene Stoner dhe "ArmaLite" projekttoi dhe prodhoi. M4 është një variant më i shkurtër dhe më i lehtë i pushkës sulmuese M16A2. Është një armë zjarri selektive e përdorur me gaz, e ushqyer me karikatorë, me përdorim nga shpatulla, me një stacion teleskopik dhe tytë 14,5 inç (370 mm) për të lehtësuar luftimin nga afër. Ashtu si pjesa tjetër e familjes M16, ai gjuan kalibrin 223, ose 5.56 mm të NATO-s.

HK MP5

Heckler & Koch MP5 (nga gjermanishtja: Maschinenpistole 5, "pistoletë automatik modeli 5") është një automatik 9 mm i dizajnit gjerman, e zhvilluar në vitet 1960 nga një ekip inxhinierësh nga prodhuesi gjerman i armëve të vogla "Heckler & Koch GmbH" (H&K) e "Oberndorf am Neckar". Ka mbi 100 variante të MP5, duke përfshirë një version gjysmë automatik.



HK MK23 SOCOM 45

Heckler & Koch MK 23, Mk 23 Mod 0, Mark 23, ose MARK 23, është një sistem armësh i përbërë nga një pistoletë gjysmë automatike e shkallës së ndeshjes, një modul synimi lazer (LAM) dhe shtypës. Ai u miratua nga Komanda e Operacioneve Speciale të Shteteve të Bashkuara (US-SOCOM) për njësitë e operacioneve speciale në vitet 1990 si një pistoletë sulmuese. Prodhimi filloi në 1991, dhe ishte baza për HK USP, e cila filloi prodhimin në 1993.



KARABINA M4

Karabina M4 është një familje armësh zjarri që rrjedh nga versionet e mëparshme të karabinës të pushkës M16, e cila nga ana e saj rrjedh nga pushka

HK MP7

MP7 është një armë gjermane e mbrojtjes personale (PDW) e prodhuar nga "Heckler & Koch" (H&K) dhe e vendosur për fishekun HK 4.6×30 mm. Ajo u projektua me fishekun e ri për të përmbushur kërkesat e NATO-s të botuara në 1989, pasi këto kërkesa kërkojnë një armë zjarri të klasës së mbrojtjes personale (PDW), me një aftësi më të madhe për të mposhtur armaturën e trupit sesa armët aktuale të kufizuara në fishekë kon-



vencionalë pistolette. MP7 hyri në prodhim në vitin 2001. Ai është një rival i drejtpërdrejtë i FN P90, i zhvilluar gjithashtu në përgjigje të kërkesës së NATO-s. Arma është rishikuar që nga prezantimi i saj dhe versioni aktual i prodhimit është MP7A1.

HK P11

Meqenëse fishekët në formë të zakonshme janë të pasaktë dhe kanë një distancë shumë të shkurtër kur përdoren nën ujë, kjo pistoletë lëshon shigjeta çeliku rreth 10 centimetra (3,9 in) të gjata. Ajo ka pesë

tyta, secila prej të cilave është e mbushur me një fishek, duke i dhënë armës një pamje si kuti piper, dhe ajo ndizet në mënyrë elektrike nga një paketë baterie në dorezën e pistoletës. Pas shkrepjes së



pesë fishekëve, njësia e tytës duhet t'i dërgohet prodhuesit të saj për rimbushje. Ai është shumë i ngjashëm me paraardhësin e tij, Mk 1 (armë brojtëse për nën ujë). Në të kaluarën, "Heckler & Koch" ka mohuar njohurinë për ekzistencën e saj.

REMINGTON MODELI 870 SHOTGUN

Remington Modeli 870 është një armë gjahu me pompë e prodhuar në SHBA, e prodhuar nga "Remington



Arms Company", LLC. Përdoret gjerësisht nga publiku për qitje sportive, gjueti dhe vetëmbrojtje. Përdoret gjithashtu zakonisht nga organizatat e zbatimit të ligjit dhe ushtria në mbarë botën.

PUSHKE SULMUESE AK-47

AK 47 është një pushkë sulmi 7.62×39 mm me zjarr selektiv, me gaz, e zhvilluar për herë të parë në Bashkimin Sovjetik nga Mikhail Kalashnikov. Komanda e Operacioneve Speciale të SHBA-së ka AK 47 në inventar për një sërë misionesh. Është një nga armët më të be-

sueshme të bëra ndonjëherë dhe bën një zgjedhje të shkëlqyer kur duhet të notosh një armë mbi plazh. Edhe pas gjashtë dekadash, modeli dhe variantet e tij



mbeten pushkët më të njohura dhe më të përdorura në botë për shkak të besueshmërisë së tyre të konsiderueshme edhe në kushte të vështira, kostove të ulëta të prodhimit në krahasim me armët bashkëkohore perëndimore, disponueshmërisë në pothuajse çdo rajon geografik dhe lehtësisë së përdorimit.

PUSHKA ANTIMATERIALE BARRETT M82

M82 është një pushkë kundër-materiale gjysmë-automatike e operuar me zbrapsje e zhvilluar nga kompania amerikane "Barrett Firearms Manufacturing". Një SASR e rëndë (Pushkë me shtrirje speciale), përdoret nga shumë njësi dhe ushtri në mbarë botën. Quket gjithashtu "Light Fifty" për dhomëzën e saj 0,50 BMG (12,7×99 mm NATO). Arma gjendet në dy variante, M82A1 origjinale (dhe A3) dhe "bullpup" M82A2. M82A2 nuk prodhohet më, megjithëse XM500 mund të shihet si pasardhësi i tij.



M249 MITRALOZ I LEHTE

Mitralozi i lehtë M249 (LMG), i emërtuar më parë Arma Automatike e Skuadrës M249 (SAW) dhe e shkruar zyrtarisht si Mitralozi i lehtë, 5.56 mm, M249, është përshtatja amerikane e belg FN Minimi, një mitraloz i lehtë i prodhuar nga Kompania belge FN Herstal (FN). M249 është prodhuar në Shtetet e Bashkuara nga filiali lokal FN Manufacturing LLC në Karolinën e Jugut dhe përdoret gjerësisht në Forcat e Armatosura të SHBA. Arma



u prezantua në vitin 1984 pasi u vlerësua si më efektive nga një numër armësh kandidate për të trajtuar mungesën e fuqisë automatike të zjarrit në njësitë e vogla. M249 u siguron skuadrave të këmbësorisë vëllimin e madh të zjarrit të një mitralozi të kombinuar me saktësinë dhe transportueshmërinë që i afrohet asaj të një pushke.

Shtatëdhjetë e pesë vjet më parë, një bum zanor gjëmoi për herë të parë mbi shkretëtirën e lartë të Kalifornisë. Një grup i vogël studiuesish nga Komiteti Këshillimor Kombëtar për Aeronautikën (NACA) – organizata paraardhëse e NASA-s – ishin të parët që dëgjuan kërcitjen e bubullimës që vinte nga avioni raketor “Bell X-1” që fluturonte më shpejt se shpejtësia e zërit. Ishte 14 tetor 1947 dhe ekipi i përbashkët X-1 i NACA-s, Forca Ajrore dhe inxhinierët e pilotët e “Bell” kishin thyer pengesën e zërit - një mur imagjinar në qiell, disa thanë se ishte e pamundur të depërtohej.


Tani, novatorët aeronautikë me misionin “Quesst” të NASA-s janë gati të thyejnë përsëri barrierën e zërit, vetëm se këtë herë në një mënyrë shumë të ndryshme që mund të na mundësojë që të gjithë ne një ditë të udhëtojmë nëpërmjet ajrit po aq shpejt sa çdo pilot i “X-1” fluturonin një supersonik. “Ai fluturim i parë supersonik ishte një arritje kaq e jashtëzakonshme, dhe tani ju shikoni se sa larg kemi arritur që atëherë. Ajo që ne po bëjmë tani është kulmi i punës shumë të madhe të tyre”, - tha Catherine Bahm, një inxhinierë aeronautike në Qendrën Kërkimore të Fluturimeve Armstrong të NASA-s në Kaliforni. Bahm është menaxher i projektit “Low Boom Flight Demonstrator”. Ekipi i saj është përgjegjës për projektimin dhe ndërtimin e X-59, aeroplanit eksperimental të NASA-s që është pjesa qendrore e “Quesst”.

Nëpërmjet “Quesst”, NASA planifikon të demonstrojë se X-59 mund të fluturojë më shpejt se zëri pa gjeneruar zhurmat tipike të zërit që çuan në ndalimin e fluturimit supersonik mbi tokë në 1973.

Plani përfshin fluturimin e X-59 mbi disa komunitete për të vëzhguar se si njerëzit reagojnë ndaj “goditjes” më të qetë të zërit që prodhon, nëse dëgjojnë diçka. Përgjigjet e tyre do të ndahen me rregullatorët të cilët më pas do të konsiderojnë shkrimin e rregullave të reja për të hequr ndalimin. Dhe kur kjo të ndodhë, do të shënojë një tjetër moment historik në fluturim, duke hapur potencialisht një epokë të re në udhëtimin ajror, ku pasagjerët e linjave ajrore mund të hipin në një avion supersonik në kohën e mëngjesit në Los Anxhelos për të bërë një rezervim për drekë në qytetin e Nju Jorkut.

Nga atëherë e deri tani

Ëndrra e udhëtimit komercial supersonik nuk ishte në mendjen e kapitenit të Forcave Ajrore Chuck Yeager,



X-59 i NASA-s, pjesa qendrore e misionit “Quesst” të agjencisë për të ndihmuar në mundësimin e udhëtimit komercial supersonik mbi tokë, shihet në këtë ilustrim nga “Lockheed Martin”, kompania me të cilën NASA ka kontraktuar për të projektuar, ndërtuar dhe kryer testet fillestare të fluturimit me aeroplanin. Fluturimi i parë synohet për vitin 2023.
Foto: Lockheed Martin

NASA është gati të thyejë barrierën e zërit në një mënyrë të re

kur ai pilotoi X-1 “Glamorous Glennis” në 1947, në fluturimin historik pas “1 Mach”, një matje se sa shpejt është fluturimi në raport me shpejtësinë e zërit.

Kaluan vite përpara se një transport supersonik i SHBA-së - i njohur gjerësisht si SST - të propozohej nga Presidenti John F. Kennedy në qershor 1963, pak pasi Europa shpalli planet e saj për “Concorde”, aeroplani më i shpejtë se zëri që operoi përfundimisht nga 1976 në 2003.

SHBA më vonë ndaloi projektin SST në 1971 dhe ndaloi fluturimin supersonik mbi tokë në 1973.

Kërkimet vazhduan në fluturimin supersonik për arsye ushtarake dhe thjesht shkencore. Aeroplanët X që pasuan X-1 i shtynë kufijtë e fluturimit më lart dhe më shpejt, dhe novatorët aeronautikë të NASA-s ishin aty në çdo hap. Mjetet gjithnjë e më të avancuara të kompjuterit dhe kërkimit të tunelit të erës që ata përdorën i shtuan njohuritë e tyre.

Duke zvogëluar zhurmën

Gjatë rrugës, studiuesit fituan një kuptim më të madh se si avionët krijojnë bume zanore dhe e kthyen në vëmendjen e tyre idenë e uljes së intensitetit të bumit të zërit duke manipuluar formën e aeroplanit.

Kjo ide u testua gjatë fluturimit nga programi “Shaped Sonic Boom Demonstration” i NASA-s, gjatë viteve 2003-2004. Ai përdori një

avion “Northrop F-5E”, trupi i të cilit u modifikua për t’i dhënë një formë të krijuar për të prodhuar zhurma më të qeta të zërit.

Funksionoi

Me X-59 dhe teknologjinë e tij pa zhurmë, supersonike, të ndërtuar mbi gjithçka që është mësuar që kur X-1 provoi për herë të parë se ishte e mundur të shkohej përtej “Mach 1”, NASA shpreson t’i mundësojë industrisë që të bëjë fluturimin më të shpejtë se zëri të disponueshëm për të gjithë. “Ne kemi qenë të ngecur me avionët tanë në rreth “0,8 Mach” për pothuajse 50 vitet e fundit, kështu që të qenit në gjendje të arrijmë atje, shumë më shpejt është ende një lloj ëndrre e paplotësuar”, - tha Peter Coen, i NASA-s. menaxher i integritetit të misionit për “Quesst”. Ekziston një shaka e vjetër se si X-1 theu barrierën e zërit dhe NASA është përpjekur ta rregullojë atë që atëherë. Coen nuk e sheh kështu. Në vend të kësaj, pengesa e re për fluturimin supersonik është kufiri i shpejtësisë për shkak të efektit negativ të zhurmës së zërit, tha ai. “Me X-59 që fluturon në misionin “Quesst”, mendoj se jemi gati të thyejmë edhe një herë pengesën e zërit”, - tha Coen.

Fluturimi i parë i X-59 është synuar për fillimin e vitit 2023.

Jim Banke,
Drejtoria e Misionit Kërkimor të Aeronautikës

PULLA POSTARE, simbol i historisë,

traditës dhe zhvillimit të një vendi

Me emetimin e pullës së parë postare shqiptare u konsolidua dhe shërbimi postar, me identitet shqiptar, e cila ka qenë kurdoherë pjesë shprehëse e identitetit tonë kombëtar. Vetë udha e gjatë dhe e bukur e pullës është një pasuri e vyer e jona. Si pasqyrë adekuate e historisë së popullit shqiptar, ajo ka pasur përherë fytyrën e saj të papërsëritshme, portretin e vet autentik. Ky portret filloi të skicohej menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912. Fillimisht, me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, për vetë rrethanat në të cilat ndodhej administrata e Qeverisë së Ismail Qemalit, vazhduan të ekzistojnë postat osmane. Madje ishin po ata nëpunës, që deri në maj 1913, përdorën vulat dhe pullat turke.

Gjërat hynë në normalitet duke filluar nga 5 maji i vitit 1913, kur u emetua dhe u vu në qarkullim pulla e parë kombëtare shqiptare. Qeveria e Ismail Qemalit, duke pasur në përbërje të saj si ministër të Postave intelektualin e njohur Lef Nosin, i kushtoi vëmendje të veçantë veprimtarisë postare përgjithësisht dhe emetimit të pullave. Vetëm në pak muaj të ekzistencës së saj, më 7 korrik 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës bëri kërkesë për anëtarësim në Bashkimin Postar të Përbotshëm, realizimi i së cilës zgjati më shumë se tetë vjet. Pikërisht në tetor të vitit 1922, Shqipëria u bë anëtare e UPU-së.

Po kështu, nisur nga nevojat e mëdha për pulla post-

are në fillimet e shtetit shqiptar, Ministria e Postave bëri zgjidhje shumë efektive e praktike. Brenda një periudhe tetë mujore, mars-dhjetor 1913, u emetuan gjashtë emisione pullash.

Pulla e parë, u realizua afro gjashtë muaj pas shpalljes së pavarësisë. Ajo nuk ishte e zakonshme, siç janë pullat aktualisht, por kishte formën e një vule në ngjyrë të zezë, me të cilën u shtypën gjithsej 2232 zarfe. Kjo pullë-vulë në zarfe me ngjyra të ndryshme, kushtonte 1 grosh dhe u nxor në shitje në 11 qytete ku funksiononin zyrat postare të ngritura gjatë pushtimit osman. Ajo u vu në qarkullim më 5 maj 1913. Karakteristikë ishte edhe prerja e vulës nga zarfet origjinale dhe vendosja e qarkullimi mbi zarfe të tjerë, praktikë e njohur dhe e përligjur nga Ministria e Postave.

E ngjashme me të parën ishte edhe e dyta, ndonëse disi më e përsosur. Përsëri kemi të bëjmë me një pullë-vulë të vetme, me formë të rrumbullakët, me dy rrahë koncentrikë brenda të cilëve është shkruar: "Postat e Qeverrisë së Përkohëshme të Shqipënisë". Çmimi i saj nuk shkruhet në pullë, por dihet që ka qenë gjithashtu 1 grosh. Kjo pullë qarkulloi në periudhën maj-nëntor 1913. Përveç se e shtypur mbi zarf (2442 copë), kjo pullë u shtyp edhe në fletë të bardha (800 copë). Ajo qarkulloi e prerë me makinë qepëse dhe e ngjitur rishtas mbi zarf. Vula e dytë në disa raste u falsifikua nga spekulantë të ndryshëm.

Tejet interesant, madje si një nga më të larmishmit



në historinë e filatelistë sonë është pulla e tretë. Jo rastësisht ajo është ndër më të kërkuarit nga filatelistët. Ky emision u përdor në zyrat e postës nga 16 qershori deri më 20 tetor 1913. Për të Posta Shqiptare shfrytëzoi një sasi të konsiderueshme pullash të administratës pushtuese osmane të viteve 1909-1910 (gjithsej 39 800 pulla), të cilat kishin mbetur pa u përdorur. Mbi to, nëpërmjet një vule dore prej bakri, u vendos mbishshtypja: një shqiponjë dykrerëshe dhe nën të fjala "Shqipënia". Vlerat e tyre variojnë nga 2 para deri në 50 piastra, kurse tirazhet nga 16 copë (50 piastër) deri në 11607 copë (tirazhi më i lartë i vlerës 20 para).

Veç tirazhit shumë të ulët, sidomos për disa nga vlerat, rrallësia e këtyre pullave lidhet edhe me ngjyrat e ndryshme të mbishshtypjes: e zeza (ngjyrë dominuese), e kaltra, e kuqja, tulla dhe vjollca. Kjo pullë e parë e gomuar, për vetë kushtet e kohës kur u vu në qarkullim, ka edhe mjaft gabime, sidomos rastet e mbishshtypjes mbrapsht, të cilat kërkojnë shumë nga filatelistë të vendit e të huaj.

Si në të gjitha shtetet e tjera edhe në Shqipëri filatelia ka qenë pjesë e kulturës dhe e lidhur ngushtësisht me historinë. Këtë e dëshmon më së miri edhe periudha midis dy luftërave botërore. Kjo periudhë pasqyrohet në filateli me veçoritë e saj specifike. Ndër to mund të përmendim p.sh., numrin e paktë të emisioneve të emetuara në vitet 1914-1919, pra gjatë Luftës së Parë Botërore. Ato kanë qenë kryesisht emisione pullash lokale si në Shkodër, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Tepelenë, Himarë, Elbasan etj. Larmi emisionesh emetuan edhe fuqitë ndërluftuese të Luftës së Parë Botërore që pushtuan Shqipërinë. Këto pulla qarkulluan së bashku me vulat datare që mbajnë shkrime në gjuhët e këtyre fuqive pushtuese.

Jo rastësisht, por nisur nga kuriozitetet e shumta, po veçojmë nga kjo periudhë historinë postare dhe emetimin e pullave nga Qeveria e Përkohshme e Durrësit, e kryesuar nga Esat Pashë Toptani.

Pas largimit të Princ Vedit, duke filluar nga 2 tetori 1914, Esat Pasha formoi Qeverinë e Përkohshme të Durrësit. Në këtë kohë zyrat postare ishin të mbyllura, shërbimin postar e kryenin postat e Levantit austriak dhe atij italian. Kjo situatë e detyroi Esat Pashën që më 9 janar 1915 të hapë zyrat postare në Durrës, Elbasan, Shijak, Lezhë, Kavajë. Fillimisht u përdorën pullat me portretin e Skënderbeut, me vlefata në qindra dhe në para e grosh, të cilat u gjetën në postën e Durrësit. Ato u mbishshtypën me myhyrin e Esat Pashës. Pulla përbëhet nga 9 vlefata si pulla postare, 5 vlefata si pulla taksë, me një mbishshtypje

"T" dhe dy kartë-postare të thjeshta 5 dhe 10 para.

Sigurisht kjo sasi pullash nuk i plotësonte kërkesat për një kohë të gjatë. Prandaj Qeveria e Esat Pashës vendosi të vinte në qarkullim dy pullat, "Tarabosh", të porositur qysh në vitin 1913 nga Pleqësia e Shqipërisë së Mesme. Ishin gjithsej 12 vlefata, nga të cilat 7 të formatit 27×30 mm dhe 5 të formatit 27×34 mm. Këto pulla, që gjithashtu kanë si mbishshtypje një myhyr të rrumbullakët me germa arabe, u përdorën, duke filluar nga 10 shkurti 1915 në Shqipërinë e Mesme, madje edhe në Berat e Skrapar.

Pas këtyre pullave, do të duhej të vinte viti 1919 që të dilnin në dritë disa emisione të tjera interesante: Zarfi me "Zyra e Financave të Elbasanit", me tirazh 500 kopje, që u vu në qarkullim gjatë muajit janar 1919, emisionet lokale të Shkodrës me mbishshtypje të pu-



llave fiskale të administratës austro-hungareze, që ishin gjendje në zyrat e financës në Shkodër, si dhe pulla 1 grosh e emisionit të vitit 1919 me mbishshtypjen "SHKODER 1919" në formë ovale.

Në periudhën që vijon ka vite të tëra si ato 1921, 1926, 1932, 1935, 1936, kur nuk u emetua asnjë pullë. Gjithashtu, krahas numrit të paktë të emisioneve, karakteristikë është edhe ngushtësia tematike. Zotëruese mbetet tema politike. Në vijim të një tradite edhe të vendeve të tjera, në pulla filloi të dukej përherë e më shumë portreti i mbretit, Ahmet Zogut, (në periudhën deri në 1939 shumica e pullave janë me fytyrën e tij), ndërsa gjatë pushtimit italian spikat shpesh fytyra e Viktor Emanuelit III. Me interes të veçantë dhe që e kapërcenin disi këtë ngushtësi tematike, ishin pullat ajrore. Duke pasur të fiksuar figurën e avionit, ato tregonin se i shërbenin postës ajrore, çka përligjete edhe tarifën e lartë që kishin.

Pra filatelia shqiptare e periudhës 1913-1944, është mjaft interesante. Këtu mund të përmenden jo pak pulla që janë bërë tejet të rralla: zarfet me vulë ari të pullave me fytyrën e Skënderbeut, zarfi me vulën e Zyrës së Financave të Elbasanit, zarfi me vulën e Tepelenës, zarfi me vulën e Beratit, emisioni gotik me

mbishtypjen "Mbr. Shqiptare", pullat e Komisionit të Kontrollit Provizor të Korçës, emisioni i 19 marsit 1915 kushtuar ngritjes së flamurit në fortesën e Shkodrës, ato të pushtimit grek, italian dhe gjerman, sidomos emisioni i 14 shtatorit 1943, që spikat veçanërisht për shumëllojshmërinë e gabimeve etj.

Pulla e "14 shtatorit 1943" përkon me datën e mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese, që për ligji shtetin kuisling shqiptar. Seria përbëhet nga 14 pulla të viteve 1939-1940, nga të cilat 13 vlefta ordinere dhe 1 ekspres, të mbishtypura me "14 shtator 1943". Ajo u vu në qarkullim më 18 shtator 1943 në postën e Tiranës, por pa kaluar dy ditë u urdhërua bllokimi i saj, pasi ishin konstatuar rreth 23 gabime në mbishtypje në 153 vlefta. Si e tillë është pranuar data 23 tetor 1943, e miratuar kjo edhe nga UPU-ja, që është njëherësh edhe dita kur në sportelin e postës së Tiranës emisioni ridoli në shitje.

Një tablo tërheqëse paraqet për filatelinë edhe periudha pas çlirimit të Shqipërisë dhe deri në vitet 90 të shekullit XX. Ajo shquhet sidomos për bollëk pullash (mesatarisht 10 emisione në vit), për tematikë më të larmishme se më parë, për një raport deri diku të drejtë midis tematikës kombëtare e asaj të huaj, për pamje të shumta në çdo emision etj. Përgjithësisht pullat janë të politizuara e të ideologjizuara. Ka emisione të përsëritur çdo pesë vjet për ngjarje të caktuara përkujtimore historike, siç ka dhe tirazhe shumë të mëdha. Një sy i vëmendshëm nuk e ka të vështirë të dallojë se në këtë periudhë është pasuruar tematika me emisione nga flora dhe fauna, nga sporti, nga arti (pulla me pamje veprash arti në pikturë e skulpturë), nga arkeologjia etj. Por gjithashtu është fakt se ka fare pak Zarfe FDC dhe Kartëpostale zyrtare.

Pas mbishtypjeve të bëra në fund të vitit 1944 dhe në fillim e në vazhdim të vitit 1945, më 28 nëntor 1945, administrata e Postës hodhi në qarkullim një emision me tri pamje e gjashtë vlefta, me ngjyra të ndryshme me mbishkrimin "Qeveria Demokratike e Shqipërisë". Më vonë këtij emisioni iu bënë katër mbishtypje radhazi. Mbishtipja e parë mban datën 10 janar 1946, e dyta 1 korrik 1946, e treta 26 korrik 1946 dhe e katërta 22 shkurt 1948. Këto emisione do të pasoheshin nga mjaft të tjerë që do t'i kushtoheshin ngjarjeve të caktuara të historisë së popullit tonë apo përvjetorëve të figurave të shquara, ndërtimit të hekurudhave të para, fluturimeve në kozmos, lojërave olimpike etj.

Deri në vitin 1957 pullat shtypeshin jashtë Shqipërisë. Pas këtij viti ato u shtypën në shtypshkronjat tona. Është rasti këtu të kujtojmë me respekt dhe t'u shprehim mirënjohjen tipografëve të parë të pullave shqiptare të specializuar në Gjermani, Sadik Dinga dhe Sulejman Maci.

Në dhjetëvjeçarën e fundit, duke filluar pas vitit 1990, pra me proceset demokratike, krahas oscilacioneve të kuptueshme të viteve të para të tranzicionit '91, '92, '93, janë bërë përpjekje serioze nga Komisioni Shtetëror i Pullës dhe Drejtoria e Postës Shqiptare për mënjanimin e politizimit të pullave, cilësia e botimit të tyre është më e mirë, pasi janë shtypur në Zvicër e Greqi.

Po ashtu, përgjithësisht janë mbajtur tregues optimalë për tirazhet e pullave, nisur nga nevojat e afrankimit dhe të koleksionimit të tyre. Karakteristikë e kësaj periudhe është edhe fakti se thuhetse çdo emision i emetuar shoqërohet me Zarkin FDC, të vulosur me vulë speciale.

Një element i ri është ideimi dhe prodhimi i libërthit filatelik për emisioni "Emblemat Shqiptare", e cila përmban katër seri pullash me sqarimet përkatëse për çdo emblemë të paraqitur. Përmirësime të dukshme ka pasur dhe mënyra e kompozimit në forma të reja më të paraqitshme dhe praktike të emisioneve të pullave Shqiptare.

Figurat e shquara kombëtare kanë zënë një vend të rëndësishëm duke përkujtuar atdhetarë, shkrimtarë, klerikë, politikanë, artistë, sportistë, etj. Emisionet "Flora" dhe "Fauna" e vendit tonë janë të pranishme në tematikat e viteve të fundit dhe janë paraqitur mjaft bukur nga piktorët tanë. I njëjti përkushtim është treguar dhe për evenimentet, aktivitetet dhe figurat e shquara ndërkombëtare ku një vend të rëndësishëm zë cikli i emisionit "Europa".



Me shumë vlerë historike dhe bashkëpunimi është pulla e përbashkët Shqipëri-Kosovë-Maqedoni, dedikuar 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës.

Gjatë këtyre viteve ka pasur një zhvillim të mëtejshëm të teknologjisë për prodhimin e pullës dhe rritjen e kualitetit të saj.

Në vitin 2012 u emetuan shumë emisione të rëndësishme, siç ishin "100-vjet pavarësi (Logo)", "100-vjetori i shpalljes së pavarësisë", "100-vjetori i ushtrisë shqiptare", "100-vjetori i Post-Telegraf-Telefonave", këto pulla janë gurët e 100-të kilometrik i historisë së kombit



tonë. Gjithashtu në kuadrin e bashkëpunimit u realizua një karnet i përbashkët Shqipëri-Kosovë-Maqedoni me rastin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë.

Në kuadër të festimeve të 100-vjetorit të pavarësisë, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Britaninë e Madhe në bashkëpunim me Postën Shqiptare organizuan ekspozitën me pullat postare.

Nga kolana “Skënderbegasit ndër vite”

NEPTUN BAJKO, futbollist i shquar i “Partizanit” dhe trajner i ekipit kombëtar të Shqipërisë

Neptun Bajko u lind në Tiranë, më 12 gusht 1958. Ai ka qenë disa herë trajner i ekipit “Partizani”, ku ka luajtur shumë vite, i Kombëtares Shqiptare të futbollit dhe disa ekipeve të tjera. Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, ashtu si për shumë sportistë elitare të Shqipërisë, ishte vatra ku u evidentua dhe u përgatit edhe Neptun Bajko, një nga sportistët e njohur të vendit, anëtar i ekipit të futbollit “Partizani”, ekipit kombëtar të Shqipërisë dhe ekipeve të tjera...

Neptun Bajko ka drejtuar si trajner ekipet: “FK Partizani”, Tiranë, 16 ko-mrik 2010 - 4 prill 2011; “Besëlidhja”, Lezhë, 1 korrik 2009 - 30 qershor 2010;

“FK Partizani”, Tiranë, 1 korrik 2005 - 30 shtator 2005; “FK Partizani”, Tiranë, 1 korrik 1986 - 30 qershor 1988.

Ish-trajneri i njohur i Partizanit dhe i Kombëtares, Neptun Bajko, është i pari që fitoi një ndeshje në transfertë me Përfaqësuesen, atë 3-2 me Moldavinë në Kishinau (7 qershor 1995), për eliminatorët e Euro 1996... Si lojtar i Partizanit, Bajko ka fituar titullin kampion në sezon 1970 - 1971, me trajner Loro Boriçin. Për t'u mbajtur mend është goli i tij kundër Torinos, në Kupën e Kupave. Si trajner i të kuqeve e ka fituar atë në sezonin 1986 - 1987. Bajko e ka drejtuar Kombëtaren në fushatën eliminatorë të Euro 1996 (10 ndeshje) dhe në kualifikueset e Botërorit 1998 (3 ndeshje). E drejtoi Shqipërinë në 13 ndeshje zyrtare, duke pasur regjistruar 2 fitore, 3 barazime dhe 8 humbje. Ai humbi dy herë 2-1 me Gjermaninë, ndërkohë që barazoi 1-1 me Bullgarinë, në atë kohë vendi i katërt në botë. Bajko



ka zhvilluar 15 ndeshje në total me Kombëtaren, përfshirë dhe dy miqësore me Bosnjën. Ai e mori detyrën nga Bejkush Birçe dhe ia pasoi Astrit Hafizit. Bajko vlerësohet si një nga njohësit më të mirë të futbollit në Shqipëri. “Kam pasur një brez të shkëlqyer lojtarësh. Ndoshta më të mirët e viteve 1985 - 1995. Dua të kujtoj kapitenin Sulejman Demollarin, që bëri jo vetëm emër me ‘Dinamon’ tonë, por dhe me ‘Dinamon’ e Bukureshtit. Një lojtar i jashtëzakonshëm. Një emblemë e vërtetë. Emra të tjerë të rëndësishëm ishin Bledar Kola, Artur Lekbello, Rudi Vata, Lefter Millo, Sokol Kushta, Foto Strakosha, Altin Rraklli, Arjan Xhumba, Arjan Bellai, Kliton Bozgo, Eduard Abazi, etj...”, -

kujton mjeshtri Neptun Bajko.

...Neptun Bajko i ka shënuar një gol Torinos së famshme, kur “Partizani” u ndesh me skuadrën italiane për Kupën e Fituesve të Kupave, në sezonin 1968 - 1969. “Partizani” fitoi 1-0 me “Torinon” në Tiranë, me golin e Pëllumb Shaqirit, ndërkohë që humbi 3-1 në Torino. Pikërisht, në ndeshjen e dytë shënoi Bajko (’85). Neptun Bajko ishte trajneri i “Partizanit”, kundër Benfikës së Portugalisë për Ligën e Kampionëve (1987-1988), në një prej ndeshjeve më të përfolura. Të kuqtë humbën 4-0, por gjyqtari spanjoll Hoze Donato Pes Perez e ndëshkoi “Partizanin” me katër kartonë të kuq, përfshirë dhe portierin Perlat Musta.



BASHKIM LIKAJ, mundës, trajner e gjqtar ndërkombëtar

Skënderbegasi Bashkim Lika është një nga ikonat e mundjes shqiptare, me emër dhe në aktivitetet ndërkombëtare, ku ai ka marrë pjesë para vitit 1990. Ndërkohë, një aktivitet të suksesshëm ai ka dhe si trajner mundje për ekipin e "Partizani" ku ka fituar shumë trofe.

Bashkim Lika lindi në Tiranë më 29 janar 1949. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në kryeqytet, ndoqi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" (1963-1967), Institutin e Fizkulturës "Vojo Kushi" (1968-1971) dhe Shkollën e Lartë të Partisë "Vladimir Iliç Lenin" (1976-1978). Fillimisht u mor me edukimin fizik në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve (1971-1974), mandej ishte trajner profesionist i mundjes në Klubit Sportiv "Partizani". Në vitet 1987-1992 ishte pedagog dhe drejtues i Katedrës së Përgatitjes Fizike në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", ndërsa pas vitit 1997 specialist i edukimit fizik në Ministrinë e Mbrojtjes. Në vitet 1968-1969 ka qenë kampion mundjeje për të rinj, në vitet 1970-1971-1972 kampion kombëtar për të rritur. Si trajner i ekipit "Partizani" të mundjes, ka koleksionuar 10 tituj



Bashkim Lika lindi në Tiranë më 29 janar 1949. Pasi mbaroi shkollën 7-vjeçare në kryeqytet, ndoqi shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej" (1963-1967), Institutin e Fizkulturës "Vojo Kushi" (1968-1971) dhe Shkollën e Lartë të Partisë "Vladimir Iliç Lenin" (1976-1978).

kampion kombëtar, 10 kupa republike, 2 kupa të spartakiadës kombëtare. Ka bërë disa takime miqësore ndërkombëtare, ku ka fituar dy herë me nënkampionët e Europës dhe dy herë me mundës të kalibrit botëror. Ka qenë 10 vjet trajner i ekipit kombëtar të mundjes, duke zënë vendet e 11-14 në Europë, president i

Federatës Shqiptare të Mundjes në vitet 1990-1992 dhe Gjqtar i Kategorisë Ndërkombëtare. Mban Urdhrin "Naim Frashëri" të Klasit I dhe "Ylli i Kuq" të Klasit II. Është kryetar i Komitetit Drejtues të Sporteve në Ushtri.

Kujtim Boriçi
Maksim Fejzullai



Autori i fotove të rralla, ditën e çlirimit të Korçës, më 24 tetor 1944, është Jonuz Baliko Latollari (1887-1970) nga Panarit-Grabockë Korçë, pjesëmarrës në të dy Luftërat Botërore.

KORÇA, DJEPI I ATDHETARIZMIT, feston 78 vite pavarësi

Brigada IX Sulmuese u formua në katundin Lozhan të Gorës, qarku i Korçës, më 16 tetor 1944. Shtabi i brigadës ishte i përbërë nga Irakli Bozo, komandant; Mihallaq Ziqishti, komisar; Petro Papi, zëvendës komisar; Meleq Babani, përgjegjës rinie dhe Vangjel Marko, intendent.

Kjo brigadë u krijua me qëllimin e shtimit të veprimeve ushtarake në zonën e Korçës. Detyra ishte të eliminonte autokolonat armike që lëviznin në aksin Janinë-Korçë-Manastir-Follorinë, Korçë-Pogradec-Tiranë, por detyra më e rëndësishme ishte çlirimi i qyteteve të Korçës, Ersekës dhe Bilishtit.

Me marrjen e këtyre qyteteve, armikut i pritëshin rrugët e komunikacionit dhe paralizoheshin tërheqja e ushtrisë gjermane nga Greqia për në Jugosllavi nëpërmjet territori shqiptar.

Urdhri për krijimin e brigadës u dha nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në përbërje

të tij u caktuan batalione me përvojë në luftë kundër pushtuesve. Inaugurimi i brigadës u bë para efektivit të saj, ku u rreshtuan të gjithë batalionet e saj. Brigada kishte një armatim që e dispononte e gjithë ushtria shqiptare në atë moment, ajo kishte armë të dhuruara nga populli, por edhe nga ndihmat aleate të hedhura me parashutë, si armë automatike, por që nuk plotësonin të gjithë numrin e pjesëtarëve të brigadës. Brigada ishte e pajisur me shërbim shëndetësor: Pranë shtabit të brigadës qëndronte një mjek dhe 2-3 infermiere vullnetare.

Pas ngritjes së Shtabit Operativ për çlirimin e Korçës, Brigada IX, që përbënte dhe një nga forcat kryesore pjesëmarrëse në operacion, kishte në përbërje të saj 1 580 partizanë. E gjithë forca partizane në zonën e Korçës arrinte në 3 000 veta, po të shtohen këtu edhe partizanët e Brigadës II me 1 150, dhe brigada e XX me 430. Këtu mund të shtojmë edhe forcat guerile që vepronin brenda në qytete, si në Korçë dhe Bilisht, të cilat arrinin në rreth 1 000 vetë.

Forcat armike që kontrollonin zonën e Korçës ishin më të pakta në numër, por të pajisura dhe mbështetura në tanke dhe artileri. Këto forca armike kishin nën kontroll vetëm rrugët kryesore dhe duhej të siguronin tërheqjen e forcave gjermane nga Greqia në Jugosllavi, e cila përbëhej nga Korparmata e 21.

Në bazë të urdhrave të Shtabit të Operacionit, batalionet e brigadës morën të gjithë detyra të ndryshme në zona të ndryshme, në bashkëpunim me batalionet e brigadave ndihmëse. Batalioni I u caktua të asgjësonte garnizonin e Kolonjës dhe Leskovikut. Batalioni II duhej të kontrollonte disa prej katundeve që kishin pranë rrugën automobilistike Qafë e Qarrit - Korçë. Batalioni III duhet të sulmonte garnizonin e Bilishtit dhe të kontrollonte kufirin në zonën e Kapshticës. Batalioni IV në bashkëpunim me batalionin I të brigadës së II duhej të sulmonte garnizonin e qytetit të Korçës dhe çlirimin përfundimtar të qytetit. Disa prej tyre edhe u diktuan në momentin kur dhe do të zinin pozicionet e luftimit, ata u goditën nga zjarri i artilerisë armike. Katër batalionet e brigadës u vendosën sipas urdhrave në pozicionet e caktuara. Të parët që u ndeshën me forcat armike ishin partizanët e batalionit I, të cilët mundën të futeshin thellë në linjat armike.

Nga Janina po tërhiqej një autokolonë e madhe me gjermanë, të cilët rrugës do të mblidhnin edhe disa nga garnizonet që kishin në Leskovik, Korçë dhe Bilisht. Kjo autokolonë u sulmua nga batalioni I i Brigadës IX në bashkëpunim me batalionin II të Brigadës II. Lufta ishte e ashpër, me sulme e kundërsulme, por falë errësirës, autokolona arriti të dalë nga rrethimi dhe të largohet në drejtim të Korçës. Ky largim i gjermanëve lejoi që forcat partizane të futen në qytetet e Leskovikut dhe Ersekës.

Në mesin e tetorit forcat partizane kishin nën kontroll të gjithë krahinën e Kolonjës, në dorë të tyre kishin rënë shumë materiale ushtarake të lëna nga armiku në ikje e sipër.

Të katër batalionet raportonin suksese në zonat ku ishin caktuar. Ato filluan sulmin kundër forcave gjermane që gjendeshin të pozicionuara jashtë Korçës, duke pasur sukses dhe duke shkaktuar panik midis armikut. Kjo bëri që ato të tërhiqeshin në mënyrë të çrregullt drejt Korçës. Batalioni i katërt tentoi me sukses edhe bllokimin e rrugës Korçë-Pogradec, kjo i detyroi forcat naziste të mos kishin asnjë komunikim me forcat jashtë, duke shuar edhe shpresën për ndonjë ndihmë të mundshme. Ky ishte një sukses në fushën e betejës për dy brigadat që organizuan sulmin. Sukses ishte edhe për komandën e brigadës, e cila kishte vetëm pak kohë që ishte krijuar.

Në bashkëpunim me Brigadën II, Brigada IX iu afrua lagjeve të jashtme të Korçës. Menjëherë mbi qytet filluan sulme të organizuara me qëllim shqetësimin e armikut. Duke e zgjatur vijën e luftës, partizanët po ngushtonin rrethimin e armikut. Të gjendur në dëshpërim gjermanët tentonin të tërhiqeshin prapa, andej nga kishin ardhur, nga kufiri grek. Forcat zbuluese partizane mundën të lokalizojnë saktësisht vendosjen e armikut dhe mënyrën se si mbroheshin. E gjithë kjo u arrit në bashkëpunim me forcat guerile që ndodheshin në qytet. U dha urdhër që rrethimi të ngushtohej edhe më shumë, forcat partizane intensifikuan sulmet, ato arritën deri në pazarin e qytetit, duke u ndeshur dhe trup me trup me gjermanët.

Kjo i detyroi gjermanët që ta përqendronin çarjen e rrethimit në një pikë, verilindjen. U përdorën të gjitha armët e mundshme, që nga artileria dhe autoblindat.

Ata filluan të hidhnin në erë shumë pika strategjike të qytetit, por sidomos depon e municioneve, shpërthimi i së cilës shkaktoi një gjendje alarmi. Gjermanët kishin lënë vetëm një shteg për t'u tërhequr, shteg, i cili u bllokua menjëherë nga forcat partizane. Vetëm një pjesë e tyre mundi të shpëtojë dhe të largohet nga qyteti. Pjesa tjetër u vra ose u kap rob nga partizanët. Ky ishte edhe sulmi i fundit i partizanëve, të cilët mundët ta çlironin përfundimisht qytetin e Korçës. Mbetej të bëhej edhe çminimi i zonave të pushpërthyer, operacion që u krye në bashkëpunim me njësitet guerile të qytetit. I gjithë qëllimi i gjermanëve ishte të hidhej në erë qyteti i Korçës, që forcat naziste të kishin mundësi të largoheshin të pa shqetësuar. Menjëherë forcat partizane dhe më saktësisht batalioni I i brigadës IX dhe ai I i brigadës II, u vunë në ndjekje të forcave armike. Forcat partizane iu drejtuan qytetit të Bilishtit, i cili mbahej akoma nga forca naziste. Qyteti u rrethua, por partizanët u gjendën përballë një sulmi të artilerisë armike. Pas shumë përpjekjesh partizanët i detyruan gjermanët të tërhiqeshin nga pozicionet e zjarrit dhe të strukeshin në kazermat e qytetit. I gjithë sulmi vazhdoi tërë natën e 25 tetorit duke i bërë gjermanët të tërhiqeshin drejt kufirit grek.

Edhe pse dolën nga kufiri shqiptar gjermanët u ndoqën dhe u sulmuan duke u shpartalluar përfundimisht. Partizanët e Brigadës IX u futën dhe ndihmuan popullin grek nga forcat gjermane, në katundet e Drenovës. Operacionet për çlirimin e Korçës u kryen në një kohë të shpejtë. Kjo ishte rezultat i bashkëpunimit me batalionet e tjera të Brigadës II. Populli i Korçës iu rezervoi një pritje të madhe partizanëve kur këta u futën në qytet,



për nder të tyre u organizuan koncerte e festime. Populli i Korçës doli i gjithi nëpër rrugë dhe festoi me partizanët çlirimin e qytetit. Kori i qytetit, për nder të kësaj ngjarjeje këndoi këngë patriotike, sidomos një këngë e cila ishte përgatitur posaçërisht për këtë ditë.

Por shfaqje të tilla gjithë kishte edhe në qytetet e tjera si Bilishti dhe në gjithë qarkun e Korçës, të cilat zgjatën tërë natën deri në mëngjes.

Menjëherë pas çlirimit të qarkut të Korçës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, dy nga batalionet e brigadës IX u vendosën në mbrojtje të qytetit të Korçës dhe dy të tjerë në mbrojtje të qytetit të Bilishtit. Detyrë ishte edhe mbrojtja e kufirit me Greqinë, e cila po mbante një qëndrim agresiv ndaj popullit shqiptar sidomos çamëve. Pas qetësimit të gjendjes forcat e Brigadës IX, që tashmë kishin hyrë në përbërje të Divizionit IV, morën urdhër të largohen nga qarku i Korçës dhe të vendosen në Shqipërinë e Mesme në rajonin Kruië-Ishëm-Kavajë.

Mundësi të **shkëlqyera** studimi në **akademitë ushtarake** më të mira në botë.
Tetë bursa të plota studimi, **6** në Akademinë e Marinës në SHBA dhe 2 në Itali, njëra për karabinieri në Modena, tjetra për detari në Livorno.

Gjithçka mbulohet nga shtetet pritëse.

Forcat e Armatosura shqiptare garantojnë **punësim dhe karrierë të sigurt** pas përfundimit të studimeve.

Kriteret dhe afatet i gjeni në linqet e mëposhtme:

<https://bit.ly/3SIJ2Vd>

<https://bit.ly/3FqoyxI>



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES

8 BURSA STUDIMI



NË AKADEMITË
USHTARAKE MË TË
MIRA NË BOTË